

**SHQIPËRIA DHE BASHKËPUNIMI POLICOR
NDËRKOMBËTAR KUNDËR KRIMIT**

Myzafer Elezi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve tëprogramittë Doktoratës në Drejtësi,
me profil “E Drejtë Publike” për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.As.Dr. Irakli Koçollari

Numri i fjalëve: 52462

Tiranë, maj 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje nuk është prezantuar asnjëherë para një komisioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKT

Bashkëpunimi policor ndërkombëtar është një temë jo fort e trajtuar nga studiuesit e fushës. Gjenden literatura që trajtojnë këtë bashkëpunim, por jo posaçërisht të fokusuar tek nivelet dhe format e bashkëpunimit policor në nivel europian apo më gjerë. Në kohën në të cilën po jetojmë krimi ka marrë përmasa të mëdha. Bëhet fjalë për ato lloje veprash penale të cilat prekin dy a më shumë shtete, dhe që ndikojnë ndjeshëm në sigurinë e vendit dhe atë globale. Përmendim këtu krimet me natyrë terroriste, të cilat kanë përballë të gjitha strukturat ligj zbatuese në fushën e sigurisë dhe drejtësisë; krimin e organizuar, veçanërisht trafikimin e njerëzve, ku mund të përmendim trafikimin e fëmijëve, të femrave për prostitucion, të organeve; trafikimin e lëndëve narkotike etj.

Në përgjithësi nuk ka një përkufizim standard që etiketon bashkëpunimin policor, por duke u nisur nga praktikat e veprimtarisë procedurale për kryerjen e shkëmbimit dhe koordinimit ndërmjet organizatave policore, si dhe nga përvoja personale mund të përkufizohet si, një aktivitet i ndërsjellë midis organizatave, agjencive të zbatimit të ligjit, që bazohet në parimet kryesore të fiksuara në dokumente të rëndësishme ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, kryerjen e operacioneve të përbashkëta pro-aktive si dhe planifikimin e veprimeve të koordinuara midis tyre.

Parë në këtë këndvështrim, duhet pranuar se hartimi dhe zbatimi në praktike i një legjislacioni që ndihmon institucionet përkatëse në veprimtarinë e tyre, për parandalimin dhe luftën kundër krimit, shpeshherë është jo i plotë, dhe jo i zbatueshëm. Për këtë arsye bëhet i nevojshëm një studim më i saktë për të analizuar dhe pasqyruar situatën aktuale, dhe për të rekomanduar ndryshime legjislative dhe institucionale që sjellin një ndryshim pozitiv në të tre fushat e përshkruara më sipër, ato ligjore, institucionale dhe operacionale.

Fjalët kyçe: Bashkëpunim policor, marrëveshje, konventë, hetime të përbashkëta, krim i organizuar, ekstradim etj.

ABSTRACT

International police cooperation is a topic hardly addressed by researchers. There are some available literature addressing the association, but not particularly focused on levels and forms of police cooperation at the European level or beyond. At the time in which we live crime has assumed large dimensions. It comes to those types of offenses which affect two or more countries, and that affect the global security and that of the country. We can mention terrorist crimes, which are facing all law enforcement structures in the area of security and justice, organized crime, especially trafficking of people, where we can mention the trafficking of children, of women for prostitution, organ; trafficking of drugs etc.

In general, there is no standard definition that labels police cooperation , but given the procedural activity practices for conducting exchange and coordination between police organizations and from personal experience can be defined as a mutual activity between organizations, law enforcement agencies based on the main principles fixed in the relevant international documents, in order to exchange information, conduct joint operations and pro - active planning and coordinated actions between them.

Seen in this context, it must be admitted that in practical the design and implementation of a law that helps relevant institutions in their activity, to prevent and combat crime, it is often incomplete, and not applicable. Therefore it becomes necessary a more accurate study to analyze and reflect the current situation and to recommend legislative and institutional changes that make a positive difference in the three areas described above, legal, institutional and operational.

Keywords: *police cooperation, agreement, convention, joint investigations, organized crime, extradition etc*

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet familjes time, e cila më ka mbështetur vazhdimisht në iniciativën time për të vazhduar studimet doktorale.

Në veçanti i dedikohet dy fëmijëve të mi, Endrit dhe Alvinit të cilët më inkurajojnë dhe më japin forcë në çdo çast të qenies time.

FALËNDERIM

Me rastin e përfundimit të punimit doktoral, kam kënaqësinë të falënderoj të gjithë ata të cilët më kanë mbështetur, udhëzuar dhe ndihmuar me të dhëna empirike për realizimin e punimit, pasi nëpërmjet tij kam mundur të njoh standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit policor kundër krimit, si dhe legjislacionin që suporton ky bashkëpunim.

Dëshiroj t'i shpreh falënderim dhe mirënjohje të gjithë stafit akademik të Universitetit European të Tiranës, dhe në veçanti stafit të Fakultetit Shkolla Doktorale, të cilat janë treguar të palodhur në përmbushjen e programit të studimeve doktrate.

Falënderoj miqtë e mi në strukturat e Policisë së Shtetit, Loreta Alla, Sokol Selfollari, Behar Tafa, Ardjan Çipa, dhe Ervin Dervina, të cilët më kanë vënë në dispozicion raporte dhe statistika vjetore të strukturave policore për periudhën kohore nga viti 2000 deri në 2013, mbi bazën e të cilave është bërë analiza e ecursisë së bashkëpunimit policor ndërkombëtar.

Veçanërisht, dua të falënderoj dy miq të mi, Dr. Xhavit Shala dhe Dr. Hasan Shkëmbi, për ndihmesën dhe predispozicionin e tyre, për të analizuar bashkërisht aspekte të bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Sugjerimet e tyre më kanë orientuar për punimin e temës.

Dua të falënderoj gjithashtu, udhëheqësin shkencor Prof.As.Dr. Irakli Koçollari, i cili ka qenë një mbështetje e madhe në të gjitha fazat e punimit dhe ditët doktrale të zhvilluara.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kapitulli I: HYRJE	1
I. Objekti dhe qëllimi i studimit.....	2
II. Cila është shtysa para studimit.....	3
III. Rëndësia e punimit.....	3
IV. Cili është modeli i studimit të bashkëpunimit policor ndërkombëtar.....	4
V. Cilët janë variablat e punimit.....	4
VI. Pyetjet qendrore dhe sekondare që ngre ky punim.....	6
VII. Metodologjia e kërkimit.....	6
VIII. Supozimet nistore.....	7
IX. Hipotezat e punimit.....	8
X. Indikatorët matës të bashkëpunimit policor sipas variablave.....	8
 Kapitulli II: ÇËSHTË BASHKËPUNIMI POLICOR NDËRKOMBËTAR.....	10
2.1 Koncepti i bashkëpunimit policor ndërkombëtar.....	10
2.2 Koncepti i bashkëpunimit ndërkombëtar sipas Traktatit të Bashkimit Europian.....	11
2.3 Rëndësia e bashkëpunimit policor ndërkombëtar dhe parimet e tij.....	12
2.4 Baza ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar.....	14
2.4.1. Traktatet dypalëshe të bashkëpunimit.....	19
2.4.2. Traktatet shumëpalëshe të bashkëpunimit.....	24
 Kapitulli III: BASHKËPUNIMIT POLICOR NË NIVEL GLOBAL.....	28
3.1 Bashkëpunimi policor ndërkombëtar përmes INTERPOL-it.....	28
3.2 Ç`është organizata policore ndërkombëtare Interpol.....	28
3.3 Krijimi i organizatës policore ndërkombëtare Interpol.....	29
3.4 Funksionimi i organizatës policore ndërkombëtare Interpol.....	29
3.5 Si realizohet komunikimi ndërmjet ZQK-ve, përmes kartelave paralajmëruese?.....	31

Kapitulli IV: BASHKËPUNIMIT POLICOR NË NIVEL RAJONAL.....	35
4.1 Bashkëpunimi policor përmes EUROPOL-it.....	35
4.1.1 Ç`është shërbimi policor europian EUROPOL, objekti dhe detyrat e tij.....	35
4.1.2 Çfarë suporti u jep EUROPOL-i vendeve anëtare?.....	38
4.1.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me EUROPOL-in.....	39
4.1.4 Si realizohet bashkëpunimi me EUROPOL dhe autoritetet kombëtare?.....	41
4.2 Bashkëpunimi policor përmes iniciativave rajonale në kuadër të SELEC.....	43
4.2.1 Qendra SECI për bashkëpunimin policor në Evropën Juglindore.....	43
4.2.2 Anëtarësimi në SELEC dhe detyrimet e shteteve anëtare.....	46
4.2.3 Iniciativat rajonale të SELEC dhe funksionimi i Task-forcave.....	47
4.2.4 Kanalet e komunikimit të SELEC me vendet anëtare.....	50
4.2.5 Roli i oficerëve ndërlidhës në kuadër të bashkëpunimit rajonal.....	52
Kapitulli V: BASHKËPUNIMIT POLICOR NË NIVEL DYPALËSH.....	56
5.1 Bashkëpunimi dypalësh për ekstradimin e personave.....	56
5.1.1 Legjislacioni për ekstradimin e personave të proceduar penalisht.....	56
5.1.2 Marrëveshja e ekstradimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	67
5.1.3 Marrëveshja e ekstradimit me Italinë.....	67
5.1.4 Marrëveshja e ekstradimit me Egjiptin.....	70
5.1.5 Marrëveshja e ekstradimit me Kosovën.....	72
5.2 Përfshirja e Mandat Arrestit European në legjislacionin kombëtar.....	74
5.2.1 Ç`është Mandat Arrestit European.....	74
5.2.2 Procedurat e MAE.....	74
5.2.3 Ku ndryshon MAE nga ekstradimi.....	76
5.2.4 Implementimi i MAE në sistemin ligjor kombëtar.....	78
5.3 Bashkëpunimi dypalësh për Menaxhimin e Integruar të Kufijve.....	79
5.3.1 Legjislacioni shqiptar për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve.....	80
5.3.2 Bashkëpunimi ndërkufitar me Republikën e Kosovës.....	83
5.3.3 Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Maqedoninë.....	85
5.3.4 Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Malin e Zi.....	87
5.3.5 Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Greqinë.....	90
5.3.6 Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Italinë.....	92
5.3.7 Risitë e bashkëpunimit dypalësh për kontrollin e kufijve.....	95

Kapitulli VI: BASHKËPUNIMI PËRMES KËRKESAVE DHE LETËRPOROSIVE.....	97
6.1 Njoftimet e akteve të procedimit penal.....	97
6.2 Marrja e akteve të tjera dhe provave të procedimit penal.....	99
6.3 Shkëmbimi i Letërporosive.....	101
6.3.1 Letërporositë nga jashtë shtetit.....	102
6.3.2 Letërporositë për jashtë shtetit.....	104
6.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të huaja.....	105
6.4.1. Legjislacioni për njohjen e vendimeve penale të huaja.....	107
 Kapitulli VII: BASHKËPUNIMI PËR OPERACIONE DHE HETIME TË PËRBASHKËTA.....	113
7.1 Krijimi dhe funksionimi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore.....	113
7.2 Bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër terrorizmit.....	120
7.3 Bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër trafikimit të njerëzve.....	126
7.3.1 Format e trafikimit ndërkombëtar të qenieve njerëzore.....	129
7.3.2 Masat legjislative kundër trafikimit të njerëzve.....	133
7.4 Bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër trafikimit të drogave.....	142
7.4.1 Pozicioni i Shqipërisë në trafikun e lëndëve narkotike.....	144
7.4.2 Masat specifike të luftës ndaj krimeve në fushën e drogave.....	146
7.4.3 Të dhëna statistikore të luftës kundër trafikut të drogave.....	149
7.4.4 Ku ka çeduar lufta kundër trafikut të drogës në Shqipëri?.....	151
7.5 Tregues të bashkëpunimit policor kundër krimit në kuadër të SELEC.....	151
 Kapitulli VIII: ANALIZË E NIVELIT DHE TENDENCAVE TË BASHKËPUNIMIT POLICOR KUNDËR KRIMIIT NDËRKOMBËTAR.....	157
 Kapitulli IX: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	159
 Shtojcë.....	163
 Bibliografia.....	172

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Foto 1:	Faqe e sistemit ASF2 të INTERPOL.....	31
Foto 2:	Kartelë e kuqe e shfaqur në sistemin ASF2 të Interpol për person në kërkim....	32
Foto 3:	Logo e EUROPOL.....	36
Foto 4:	Logo e Qendrës SECI.....	44
Foto 5:	Logo e SELEC.....	46
Foto 5:	Skema e shpërndarjes së oficerëve shqiptar ndërlidhës në vende të ndryshme...	54
Skema 1:	Shërbimi kufitar në vendet fqinjë.....	83
Skema 2:	Bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën.....	85
Skema 3:	Bashkëpunimit kufitar me Malin e Zi.....	90
Skema 4:	Pamje e kufirit tokësor Shqipëri – Greqi sipas seksioneve dhe piramidave.....	92
Tabela 1:	Tregues të veprave penale ndërkufitare, 2005 – 2013.....	96
Grafik 1:	Raste të operacioneve policore të trafikimit të femrave, realizuar me partnerët ndërkombëtar, dhe autorët e tyre, 2005 – 2012.....	140
Tabelë 2:	Operacione policore të përbashkëta për vitin 2012.....	140
Tabelë 3:	Autorët e veprës penale të trafikimit të femrave dhe të miturve, 2006 - 2013..	141
Grafik 2:	Numri i bimëve Cannabis Sattiva të asgjësuara në periudhën 2005 – 2012.....	149
Tabelë 4:	Drogë e sekuestruar në Itali me origjinë/tranzituara nga Shqipëria.....	150
Tabelë 5:	Operacionet ndërkombëtare të kryera në bashkëpunim.....	155

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

INTERPOL - Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale.

EUROPOL - Shërbimi Policor European.

SIENA - Sistemi i Sigurt i Komunikimit me EUROPOL.

ZKE - Zyra Kombëtare EUROPOL në Shqipëri.

ZNE - Zyrës Ndërlidhëse në EUROPOL.

ZQK - Zyra Qendrore Kombëtare.

ASF2 - Sistemi i Komunikimit ndërmjet ZQK-ve dhe INTERPOL.

BSEC - Iniciativave për bashkëpunimit ekonomik e vendeve të Detit të Zi

TBE - Traktati i Bashkimit European.

UNTOC - Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

UNCAC - Konventa e OKB-së Kundër Korrupsionit.

SEPCA - Shoqata e Krerëve të Policisë për Europën Juglindore.

SECI - Iniciativa e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore.

COSI - Komiteti mbi Sigurinë e Brendshme.

JHA - Çështjet e Brendshme dhe të Drejtësisë, të Bashkimit European.

ZKE - Zyra Kombëtare EUROPOL në Shqipëri.

SIENA - Sistem i komunikimit elektronik midis EUROPOL dhe ZKE.

WCO - World Customs Organization- Organizata Botërore e Doganave.

UNODC - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin.

SELEC - Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore.

JCC - Joint Cooperation Committee – Bordi Drejtues i SELEC.

SEECF - Procesi i bashkëpunimit në Evropën Juglindore.

SPOC - Iniciativa kundër krimit të organizuar.

RAI - Iniciativa kundër Korrupsionit.

SEEPAG - Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore.

SEPCA - Forcimi i Policisë, Asosacioni i Shteteve të Policisë në Evropën Juglindore.

MARRI - Iniciativa rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët.

WCO - Organizata Botërore e Doganave.

CARRIC - Qendra Rajonale aziatike për koordinimin e informacionit kundër narkotikëve.

EUBAM - Misioni i BE-së për Sigurinë e Kufijve të Moldavisë dhe Ukrainës.

PCC - SEE - Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore.

GAATW - Aleanca Globale Kundër Trafikut të Grave.

QNOD - Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

TIMS - Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit.

ICPC - Komisioni i Policisë Kriminale Ndërkombëtare.

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara.

BE - (EU) Bashkimi Europian.

ADN - Acidi Deoxyribonucleic.

I-24/7 - Sistemi global i komunikimit me Interpolin.

KP - Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

K.Pr.P - Kodi i Procedurës Penale.

PKK - Pikë e Kalimit Kufitar.

VKK - Vend i kalimit Kufitar.

VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave.

EPH - Ekipet e Përbashkëta Hetimore.

MAE - Mandat Arresti Europian.

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

OCTA-SEE - Vlerësimi i rrezikshmërisë ndaj Krimit të Organizuar.

FRONTEX - Agjencia Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Kapitulli I: HYRJE

Përshkrimi i strukturës së punimit

Tema “*Shqipëria dhe bashkëpunimi policor ndërkombëtar*”, ka si objekt bashkëpunimin policor ndërkombëtar të trajtuar në tre këndvështrime: bazuar në nivelet e bashkëpunimit, instrumentet ligjore (konventa, marrëveshje, traktate etj); dhe mekanizmat kryesor të bashkëpunimit. Struktura e temës është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të prek çdo aspekt të bashkëpunimit policor ndërmjet policive dhe organizatave policore ndërkombëtare, si INTERPOL, EUROPOL, SELEC, etj. Tema është e ndarë në katër pjesë, ku secila prej tyre është e ndarë në kapituj të veçantë.

Pjesa e Parë që trajton konceptin teorik të bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Në këtë pjesë janë përcaktuar qëllimi, hipotezat dhe metodologjia e përdorur. *Kapitullin I-rë* trajton legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar ku bazohet ky bashkëpunim, konventat shumëpalëshe dhe ato dy palëshe të nënshkruara nga vendi ynë, si dhe legjislacioni kombëtar penal e procedural me gjithë ndryshimet e bëra, me qëllim përfshirjen në të detyrimeve që rrjedhin nga këto konventa.

Pjesa e Dytë, trajton nivelet e bashkëpunimit policor ndërkombëtar, të cilat janë: *Niveli global* përmes organizatave ndërkombëtare siç janë Interpol dhe NATO, ku trajtohen mënyrat e funksionimit të këtij bashkëpunimi përmes kartelave paralajmëruese të saj, me qëllim gjetjen e njerëzve, sendeve apo dokumenteve të kërkuara, dhe kontributit policor në kuadër të angazhimeve si vend anëtar i NATO-s; *Niveli rajonal*, i fokusuar në bashkëpunimin përmes shërbimit policor europian - EUROPOL dhe iniciativave rajonale të Europës Juglindore përmes SELEC, ku trajtohen objektivat e këtij shërbimi, sporti për vendet anëtare, iniciativat rajonale të SELEC dhe krijimin e task-forcave kundër krimit, kanalet e komunikimit ndërmjet vendeve anëtare dhe rolin e oficerëve ndërlidhës në kuadër të këtij bashkëpunimi për shkëmbim informacioni, etj; dhe *Niveli dypalësh*, i cili kryesisht është i fokusuar në bashkëpunimin për ekstradimin e ndërsjellët të personave dhe

bashkëpunimin për parandalimin dhe goditjen e krimeve ndërkufitare. Çdo nivel bashkëpunimi përbën një kapitull më vete. (*Kapitulli II, III dhe IV*).

Pjesa e Tretë e punimit trajton mekanizmat kryesore të bashkëpunimit policor, dhe është e ndarë në dy kapituj (*Kapitulli V dhe VI*). *Kapitulli V-të* trajton bashkëpunimin përmes kërkesave dhe letër-porosive. Zakonisht ky bashkëpunim kryhet nga prokuroria dhe gjykata të cilat kanë kompetencat kryesore në hetimin dhe gjykimin e çështjeve, nëpërmjet kanaleve diplomatike, por në shumë raste kjo formë bashkëpunimi realizohet edhe ndërmjet organizatave policore të vendeve. Kapitulli trajton njoftimin e akteve, marrjen e provave të procedimit penal, shkëmbimin e letër-porosive, si dhe legjislacionin kombëtar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja. Ndërsa, *Kapitulli VI-të* trajton bashkëpunimin policor për operacione dhe hetime të përbashkëta, kryesisht i fokusuar në krijimin e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore me vendet partnere, bashkëpunimin kundër terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, trafikut të drogës etj, duke i konkretizuar me raste studimore për çdo formë bashkëpunimi, dhe analizuar statistikën vjetore të bashkëpunimit policor ndërkombëtar.

Pjesa e Katërt dhe e fundit e punimit përfshin analizën e tendencave dhe nivelit bashkëpunimit policor bazuar në hipotezat e ngritura, duke trajtuar disa raste studimore në faza të ndryshme. Punimi mbyllet me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, si dhe shoqërohet nga rubrika e apendikseve ku përfshihen tabela dhe grafikë të ndërtuara mbi kërkimet e bëra në terren lidhur me rezultatet e bashkëpunimit kundër krimit, në periudhën kohore 2000 - 2013.

I. Objekti dhe qëllimi i studimit

Objekti i temës është bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër krimit. Nëpërmjet kësaj teme synohet pasqyrimi i situatës aktuale në Shqipëri, për sa i përket bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër krimit transnacional, dhe aspekteve të trajtimit ligjor, efektshmërisë, problematikes dhe rasteve të trajtuara, parë në tre këndvështrimet qendrore të saj: ligjore, institucionale, dhe operacionale.

Qëllimi kryesor i punimit është analiza e nivelit dhe tendencave të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kriminalitetit bazuar në indikatorët matës, në kontekstin historik 2000 - 2013, evidentimi i problemeve aktuale në këtë fushë dhe pasqyrimi i disa rekomandimeve që mund të çojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve dhe zhdukjen e mangësive që i gjenerojnë ato.

II. Shtysa para studimit

Dy janë arsyet kryesore që çuan në përzgjedhjen dhe trajtimin e kësaj teme:

Së pari, rritja në numër dhe në lloje e veprimtarive të paligjshme që prekin më shumë se një shtet, si: krim i organizuar, trafikë të paligjshme etj. (Sipas statistikave kombëtare, të vendeve fqinje, dhe raporteve të organizatave ndërkombëtare).

Së dyti, rritja e rolit të bashkëpunimit policor të Shqipërisë me shtetet e tjera, për të luftuar krimet transnacionale. (Përshtatje të legjislacionit, shkëmbim i ndërsjellët i informacionit, harmonizim të veprimeve operacionale, hetime të përbashkëta).

III. Rëndësia e studimit


Bashkëpunimi policor ndërkombëtar është i rëndësishëm dhe ja vlen të studiohet për dy arsye kryesore:

Së pari, sepse aktivitetet e paligjshme, si krimi i organizuar, trafikët e të gjitha llojeve, terrorizmi etj, mund të shtrihen në disa shtete, pra, prekin disa juridiksione kombëtare; rrezikojnë sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë; dhe përballen suksesshëm vetëm përmes bashkëpunimit ndërkombëtar policor, por dhe agjencive ligjzbatuese.

Së dyti, sepse shkalla dhe efikasiteti i bashkëpunimi policor ndikon mbi ndjeshëm në: sigurinë e çdo vendi, përfshirë Shqipërinë; marrëdhëniet mes shteteve (përfshi ato të Shqipërisë me shtete të tjera); dhe mirëqenien e çdo individ, grupi, shoqërie, shteti (përfshi ato shqiptare).

IV. Cili është modeli i studimit të bashkëpunimit policor ndërkombëtar?

Punimi është ndërtuar mbi një model studimi, në qendër të të cilit është bashkëpunimi policor ndërkombëtar, trajtuar sipas tre niveleve: global, rajonal dhe dypalësh. Mekanizmat e bashkëpunimit, realizohen nëpërmjet kombinimit të instrumenteve ligjore dhe kuadrit operacional, sipas skemës së mëposhtme:



V. Cilët janë variablat e punimit?

Studimi bazohet në tre variabëla, një variabël i varur i cili është “Bashkëpunimi policor ndërkombëtar”, dhe dy variablat të pavarur, respektivisht: “Instrumentet ligjore” dhe “Kuatr operacionale”.

Ç`përfaqëson “*Bashkëpunimi policor ndërkombëtar*”, si variabël i varur?

- Dallon nga “bashkëpunimi ndërkombëtar” për nga: fokusi, baza ligjore, institucione, aktorët veprues, format e realizimit
- Gjen shprehje në tre nivele: global, rajonal, dhe bilateral;
- Shtrihet në fusha të ndryshme, si: krim i organizuar, trafikë ilegale, terrorizëm, menaxhim i kufijve;
- Shkalla e bashkëpunimit mund të variojë midis: e lartë, mesatar ose e ulët.

Ç'përfaqësojnë ***“Instrumentet ligjore”***, si variabël i pavarur?

- Ekzistojnë dhe përdoren në tipe të ndryshme, si: marrëveshje, konventa, protokolle, traktate, memorandume, karta, deklarata, pakte, statute, rezoluta, akte, ligje, vendime, rregullore, rekomandime, etj;
- Origjinojnë nga iniciativa ndërkombëtare ose kombëtare të shteteve, si: ndërkombëtare (nga marrëveshjet mes shteteve), ose kombëtare (nga ligje të legjislativit, vendime të ekzekutivit, akte titullarësh, kode, etj);
- Aplikohen nga shtetet në nivel global, rajonal, dypalësh;
- Dallojnë nga njeri-tjetri nga këto elemente, si: parimet mbi të cilat ngrihen fokusi dhe orientimi i tyre; marrëdhëniet dhe detyrimet që krijojnë me shtetin nënshkrues; hapësirën që i lënë shtetit nënshkrues për të refuzuar elemente të veçantë, etj.

Ç'përfaqëson ***“Kuatrri operacional”***, si variabël i pavarur?

- Ka karakter organizativ (shkëmbim informacioni, struktura, staf, pajisje, veprime operacionale, etj);
- Gjen shprehje në nivel global, rajonal, dypalësh, dhe kombëtar;
- Reflekton kapacitetin teknologjik dhe investimin konkret të një shteti në funksion të bashkëpunimit policor për parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit.

Cilat janë ***“Mekanizmat realizues”***, dhe ç'përfaqësojnë në model?

- Ekzistojnë në pesë forma kryesore:
 - si kërkesë dhe Letërporosi të paraqitura nga një shtet i interesuar;
 - si njohje dhe zbatim të vendimeve gjyqësore nga shtetet nënshkruese;
 - si ekstradim të një personi nga brenda-jashtë dhe anasjelltas të një shteti;
 - si hetime të përbashkëta për një aktivitet të paligjshëm nga dy ose më shumë shtete;
 - si menaxhim i integruar i kufirit nga dy ose më shumë shtete fqinje, etj.
- Lidhin variablat e pavarur (instrumentet ligjore dhe kuadrin operacional) me variabëlën e varur (bashkëpunimin policor ndërkombëtar);

- Dallohen nga njeri-tjetri prej:
 - objektivit të tyre;
 - veprimet/hapat që ndërmerren;
 - kushtet e realizimit që kërkojnë;
 - baza ligjore mbi të cilën mbështetet vënia në punë e mekanizmit;
 - agjentët që involvon vënia në punë e mekanizmit

VI. Pyetjet qendrore dhe sekondare që ngre ky punim

Pyetja qendrore:

1. Çfarë e shpjegon shkallën dhe dinamikat e bashkëpunimit policor në nivel global, rajonal dhe dypalësh, që vihet re në Shqipëri?

Pyetjet sekondare:

1. Në cilin nga nivelet e bashkëpunimit: global, rajonal apo dypalësh, Shqipëria është më aktive, dhe cilat janë dallimet dhe përparësitë e njerit apo tjetrit nivel?
2. Çfarë dinamikash karakterizojnë rolin e instrumentave ligjore në Shqipëri nga pikëpamja e tipeve dhe e përdorimit të tyre, në nivel: global, rajonal, dhe dypalësh?
3. Çfarë dinamikash vihen re në Shqipëri sa i takon kuadrit operacional nga pikëpamja e shkëmbimit të informacioneve dhe veprimeve operationale?
4. Cilët nga mekanizmat që materializojnë bashkëpunimin policor, vihen re se praktikohen më shumë në Shqipëri?

VII. Metodologjia e kërkimit

Gjatë studimit dhe hulumtimit të disertacionit janë përdorur metoda të ndryshme shkencore si, metoda e analizës, e studimit të rastit, e krahasimit, statistikë deskriptive e të dhënave, etj. Në punim bëhet një analizë e bashkëpunimit policor në nivel global, europian dhe dypalësh në lidhje me parandalimin, hetimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, terrorizmit ndërkombëtar, si dhe ekstradimin të subjekteve që i nënshtrohen

përgjegjësisë penale ndërkombëtare, në shekullin e ri (2000 - 2013), duke krahasuar të dhënat empirike të grumbulluara nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe duke parë evoluimin që ka pësuar ky bashkëpunim ndër vite. Përmes këtyre metodave dhe teknikave hulumtuese është arritur të provohet lidhja e ndërsjellët midis krimit të organizuar kombëtar dhe atij ndërkombëtar, si dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet shteteve për të patur sukses në këtë fushë.

Metodologjia përfshin gjithashtu, analizën juridike të veprave më të rënda kriminale në vend, të shkaqeve, pasojave, dhe ndryshimeve që ka pësuar kurba e kriminalitetit për periudhën analizuese, dhe tendencave të autorëve për tu përfshirë në krim, njëkohësisht në disa shtete. Do të bëhet analizë krahasuese e akteve ligjore të brendshme dhe ato ndërkombëtare, të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre, ndryshimet e bëra ndër vite, për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të vendeve partnere, dhe nevojat për përmirësime ligjore të tjera.

VIII. Supozimet nistore

Supozimet nistore mbi të cilat ngrihet bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër krimit janë identifikuar sipas variablave të studimit dhe fushës së bashkëpunimit, të pasqyruara si më poshtë:

- *Në një botë globale, krimi, trafiqet, terrorizmi, kontrollohen dhe luftohen më mirë përmes bashkëpunimit midis shteteve dhe agjencive të ligjit.*

Bashkëpunimin policor:

- Reflekton interesat e shteteve dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, d.m.th. ato angazhohen në bashkëpunim policor për shkak të perputhjes së interesave, për rritje të nivelit të tyre të sigurisë;
- Baza e bashkëpunimit mes shteteve dhe agjencive të tyre të ligjit është kriminaliteti i dyanshëm dhe reciprociteti.

Për Instrumentet ligjore:

- Legjitimiteti dhe juridiksioni i instrumentave ligjore që mbulojnë bashkëpunimin policor buron nga pranimi i tyre prej shteteve dhe agjencive të ligjit, mbi bazën e vullnetit të lirë dhe respektimit të të drejtave të njeriut;
- Standardet dhe autoriteti i instrumenteve ligjore ndërkombëtare që mbulojnë bashkëpunimin policor, marrin përparësi mbi ato kombëtare, vetëm kur shtetet dhe agjencitë e tyre të ligjit i pranojnë ato me vullnet të lirë, përmes përqafimit të tyre dhe kryerjes së ndryshimeve në legjislacionin kombëtar.

Për Kuadrin operacional:

- Praktikë e informimit dhe disponueshmëria e strukturave të zbatimit të ligjit, reflektojnë angazhimin e një shteti dhe përcaktojnë shkallën e bashkëpunimit policor dhe të suksesit të shteteve dhe agjencive të tyre në luftën kundër aktiviteve të paligjshme.

IX. Hipotezat e punimit

Hipoteza kryesore:

- *Bashkëpunimi policor me vendet partnere kundër krimit të organizuar karakterizohet nga tendenca në rritje e tij.*

Hipoteza sekondare:

- *Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale në fushën e ekstradimit, reflekton angazhim dhe rezultate konkrete të strukturave të zbatimit të ligjit.*

X. Indikatorët matës të bashkëpunimit policor sipas variablave

Për të analizuar nivelin e bashkëpunimit policor ndërkombëtar, identifikojmë më parë indikatorët matës të këtij bashkëpunimi, të cilët i rendisim si më poshtë:

Lidhur me bashkëpunimin policor:

- *Numri i fushave të bashkëpunimit.* Sa fusha vërehet se rrok bashkëpunimi policor në Shqipëri në nivel global, rajonal dhe dypalësh?
- *Numri i anëtarësimeve në organizmat ndërkombëtarë.* Në sa organizata/organizma me fokus bashkëpunimin policor vërehet se është antaresuar Shqipëria, në nivel global, rajonal dhe dypalësh?
- *Numri i llojeve të akteve të paligjshme.* Sa është numri i llojeve të akteve të paligjshme për luftimin e të cilave Shqipëria bashkëpunon?

Lidhur me instrumentat ligjore ndërkombëtare:

- *Numri i nënshkrimeve/ratifikimeve.* Sa instrumente legale ndërkombëtare ka nënshkruar Shqipëria, në nivel global, rajonal dhe dypalësh?
- *Numri i ndryshimeve të legjislacionit kombëtar.* Sa ligje ka miratuar apo ndryshuar Shqipëria pas ratifikimit të instrumentave nderkombetare, në nivel global, rajonal dhe dypalësh?
- *Numri i tipeve të instrumentave.* Sa është numri sipas tipeve, i instrumentave ndërkombëtare që ka përqafuar Shqipëria, në nivel global, rajonal dhe dypalësh?

Lidhur me bashkëpunimin policor operacional:

- *Volumi dhe praktikat e informimit.* Sa informacione janë shkëmbyer ndërmjet strukturave policore ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve partnere? Ç'tregon Shqipëria sa i përket informimit?
- *Numri i zyrave, stafit, pajisjeve.* Cila është gjendja aktuale në Shqipëri për sa i zyrave, stafit, pajisjeve, të destinuara për bashkëpunimin policor sipas niveleve?
- *Numri i operacioneve të përbashkëta.* Në sa operacione policore ndërkombëtare dhe hetime të përbashkëta ka marrë pjesë Shqipëria?

Kapitulli II: KONCEPTI I BASHKËPUNIMIT POLICOR

2.1 Koncepti i bashkëpunimit policor ndërkombëtar

Bashkëpunimi nënkupton koordinimin e masave dhe të veprimeve të palëve pjesëmarrëse për arritjen e një qëllimi të caktuar. Ky lloj bashkëpunimi bazohet në marrëveshje dhe akte të tjera ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë. Në përgjithësi, bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet nëpërmjet organizatave ndërkombëtare të tilla si: Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, Interpol, Organizata Botërore e Doganave, Europol, Eurojust, etj. Bashkëpunimi në kuadrin komunitar bazohet traktatet bazë të Bashkimit Evropian, Europol, instrumentet dhe marrëveshjet e ndryshme si, Marrëveshja Shengen etj. Ndërsa në kuadrin rajonal, bashkëpunimi policor realizohet nëpërmjet iniciativave të tilla si: ajo e vendeve të Detit të Zi¹ (BSEC), e vendeve të Evropës Juglindore (SECI), e vendeve të Evropës Qendrore dhe ajo e vendeve që lagen nga detet Adriatik e Jon, etj.

Ç'është bashkëpunimi policor ndërkombëtar?

Lidhur me këtë formë bashkëpunimi jepet ky përkufizim:

“Bashkëpunimi policor ndërkombëtar është një aktivitet i ndërsjellë midis organizatave, agjencive të zbatimit të ligjit që bazohet në parimet kryesore të fiksuara në dokumente të rëndësishme ndërkombëtare me qëllim shkëmbimin e informacioneve, kryerjen e operacioneve të përbashkëta pro-aktive si dhe planifikimin e veprimeve të koordinuara midis tyre”².

Bashkëpunimi policor ndërkombëtar përfshin shkëmbimin e informacionit ndërmjet agjencive kombëtare e lokale të zbatimit të ligjit, por edhe operacione dhe kontrole të përbashkëta si dhe planifikimi i veprimeve të bashkërenduara kundër aktiviteteve kriminale. Ai bazohet në disa traktate të Këshillit të Evropës dhe të Kombeve të Bashkuara (marrëveshje shumëpalëshe) dhe zhvillohet gjithashtu ndërmjet shteteve (marrëveshje dypalëshe).

¹ BSEC - Iniciativave e vendeve të Detit të Zi

² Dr.Hasan Shkëmbi: “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Evropian”, shtëpia botuese GEER 2006, Tiranë, faqe 204.

2.2 Koncepti i bashkëpunimit ndërkombëtar sipas Traktatit të Bashkimit Evropian

Bashkimi European zhvillon një bashkëpunim policor që shoqëron të gjitha autoritet kompetente të shteteve anëtare, duke përfshirë shërbimet e policisë, doganave dhe shërbimet e tjera shtypëse të specializuara në fushat e parandalimit ose zbulimit të shkeljeve penale dhe hetimeve në çështjet e tyre për:

- *Mbledhjen, grumbullimin, trajtimin, analizën dhe shkëmbimin e informacioneve të përshtatshme;*
- *Mbështetjen në formimin e personelit, si dhe bashkëpunimin lidhur me shkëmbimin e personelit, pajisjeve dhe në kërkimin kriminalistik;*
- *Teknikat e përbashkëta të hetimit lidhur me zbulimin e formave të rënda të krimit të organizuar*³.

Bashkëpunim ndërkombëtar policor është i lidhur ngushtë me atë gjyqësor në fushën penale, pasi një bashkëpunim i mirë mes policisë është shenjë e zhvillimit më të mirë të ndihmës gjyqësore. Lidhjet dhe ndryshimet ndërmjet tyre mund të identifikohen me disa arsye, si:

- Përgjithësisht, dallimi mes bashkëpunimit të policisë dhe atij gjyqësor nuk është i qartë në të gjitha vendet, pasi në disa sisteme të *common law* organet e policisë luajnë në fazën e hetimeve paraprake, të njëjtin rol që luhet nga autoriteti gjyqësor në pjesën më të madhe të vendeve të *civil law*;
- Të dy sistemet e bashkëpunimit plotësojnë njeri-tjetrin, ndonëse e kanë zanafillën në sistemin e bashkëpunimit të policisë, tani tërhiqen në drejtim të ndihmës gjyqësore. P.sh: rregullimi i veprimtarisë së infiltrimit të punonjësve të policisë në organizata dhe grupe kriminale, apo dhe në dorëzime të kontrolluara, për bashkëpunimin praktik të tyre kërkon një veprimtari të përbashkët të autoriteteve gjyqësore;
- Në disa raste, për efekte kohore me qëllim shkurtimin e procedurave burokratike, sistemi i bashkëpunimit gjyqësor mund të zëvendësohet me atë policor, si p.sh,

³ Neni 69/F, paragrafi 1, 2 i Traktatit të Bashkimit Evropian.

përdorimi i letër-porosisë mund të zëvendësohet më thjesht nga krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë mes forcave të policisë;

- Të dy format e bashkëpunimit burojnë nga e drejta ndërkombëtare, dhe kanë qëllim të njëjtë, krijimin e një hapësire të drejtësisë, lirisë dhe sigurisë.⁴

2.3 Rëndësia e bashkëpunimit policor ndërkombëtar dhe parimet e tij

Krimi i organizuar mund të ndodh brenda kufijve kombëtarë, në dy apo më shumë vende, gjë që mund të çojë në zhvillimin e hetimeve në disa juridiksione. Kështu që, në funksion të hetimeve është i domosdoshëm bashkëpunimi ndërmjet policive respektive. Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar është pranuar në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, për të cilat paraqesim disa shembuj:

- Synim parësor i Konventës së OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar është: *“bashkëpunimi ndërkombëtar për parandalimin dhe luftën kundër krimin të organizuar”*⁵.
- Qëllimi bazë i “Protokollit të OKB-së për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar” është: *“nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin, ndalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore”*.⁶
- Qëllimi bazë i “Protokollit kundër kalimit kontrabandë të migruesve me Tokë, Det dhe Ajër, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar” është: *“parandalimi dhe lufta kundër kalimit kontrabandë të*

⁴ Giovanni MELILLO - Prokurori Kombëtar i Antimafies italiane: “Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimin të organizuar: kërkimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi”, botuar në Manualin: “ITALI – SHQIPËRI: Instrumente ligjore dhe teknika të luftës kundër krimin të organizuar transnacional përballje përvojash”, Botues UNICRI (Torino, Itali), viti 2007, faqe 384.

⁵ UNTOC - “Konventa e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar” është ratifikuar nga parlamenti shqiptar me Ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar dhe dy Protokolleve Shtesë të saj”. Konventa u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në muajin nëntor të vitit 2000 dhe ka hyr në fuqi në muajin dhjetor të vitit 2003.

⁶ Protokollin e Palermos, 2000.

migruesve, si edhe nxitja e bashkëpunimit midis Shteteve Palë për këtë qëllim, duke mbrojtur, në të njëjtën kohë, të drejtat e migruesve të kaluar kontrabandë”⁷. Në Konventë është përfshirë një deklaratë e cila thotë se veprimi i efektshëm për të parandaluar dhe luftuar kalimin kontrabandë të migruesve kërkon një qasje të plotë ndërkombëtare, përfshirë edhe bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe masa të tjera të duhura.

- “Konventa Kuadër e OKB-së kundër Korrupsionit”⁸ (UNCAC), theksojnë rëndësinë qendrore të bashkëpunimit ndërkombëtar si një mjet me rëndësi kritike për eliminimin e bazave të kriminelëve.
- “Konventat Evropiane për Ndihmën Reciproke në Çështjet Penale dhe Ekstradimin” dhe Protokollet e tyre i detyrojnë shtetet nënshkruese të miratojnë ligje të përbashkëta në fushat e ndihmës së ndërsjellët juridike dhe ekstradimit.
- “Konventa për Bashkëpunimin Policor për Evropën Juglindore” thekson: *“palët duhet ta forcojnë bashkëpunimin e Palëve të Kontraktuara në lidhje me luftën kundër rreziqeve që i kanosen sigurisë publike dhe/ose rendit publik si edhe në lidhje me parandalimin, zbulimin dhe hetimit policor të veprave penale*”⁹.
- “Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara”¹⁰ përcakton fushat dhe format¹¹ e bashkëpunimit të ndërsjellët. Sipas marrëveshjes fusha e bashkëpunimit përfshin:

⁷ Protokoll i OKB për kontrabandën, miratuar në Dhjetor 2000.

⁸ UNCAC - “Konventa Kuadër e OKB-së kundër Korrupsionit” e cila hyri në fuqi në vitin 2005.

⁹ Shih: Neni 1 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (PCC SEE), miratuar më datë 05.05.2006.

¹⁰ Ratifikuar me ligjin nr. 8512, datë 15.7.1999, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara”, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, faqe 809. Qeveritë e vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC) nënshkruese të Marrëveshjes janë: Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Gjeorgjia, Republika Helenike, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Republika e Turqisë, Ukraina, të cilat më pas do të quhen “Palë”.

¹¹ Format e bashkëpunimit i paraqet Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje.

parandalimin, shtypjen, zbulimin, mbylljen dhe investigimin e krimeve dhe në veçanti të:

- “- akteve të terrorizmit;
- krimit të organizuar;
- kultivimit të paligjshëm, prodhimit, përpunimit dhe trafikut të narkotikëve dhe substancave psikotrope;
- përpunimit ilegal, tregtimit ilegal dhe përdorimit të prekursorëve dhe lëndëve bazë për prodhimin ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope;
- trafikut të paligjshëm të armëve, duke përfshirë armët biologjike, kimike dhe radioaktive, municionet, eksplozivet, materialet nukleare dhe radioaktive, si dhe substancat helmuese;
- aktivitetet ndërkombëtare ilegale ekonomike dhe legalizimit të aktivitetet (pastrimi i parasë) që rrjedhin nga aktivitetet kriminale, transaksione të dyshimta ekonomike dhe transaksione bankare dhe abuzime në fushën e investimeve;
- kontrabandës;
- aktivitetet kriminale të lidhura me migracionin, kalimin ilegal të kufirit dhe trafikun ilegal të qenieve njerëzore;
- shfrytëzimit seksual të grave dhe të miturve apo fëmijëve;
- falsifikimit të kartëmonedhave, kartave të kreditit, dokumenteve, sigurimeve dhe vlerave të tjera, si dhe çdo lloj dokumenti identiteti;
- krimet e dhunshme kundër jetës dhe pronës së njerëzve;
- trafikut ilegal të objekteve të trashëgimisë historike dhe kulturore, veprave të artit, gurëve dhe materialeve të çmuara, pronësisë intelektuale si dhe të çdo lloj materiali tjetër të vlefshëm;
- korrupsionit
- krimit ekologjik;
- krimit teknologjik, duke përfshirë krimin kompjuterik
- marrjes peng dhe tregtimit të njerëzve dhe organeve
- krimeve detare (grabitje detare, pirateri etj);
- vjedhjeve dhe trafikut ilegal të automjeteve”¹².

2.4 Baza ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar

Është thelbësore të përcaktohet baza ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar. Përmes përcaktimit të bazës ligjore të një mase, nëpunësi i drejtësisë penale mund të jetë i sigurt se kompetenca po ushtrohet si duhet dhe se rezultatet e bashkëpunimit mund të përdoren sipas mënyrës për të cilën janë parashikuar. Verifikimi i bazës ligjore zakonisht siguron edhe

¹² Shih: Neni 1 i Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara”.

informacion të rëndësishëm për objektin dhe natyrën e instrumentit përkatës të bashkëpunimit. Si bazë ligjore shërbejnë dokumentet e mëposhtme:

- Kushtetuta dhe legjislacioni kombëtar;
- Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
- Traktati i BE/Mastricht, 1992, nenet 29 dhe 30 “Bashkëpunimi Policor”;
- Traktati i Lisbonës, neni 69/F/G “Bashkëpunimi Policor”;
- Konventa Shengen, e vitit 1990;
- Konventa Europol, e vitit 1995;
- Traktati i Amsterdimit, i vitit 1997;
- Traktati Nicës, i vitit 2003, etj.

Rast për të analizuar, lidhur me referencat ligjore ndërkombëtare për bashkëpunim policor të ndërsjellët, marrim një marrëveshje të ratifikuar nga legjislativi shqiptar, dhe konkretisht, Marrëveshjen ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi “*Për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në veçanti në forma të tij të organizuara*”.¹³ Kjo Marrëveshje parashikon, se, qeveritë e vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC) nënshkruese të Marrëveshjes janë: Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Gjeorgjia, Republika Helenike, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Republika e Turqisë, Ukraina, angazhohen të bashkëpunojnë, për faktin se, krimi kombëtar dhe ndërkombëtar, në të gjithë format e tij, përbën një rrezik serioz për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e qenieve njerëzore dhe në të njëjtën kohë ndikon mbi themelet ekonomike, kulturore dhe politike të shoqërisë. Gjithashtu, marrëveshja parashikon fushat e bashkëpunimit të cilat do të realizohen nëpërmjet:

“- shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencës në fusha me interes të përbashkët;
- shkëmbimit të informacionit për parandalimin dhe shtypjen e çdo forme të krimit trans-kombëtar, në veçanti të gjitha aktet e terrorizmit, krimi të organizuar, trafikut ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope, armëve dhe materialeve radioaktive, aktiviteteve

¹³ Marrëveshja është firmosur në Korfuz më 2 tetor 1998, dhe është ratifikuar me ligjin nr. 8512, datë 15.7.1999. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, faqe 809.

kriminale që lidhen me migracionin, duke përfshirë informacionin në lidhje me rrjete individuale dhe kriminale të përfshira në krimin trans-kombëtar;

- planifikimin dhe adoptimin e aksioneve të koordinuara kundër rrjeteve kriminale;

- kërkimin e individëve të larguar nga hetimi i krimeve apo vuajtja e dënimit, si dhe ata që janë raportuar të humbur;

- shkëmbimin e informacionit në lidhje me figurat e reja të krimit, metodat dhe format e parandalimit, shtypjes dhe hetimit të tij;

- asistencë në hetimin e transfertave të dyshimta bankare dhe financiare, duke përfshirë ato që kanë lidhje me legalizimin e aktiviteteve kriminale;

- shkëmbimin e eksperiencës mbi përdorimin e metodave shkencore dhe teknologjike dhe mjetet për kërkimet shkencore dhe kriminologjike, veçanërisht në fushën e hetimit dhe kontrollit të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në përputhje me ligjet ndërkombëtare;

- shkëmbimin e informacionit në lidhje me metodat e përdorura për transportimin, fshehjen dhe shpërndarjen e drogave narkotike dhe substancave psikotrope;

- marrjen e masave të domosdoshme ligjore, administrative dhe të sigurisë në kufijtë e tyre në mënyrë që të parandalohet kontrabanda, veçanërisht të drogave narkotike dhe substancave psikotrope;

- shkëmbimin e informacionit mbi tipet e reja të drogave dhe substancave psikotrope që shfaqen gjatë trafikimit të paligjshëm, teknologjive të përpunimit dhe substancave të përdorura për këto, po ashtu si dhe metodave të reja të kërkimeve të përdorura, në analizat për identifikimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope;

- shkëmbimin e informacionit mbi lidhjet e trafikut të paligjshëm të drogës dhe substancave psikotrope me terrorizmin dhe krimin e organizuar;

- shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe eksperiencës në fushën e kontrollit të kufirit dhe mbështetjes materiale dhe teknike të shërbimeve kompetente për hetimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit si dhe për parandalimin e hyrjes së paligjshme të personave të dyshuar

të përfshirë në akte kriminale e veçanërisht terroriste si dhe aktivitete të lidhura me migracionin;

- shkëmbimin e eksperiencës së punës, përfshirë këtu kurse, konsultime, seminare dhe kurse trajnimi;

- shkëmbimin e të dhënave statistikore si dhe ligjeve dhe dispozitave kombëtare, broshurave, botimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore në fushat e mbuluara nga kjo Marrëveshje;

- organizimin e mbledhjeve të ekspertëve brenda kompetencave të tyre, kurdoherë që të gjykohet nga vetë ata të jetë e domosdoshme për t'u marrë me çështje që mendohet se janë të interesit të tyre të përbashkët;

- kërkimin dhe kthimin, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të objekteve të vjedhura duke poseduar numra ose shenja të tyre, përfshirë këtu edhe ato me vlera kulturore dhe historike, automjeteve dhe armëve të zjarrit, si dhe dokumenteve të identifikimit dhe pasaportave;

- shkëmbimin e informacionit në lidhje me qytetarët e Shteteve dhe të Palëve të tjera të dënuar për krime të kryera në territoret e Shteteve të tyre, si dhe individëve nën hetim”.¹⁴

Ndërsa, Protokolli Shtesë i kësaj marrëveshje, theksoni se, informacioni me interes të ndërsjellë, do të shkëmbehet në mënyrë të veçantë, për:

- a) aktet e terrorizmit të planifikuara dhe të drejtuara kundër udhëheqësit të shtetit, personave që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare, anëtarëve të misioneve dhe konsullatave diplomatike, zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, pjesëmarrësve në vizita shtetërore, si dhe në ngjarje kombëtare/ndërkombëtare dhe kundër zyrtarëve dhe civilëve;
- b) organizatat terroriste, grupet ose personat terroristë që paraqesin kërcënim për sigurinë e shteteve të tyre, si dhe kontaktet ndërmjet këtyre organizatave terroriste, grupeve apo personave terroristë;
- c) tentativat dhe aksionet terroriste të drejtuara kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve të Palëve;
- d) aktet e terrorizmit dhe kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla në territorin e shteteve të Palëve, kundër qendrave ekonomike, teknologjike dhe ekologjike dhe sistemeve të rëndësishme jetike;
- e) organizatat dhe grupet terroriste që veprojnë në territorin e shteteve të Palëve, taktikat dhe metodat e tyre, udhëheqësit, anëtarët, si dhe personat e përfshirë në dhe/ose mbështetjen e aktiviteteve të këtyre grupeve ose organizatave;
- f) organizatat dhe institucionet që mbështesin terrorizmin, për mekanizmat, përhapjen dhe drejtimin e kësaj mbështetje;
- g) trafikimin e paligjshëm të armëve, përfshirë municioneve, lëndëve eksplozive dhe kurtheve me eksploziva, materialeve dhe burimeve bërthamore dhe radioaktive, armëve kimike dhe biologjike dhe komponentëve të tyre, të kryer nga personat dhe grupimet e organizuara kriminale, kanalet e përdorura për transportimin e paligjshëm të tyre nëpër territorin e shteteve të Palëve;
- h) burimet e zbuluara dhe të dyshuara dhe kanalet e mbështetjes financiare logjistike ose llojeve të tjera të mbështetjes materiale për organizatat dhe grupet terroriste;
- i) praktikën dhe legjislacionin mbi kundër-terrorizmin”.¹⁵

Gjithashtu, Protokolli Shtesë thekson se, Palët do të punojnë dhe do të kryejnë bashkëpunim të ngushtë, në mënyrë të veçantë për:

¹⁴ Shih: Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi “Për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në veçanti në forma të tij të organizuara”. (Protokolli shtesë).

¹⁵ Shih: Neni 5 i Protokollit Shtesë për luftën kundër terrorizmit i “Marrëveshjes midis qeverive të shteteve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht të organizuar të tij”.

“a) shtypjen e përgatitjes dhe kryerjes së akteve të terrorizmit, si dhe të dhënies për terroristët së ndonjë forme të mbështetjes, përfshirë mbështetjen financiare;
b) refuzimin e strehës së sigurisë për ata që financojnë, planifikojnë, mbështesin ose kryejnë akte terroriste;
c) zbulimin dhe shkatërrimin e vendeve ku kryhet stërvitja e terroristëve, planifikimi dhe përgatitja e akteve të terrorizmit, nëse paraqiten evidenca konkrete;
d) parandalimin e lëvizjes dhe shkatërrimin e segmenteve të udhëtimit të terroristëve dhe grupeve terroriste;
e) zbulimin dhe identifikimin e strukturave të përdorura nga grupet ose organizatat terroriste për fshehjen e aktiviteteve të tyre;
*f) parandalimin, zbulimin dhe goditjen e mbështetjes financiare, shpërndarjes së armëve dhe municioneve, substancave eksplozive, kurtheve me eksploziva, materialeve dhe burimeve bërthamore dhe radioaktive, armëve kimike dhe biologjike dhe komponentëve të tyre, si edhe dhënien e çdo asistence për personat apo organizatat për planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e akteve të terrorizmit”.*¹⁶

Po sipas Protokollit të sipërcituar, Palët kanë detyrimin që të njoftojnë njëra-tjetrën për rezultatet e aksioneve bashkëpunuese. Pra, marrëveshjet në tërësi, si ato bilaterale dhe multilaterale, paraqesin një rendësi të veçantë në drejtim të luftës kundër kriminalitetit me përmasa trans-nacionale, për faktin se paraqesin fushën dhe format e bashkëpunimit, kanalet e komunikimit dhe gjithë modalitetet e implementimit të tij nga agjencitë ligjzbatuese të shteteve nënshkruese. Shtetet dhe grupet e shteteve që punojnë përmes organizatave ndërqeveritare kanë krijuar një rrjet kompleks traktatesh dypalëshe dhe shumëpalëshe, të cilët ofrojnë një bazë ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar. Bashkëpunimi i mbështetur në traktate ka avantazhe praktike dhe strategjike.

Së pari, një traktat e detyron një shtet të cilit i drejtohet kërkesa, të bashkëpunojë sipas së drejtës ndërkombëtare;

Së dyti, traktatet përmbajnë dispozita të hollësishme për procedurën dhe parametrat e bashkëpunimit;

¹⁶ Shih: Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi “Për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në veçanti në forma të tij të organizuara”. (Protokolli shtesë).

Së fundi, traktatet mund të parashikojnë forma bashkëpunimi të cilat, përndryshe, nuk do të ishin të mundura.¹⁷

2.4.1. Traktatet dypalëshe të bashkëpunimit

Traktatet dypalëshe lidhen ndërmjet vendeve me qëllim të plotësojnë interesat e vendeve duke u bazuar në traktatet ndërkombëtare në harmonizim me sistemet juridike të brendshme. Kryesisht traktate dypalëshe kanë në fokus ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellët juridike. Shqipëria është bërë pjesë e çdo iniciative ndërkombëtare që i shërben luftës kundër krimit, nëpërmjet ratifikimit të disa akteve ndërkombëtare në fushën penale, duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime (këtu mund të përmendim, *“Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për ekstradimin”*), si dhe ka bërë pjesë të sistemit të saj të brendshëm disa nga konventat kuadër të Këshillit të Europës në të cilat është parashikuar ekstradimi si një mjet efikas që i shërben me efikasitet luftës kundër krimit. Përmendim këtu disa dokumente tepër të rëndësishme, si:

- Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale¹⁸;
- Konventa Europiane *“Për ekstradimin”*¹⁹;
- Konventa *“Për transferimin e procedimeve penale”*;²⁰
- Konventa Europiane *“Për shtypjen e terrorizmit”*;²¹
- Konventa *“Për transferimin e personave të dënuar”*;²²
- Konventa *“Për ndihmën e ndërsjellët juridike”*;²³
- Konventa Evropiane *“Për të drejtat e njeriut”*;²⁴

¹⁷ “Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kalimi kontrabandë i migrantëve” (Udhëzues për bashkëpunimin ndërkombëtar), përgatitur nga Zyra e Programit Rajonal për Evropën Juglindore, botuar në gjuhën shqipe nga UNODC, Tiranë, shkurt 2010.

¹⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8984, datë 23.12.2002.

¹⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998.

²⁰ Ratifikuar me ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999.

²¹ Ratifikuar me ligjin nr. 8642, datë 13.07.2000.

²² Ratifikuar me ligjin nr. 8499, datë 10.06.1999.

²³ Ratifikuar me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999.

²⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998.

- Konventa "Për ndjekjen e tregtisë së qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të korrupsionit të tjerëve";
- Konventën Penale Evropiane për Korrupsionin,²⁵ etj.

Gjithashtu, vendi ynë bazuar në legjislacionin e brendshëm,²⁶ ka ratifikuar edhe një sërë marrëveshesh dypalëshe ekstradimi, ku bëjnë pjesë:

- Marrëveshje ekstradimi me Greqinë²⁷, të vitit 1993;
- Marrëveshje ekstradimi me Maqedoninë,²⁸ të vitit 1998;
- Marrëveshje ekstradimi me Republikën Arabe të Egjiptit,²⁹ të vitit 2004;
- Marrëveshje ekstradimi me Republikën e Italisë³⁰, të 2011,
- Marrëveshje ekstradimi me Republikën e Kosovës³¹, të vitit 2013, etj.

Edhe gjatë periudhës së qeverisë së Zogut, shteti ka lidhur marrëveshje dypalëshe ekstradimi, të cilat përcaktonin rregulla të detyrueshme mes Mbretërisë Shqiptare dhe shteteve të mëposhtme, në fushën e ekstradimeve, të tilla si:

- Marrëveshje ekstradimi me Kroacinë, në vitin 1926³²;

²⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001.

²⁶ Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 39, paragrafi 2 thekson se: "Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor". Ndërsa neni 122 parashikon se: "Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të".

²⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 7760, datë 14.10.1993

²⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8299, datë 04.03.1998.

²⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 9214, datë 01.04.2004.

³⁰ "Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin e 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmën Juridike për Çështjet Penale" të 20 prillit 1959, ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, e cila hyri në fuqi më datë 01.08.2011.

³¹ Ratifikuar me ligjin nr. 2/2013, datë 31.01.2013. Në Kapitullin I, Parimet e përgjithshme, Neni 1- Detyrimi për ekstradim, parashikon se: "Palët marrin përsipër të dorëzojnë te njëra-tjetra, sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat kundër, të cilëve autoritetet kompetente të palës kërkuuese kanë filluar procedurën gjyqësore për veprë penale ose që janë të kërkuar nga autoritetet e saj për ekzekutimin e një dënimi apo urdhër-arresti". Ndërsa Neni 6- Ekstradimet e shtetasve, parashikon se: "Palët marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. Palët nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit".

³² H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, "Procedura Penale – Komentar", botimet "Morava", Tiranë 2003, faqe 652.

- Marrëveshje ekstradimi me Britaninë e Madhe³³, të vitit 1927;
- Marrëveshje ekstradimi me SHBA-në³⁴, të vitit 1935.

Gjithashtu, duhet theksuar se, edhe gjatë sistemit totalitar në Shqipëri, qeveritë komuniste kanë miratuar dhe marrëveshje të tjera dypalëshe me shtete të tjera, lidhur me bashkëpunimin ndërshtetëror në fushën penale, të cilat sjellin si pengesë kryesore për ekstradim çështjen e shtetësisë, pra ato identifikojnë fushat dhe mekanizmat e bashkëpunimit në fushën penale, por refuzojnë ekstradimin e shtetasve të vet, të tilla si:

- Konventa për ndihmë juridike me Bashkimin Sovjetik,³⁵ të vitit 1958;
- Konventa për ndihmë juridike me Gjermaninë³⁶, të vitit 1959;
- Konventa për ndihmë juridike me Çekosllovakinë³⁷, të vitit 1959;

³³ <http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&kid=231>

³⁴ Traktati u nënshkrua në Tiranë më, datë 1 mars 1933. Senati e dhe pëlqimin për ratifikim më datë 2 shkurt 1934. Traktati u ratifikua nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 21 shkurt 1934. Traktati është ratifikuar nga Shqipëria më 20 prill 1935. Ratifikimet u shkëmbyen në Uashington DC, më 14 nëntor 1935. Traktati hyri në fuqi 14 nëntor 1935, dhe u shpall nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 19 nëntor 1935.

http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_United_States_extradition_treaties

³⁵ Nënshkruar në Moskë në vitin 1958. Neni 4 -Vëllimi i ndihmës juridike, thekson llojet e ndihmave juridike: “Palët Kontraktonjëse i japin ndihmë juridike njëra tjetrës me anë të kryerjes së veprimeve të veçanta procedurale në veçanti me anë të përpilimit dhe dërgimit të dokumenteve, të kryerjes së këqyrjeve, përfshirjeve, të dërgimit dhe dorëzimit të provave materiale, të kryerjes së ekspertimeve, të pyetjes së pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, të pyetjes së palëve dhe të personave të tjerë, të këqyrjes drejt për drejt nga Gjykata, si dhe me anë të dorëzimit të dokumenteve”. Risi e konventës është mbrojtja e dëshmitarëve dhe e ekspertëve. Kështu, Neni 8 - Paprekshmëria e dëshmitarëve dhe e ekspertëve, thekson se: “Dëshmitari ose eksperti, që me ftesë të dërguar institucionit të drejtësisë të Palës Kontraktonjëse, së cilës i është drejtuar porosia, paraqitet në institucionin e Palës Kontraktonjëse që ka bërë porosinë, nuk mund të merret, pavarësisht nga shtetësia e tij, në përgjegjësi penale, ose të ndalet, ose të vuajë në territorin e saj dënim penal për krim të kryer para se të kalonte kufirin e saj shtetëror”.

³⁶ Konventë midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Demokratike Gjermanë “Mbi dhënien e Ndihmës Juridike për Çështje Civile, Familjare dhe Penale, bërë në Berlin më 11.01.1959. Në Kapitullin e II-të - Ndihma juridike në çështjet penale, Neni 56 - **Dorëzimi i fajtorëve**, parashikon se: “Palët Kontraktonjëse, në përputhje me këtë Konventë, në bazë të kërkesës, i dorëzojnë njëra tjetrës personat, kundër të cilëve duhet të fillojë ndjekja penale, ose duhet të ekzekutohet vendimi. Dorëzimi bëhet vetëm për ato vepra të cilat, në përputhje me legjislacionin e të dy Palëve Kontraktonjëse, janë të dënueshme dhe për kryerjen e të cilave ligja parashikon dënim me heqje të lirisë për më shumë se një vit, ose një dënim më të rëndë (që më tutje do të quhen “krime që shkaktojnë dorëzimin”)”. Ndërsa Neni 57 - **Refuzimi i dorëzimit**, parashikon rastet e mos dorëzimit, ku thekson se: “Dorëzimi nuk mund të bëhet kur personi, dorëzimi i të cilit kërkohet, është shtetas i palës Kontraktonjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa”.

³⁷ Konventë midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Çekosllovake mbi dhënien e ndihmës juridike për çështjet civile, familjare dhe penale, është nënshkruar në Pragë më 16.01.1959. Kapitulli II- Ndihma juridike për çështje penale, Neni 52- **Detyrimi për dorëzimin**, thekson se: “Palët Kontraktonjëse

- Konventa për ndihmë juridike me Rumaninë³⁸, e vitit 1961, etj.

Në vijim, shteti shqiptar ka nënshkruar marrëveshje të tjera bashkëpunimi në fushën penale me vende të ndryshme, të cilat aktualisht janë duke u zbatuar nga strukturat ligjzbatuese, si p.sh:

- Konventa me Greqinë për transferimin e të burgosurve, të vitit 1993;
- Konventa me Greqinë për zbatimin reciprok të vendimeve penale, e vitit 1993;
- Konventa për ndihmë gjyqësore me Greqinë, e vitit 1993;
- Marrëveshje për ndihmë juridike me Turqinë, e vitit 1995;
- Marrëveshje me Slloveninë për luftën kundër krimit, të vitit 1998;
- Marrëveshje me Maqedoninë për ekzekutimin e vendimeve penale, të vitit 1998;
- Marrëveshje për ndihmë juridike me Maqedoninë, e vitit 1998;
- Marrëveshje me Hungarinë për luftën kundër krimit, e vitit 2000;
- Marrëveshje me Rumaninë për luftën kundër krimit³⁹, e vitit 2002;

detyrohen, në baze të kërkesës, t'i dorëzojnë njëra tjetrës personat, që ndodhen në territorin e tyre për të marrë në përgjegjësi penale ose për të vënë në ekzekutim vendimin penal. Dorëzimi lejohet vetëm për krime të atilla, kryerja e të cilëve mund të sjellë me vehte, sipas legjislacionit të të dy Palëve Kontraktgjëse, dënime me heqjen e lirisë për një kohë më të gjatë se një vit, ose një dënim më të rëndë (më tutje do të quhen "krime që sjellin me vehte dorëzimin)". Ndërsa Neni 53, pika "a"- **Refuzimi për dorëzim**, parashikon refuzimin ekstradimit, ku thekson se: "Dorëzimi nuk mund të bëhet në qoftë se personi, dorëzimi i të cilit kërkohet, është shtetas i Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa". Konventa gjithashtu, trajton mbrojtjen juridike e njëjlojtë, e cila nënkupton detyrimin e shteteve nënshkruese që t'ju ofrojnë shtetasve të palës tjetër kontraktgjëse trajtim të barabartë me shtetasit e tyre, ku shtetet nënshkruese marrin përsipër që t'i ofrojnë njëri-tjetrit ndihmë juridike për kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale për marrjen e provave. Marrëveshja dypalëshe përcakton, se, dokumentet zyrtare të përpiluara apo të vërtetuara në shtetin tjetër kanë të njëjtën vlerë provuese, ashtu sikurse aktet zyrtare të brendshme. Ajo gjithashtu trajton, kushtet, procedurat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të shtetit tjetër.

³⁸ "Konventa midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore Rumune, mbi dhënien e ndihmës juridike për çështjet civile, familjare dhe penale", ratifikuar me Dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, më datë 17.04.1961. Në Kapitullin II, Ndihma juridike në çështjet penale, Neni 56-**Detyrim për dorëzim**, parashikon se: "Palët i dorëzojnë njëra-tjetrës personat që ndodhen në territorin e tyre, kundër të cilëve duhet të filloj çështja penale, gjykimi, ose duhet të ekzekutohet ndonjë vendim penal, për ato krime të cilat në përputhje me legjislacionin e të dy palëve, të dënueshme për më shumë se sa një vit". Edhe në këtë marrëveshje nuk gjen zbatim ekstradimi i shtetasve për shkak të shtetësisë së tyre.

³⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 8945, datë 03.10.2012, Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme".

- Protokoll i mirëkuptimit me Italinë për bashkëpunim policor kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali”,⁴⁰ e vitit 2003;
- Marrëveshje me Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale”⁴¹, e vitit 2003;
- Marrëveshje me Italinë për transferimin e personave të dënuar⁴², e vitit 2004;
- Marrëveshje me Maqedoninë për luftën kundër krimit⁴³, të vitit 2004;
- Marrëveshje me UNMIK për transferimin e personave të dënuar⁴⁴, të vitit 2005;
- Marrëveshje me Mbretërinë e Belgjikës për bashkëpunimin policor , të vitit 2005;⁴⁵
- Marrëveshje me Bullgarinë për ndihmë të ndërsjellët juridike.⁴⁶ të vitit 2005;
- Marrëveshje me Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit⁴⁷, të vitit 2006;
- Marrëveshje me Italinë, për ekstradim të ndërsjellët të personave⁴⁸, të vitit 2008;

⁴⁰ Ratifikuar me ligjin nr. 9019, datë 06.03.2013, Për ratifikimin e “Protokollit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali”.

⁴¹ Ratifikuar me ligjin nr. 9081 date 19.06.2013, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale”.

⁴² Ratifikuar me ligjin nr. 9169, datë 22.01.2004, “Për ratifikimin e Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të 21 marsit 1983 “Për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë”.

⁴³ Ratifikuar me ligjin nr. 9307, datë 04.11.2004, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme”.

⁴⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 9496, datë 20.3.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar”.

⁴⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 9427, datë 13.10.2005, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për bashkëpunimin policor”.

⁴⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 9348, datë 24.02.2005, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellët juridike në çështjet civile”.

⁴⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 9505, datë 03.04.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit”, të vitit 2006.

- Marrëveshje me Spanjën për bashkëpunim në luftën kundër krimit⁴⁹, të vitit 2009;
- Marrëveshje me Çekinë për bashkëpunim në luftën kundër krimit,⁵⁰ të vitit 2009;

Duhet theksuar se, këto marrëveshje rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale midis shteteve nënshkruese, lidhur me format e bashkëpunimit të ndërsjellët për çështjet penale, si: të kryerjes së këqyrjeve; të dërgimit dhe dorëzimit të provave materiale; të kryerjes së ekspertimeve; të pyetjes së të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, të pyetjes së palëve dhe të personave të tjerë; të këqyrjes drejt për drejt nga Gjykata; të dorëzimit të dokumenteve; të ekstradimit dhe rastet e refuzimit; njohja e ndërsjellët e vendimeve penale, etj.

2.4.2. Traktatet shumëpalëshe të bashkëpunimit

Janë të rëndësishme në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, pasi lidhen me çështje me interes global, të tilla si: terrorizmi, trafiku i qenieve njerëzore, trafiku i drogës, korrupsioni, krimi organizuar etj. Këto traktate marrin fuqi pasi të jenë ratifikuar nga legjislativi kombëtar i vendeve anëtare. Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër i traktateve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale që krijojnë detyrime për shtetet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimi kontrabandë i migruesve.

a. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)

Konventa⁵¹ identifikon dhe nxit bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet vendeve anëtare lidhur me çështje globale, me qëllim marrjen e masave kundër krimit të organizuar

⁴⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për ndihmë juridike për çështjet penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre”, hyrë në fuqi në 01.08.2011.

⁴⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 10155, datë 15.10.2009, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

⁵⁰ Ratifikuar me ligjin nr. 10162, datë 15.10.2009, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

ndërkombëtar, dhe formave të tjera të krimit. Konventa identifikon bashkëpunimin dhe krijon detyrime për shtetet nënshkruese lidhur me çështje të tilla si:

- *Bashkëpunimin ndërkombëtar për grumbullimin dhe shkëmbimin e informacionit kriminal;*
- *Bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet forcave ligjzbatuese për konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga veprat penale;*
- *Juridiksioni;*
- *Bashkëpunimin ndërkombëtar për ndihmë të ndërsjellët juridike lidhur me ekstradimin, transferimin e çështjeve penale, dhe transferimin e personave të dënuar;*
- *Bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet forcave ligjzbatuese lidhur me hetimet e përbashkëta, teknikat e posaçme hetimore, si dhe krijimin e kartelës penale⁵².*

b. Protokoll i OKB-së kundër Kontrabandës

Ky protokoll përcakton format e bashkëpunimit lidhur me rastet e kalimit kontrabandë të migrantëve, dhe synon fuqizimin e bashkëpunimit mes agjencive të kontrollit të kufirit për parandalimin dhe luftën kundër kalimit të pa ligjshëm të kufirit shtetëror, duke shkëmbyer informacion lidhur me:

- personat dhe grupet e kontrabandistëve;
- rrugët, bartësit dhe mjetet e transportit që përdorin kontrabandistët;
- përdorimin apo keqpërdorimin e dokumenteve të udhëtimit;
- mjetet dhe metodat e fshehjes dhe transportimit të personave;
- shkëmbimin praktikave legjislative dhe e përvojave më të mira⁵³, etj.

⁵¹ UNTOC – “Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, miratuar në vitin 2000

⁵² Shih: UNTOC

⁵³ Shih: Protokoll i OKB-së kundër Kontrabandës.

c. Protokoll i OKB-së kundër Trafikimit

Ky protokoll⁵⁴ është një marrëveshje ndërkombëtare sipas së cilës shtetet duhet të marrin masa legjislative, politike dhe praktike për të parandaluar trafikimin, si dhe për të ndihmuar viktimat e trafikimit, si dhe për ndjekur penalisht dhe ndëshkuar personat autorët e krimit. Gjithashtu, protokoll i identifikon formash konkrete të bashkëpunimit të cilat mund të jenë:

- Shkëmbim i informacionit ndërmjet policive të vendeve anëtare, lidhur me identifikimin e viktimave dhe të autorëve;
- Ndihmë e ndërsjellët për identifikimin e mjeteve dhe metodave që përdorin grupet e organizuara kriminale për qëllimin e trafikimit;
- Bashkëpunim mes autoriteteve kombëtare që operojnë në kufiri, për verifikimin e dokumenteve të udhëtimit dhe të identitetit;
- Bashkëpunimi për konfiskimin e produkteve të krimit, etj.

Sipas Protokollit të Palermos trafikimi përkufizohet si më poshtë:

*“...rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, me anë të kërcënimit, ushtrimit të forcës ose të formave të tjera të detyrimit, të grabitjes, mashtrimit, gënjeshtërs, abuzimit, shpërdorimit të pushtetit ose përfitimit nga pozicioni i pambrojtur i personit, për qëllimin e shfrytëzimit të tij, me anë të marrjes ose dhënies së pagesave apo përfitimeve të tjera për sigurimin e lejes së një personi që ka kontroll mbi një tjetër. Shfrytëzimi do të përfshijë, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, ose të formave të ndryshme të shfrytëzimit seksual, të punës apo shërbimeve të tjera, të skllavërisë ose të praktikave të ngjashme me skllavërinë, të shërbimeve të detyruara apo të heqjes së organeve”.*⁵⁵

*d. Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit (UNCAC)*⁵⁶

⁵⁴ Protokoll i Palermos - Protokoll i OKB-së kundër Trafikimit – “Protokoll për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, firmosur në Palermo, viti 2000. Ky protokoll hyri në fuqi në vitin 2003, ndërsa deri në 1 Janar 2009 në të merrnin pjesë mbi 124 shtete palë. Ai u kërkonte shteteve palë të përcaktojnë si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore sipas përkufizimit në këtë instrument, si dhe veprat e lidhura me të.

⁵⁵ Neni 3, Protokoll i Palermos.

⁵⁶ UNCAC - Konventa e OKB-së Kundër Korrupsionit, synon të nxisë dhe forcojë masat e luftës kundër korrupsionit në sektorin publik dhe privat, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (hyri në fuqi në vitin 2005).

UNCAC synon bashkëpunimin ndërkombëtar për veprat penale në fushën e korrupsionet, dhe harmonizon kryerjen e veprimeve për parandalimin dhe goditjen e këtij fenomeni, që shfaqen në shoqëritë demokratike në forma të ndryshme, të tilla si:

- Dhënia ryshfet nëpunësve për të përfituar lehtësira;
- Abuzimi me detyrën dhe me fondet publike nëpërmjet tenderëve dhe forma të tjera;
- Shpërdorimi i funksionit nga nëpunësit e administratës publike dhe private;
- Vjedhja e përvetësimi i realizuar me shpërdorim të pozitës;
- Shpërdorimi e fallsifikimi i dokumenteve;
- Krijimi i privilegjeve të pa drejta;
- Dhënia e informacioneve të klasifikuara;
- Favorizimet në kontrata;
- Mbulimi i veprimtarisë kriminale,⁵⁷ etj.

Konventa cilëson si shkelje penale pengimin e drejtësisë në lidhje e kryerjen e shkeljeve të sipërcituara dhe të parashikon masa parandaluese sektorin publik dhe atë privat, për të cilat shtetet palë detyrohen të bashkëpunojnë në këtë drejtim lidhur me mbledhjen e provave për t'u përdorur në ndjekjen penale, gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të vëna me korrupsion, deri në ekstradimin e autorëve. Edhe Këshillit të Evropës ka miratuar disa konventa të cilat kanë në fokus luftën kundër korrupsionit, si:

- Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Penale mbi Korrupsionin⁵⁸;
- Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Civile mbi Korrupsionin⁵⁹;
- Konventa Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykrimeve Penale,⁶⁰ etj.

Të gjitha konventat e sipërcituara janë ratifikuar nga parlamenti shqiptar, dhe në zbatim të tyre janë bërë përmirësime në legjislacionin e brendshëm.

⁵⁷ Shih: UNCAC.

⁵⁸ Kjo Konventë e cilëson korrupsionin si vepër penale.

⁵⁹ Kjo Konventë parashikon dëmshpërblimin e viktimave të korrupsionit.

⁶⁰ Konventa Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykrimeve Penale, bërë në Hagë më 28.05.1970, ratifikuar me Ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003. Shpallur me dekret nr. 3840, datë 17.06.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Fletore Zyrtare nr. 51, datë 25.06.2003.

Kapitulli III: BASHKËPUNIMIT POLICOR NË NIVEL GLOBAL

3.1 Bashkëpunimi policor ndërkombëtar përmes INTERPOL-it

Një nga mënyrat e bashkëpunimit policor në nivel global realizohet nëpërmjet organizatës organizatës policore ndërkombëtare INTERPOL. Shqipëria ka miratuar Ligjin nr. 8427 datë 14.12.1998, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL”⁶¹. Në nenin 1 të këtij ligji është parashikuar se: *“Republika e Shqipërisë aderon në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë Organizatë, parashikuar në Kushtetutën e INTERPOL-it”*.

3.2 Ç’është organizata policore ndërkombëtare INTERPOL?

INTERPOL është organizata policore ndërkombëtare më e madhe me rreth 190 vende anëtare,⁶² sekretariati i së cilës është i vendosur në Lion, Francë. Stafi i tij përbëhet nga 540 zyrtarë prej 80 shteteve të ndryshme. Çdo anëtar është mbikëqyrës për një zyrë rajonale që shërben si pikë kontakti për Sekretariatit me INTERPOL-in dhe anëtarëve të tjerë të cilët kërkojnë asistencë hetimore, të cilët gjithashtu janë përgjegjës për lokalizimin e të arratisurve të mundshëm⁶³.

I krijuar në vitin 1923⁶⁴, INTERPOL lehtëson bashkëpunimin policor ndërkombëtar, si dhe ndihmon dhe asiston të gjithë autoritetet dhe shërbimet, misioni i të cilave është parandalimi dhe lufta kundër krimit ndërkombëtar. Qëllimi i organizatës është:

- *“Të sigurojë dhe promovojë asistencë ndërmjet të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kornizës ligjore ekzistuese të vendeve të ndryshme dhe në respekt të frymës së “Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut”*.

⁶¹ Fletore Zyrtare nr. 30, datë 23.12.1998, faqe 1157.

⁶² Kushtetuta e INTERPOL-it, hyrë në fuqi më 03 qershor 1956.

⁶³ www.interpol.int

⁶⁴ Dr.Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 206.

- *Të krijojë dhe zhvillojë të gjitha institucionet që kontribuojnë efektivisht në parandalimin dhe shuarjen e krimeve*".⁶⁵

3.3 Krijimi i organizatës policore ndërkombëtare INTERPOL⁶⁶

Kongresi i parë ndërkombëtar i policisë kriminale është mbajtur në Monaco në vitin 1914, ku juristë dhe prokurorë nga 14 vende takohen të diskutojnë mbi procedurat për arrestimet, teknikat për identifikimin, të dhëna ndërkombëtare të centralizuara dhe procedura ekstradimi. Në vitin 1923 u krijua Komisioni i Policisë Kriminale Ndërkombëtare (ICPC)⁶⁷ me qendër në Vjenë, Austri me iniciativë të Dr. Johannes Schober - President i Policisë së Vjenës⁶⁸, ku për herë të parë u publikuan kartelat e personave të kërkuar në gazetën ndërkombëtare të sigurisë publike të INTERPOL-it.⁶⁹

3.4 Funksionimi i organizatës policore ndërkombëtare INTERPOL

Siç përcaktohet në nenin 5 të Kushtetutës së saj, INTERPOL përfshin në vijim:

- Asamblenë e Përgjithshme;
- Komitetin Ekzekutiv;
- Sekretariatin e Përgjithshëm;
- Zyrat Qendrore Kombëtare;
- Këshilltarët;
- Komisionin për Kontrollin e dosjeve të INTERPOL-it.⁷⁰

⁶⁵ Shih: Kushtetuta e INTERPOL-it, Neni 2.

⁶⁶ Shih faqen zyrtare të INTERPOL në adresën: www.interpol.int

⁶⁷ Deflem, 2005. "International Police Cooperation - History of". Pp.795-798 in The Encyclopedia of Criminology, edited by Richard A. Wright and J. Mitchell Miller. New York: Rutledge.

⁶⁸ Pas vdekjes së Dr. Schober u krijua posti i Sekretarit të Përgjithshëm. I pari i emëruar ishte shefi i policisë austriake Oskar Dressler.

⁶⁹ Shih faqen zyrtare të INTERPOL në adresën: www.interpol.int

⁷⁰ Po aty.

Në mënyrë që të arrijë qëllimet e saj me vendet anëtare, organizata INTERPOL mban lidhje dhe shkëmben informacion dhe të dhëna me ZQK-të e vendeve anëtare, në funksion të misionit dhe vizionit të saj. Vizioni i organizatës INTERPOL është: “Ndërlidhje policore për një botë më të sigurt”, ndërsa misioni i saj: “Parandalimi dhe lufta kundër krimit nëpërmjet një bashkëpunimi policor ndërkombëtar të lartë”⁷¹. Rënësia qëndron në ndërlidhjen që siguron për çdo agjenci të zbatimit të ligjit në vendet anëtare, për të bërë të mundur përmirësimin e sigurisë publike. Misioni arrihet nëpërmjet katër funksione primare të organizatës, të cilat janë:

- a) *Komunikim i sigurt dhe global policor (sistemi I24/7 i sigurt, i disponueshëm për të gjitha ZQK);*
- b) *Shërbime dhe arshiva globale për policitë (databas-e nominale, automjetesh, gjurmë gishtash, ADN, vepra arti etj);*
- c) *Ndihmë shërbimeve policore (nëpërmjet zyrave specifike në Sekretariatit e Përgjithshëm);*
- d) *Trajnim policor dhe zhvillimi (nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm)*⁷².

INTERPOL-i u jep ndihmë vendeve anëtare nëpërmjet Sistemit eASF dhe databas-eve policore që ai ka, të cilat kontrollohen nëpërmjet sistemit I-24/7 nga çdo ZQK. Sistemi eASF është një sistem që praktikisht lidh databas-et e INTERPOL-it me sistemin kombëtar të vendeve. Shqipëria është një nga vendet që e ka instaluar këtë sistem, ndërsa databas-et ruajnë të dhëna të: gjurmëve të gishtave, dokumenteve të vjedhur ose të humbur, automjeteve të vjedhur, personave në kërkim ndërkombëtar, ADN, veprave të artit të vjedhura, si dhe imazhe të abuzimeve seksuale ndaj të miturve.

⁷¹ Kushtetuta e Interpolit.

⁷² Dr. Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 207.

Foto 1: Faqe e sistemit ASF2 të INTERPOL

The image shows the top section of the INTERPOL website. At the top left is the INTERPOL logo, a globe with a torch, and the word "INTERPOL" in large blue letters. Below it is the tagline "CONNECTING POLICE FOR A SAFER WORLD". A blue navigation bar contains the links: HOME, ABOUT INTERPOL, NEWS AND MEDIA, and MEMBER COUNTRIES. Below this is a dark grey search area. On the left, there's a red "SEARCH" button. To its right are input fields for "Lastname" (containing "zharka"), "Firstname", "Nationality" (a dropdown menu), and "Free text". On the right side of the search area, there are fields for "Current age" (with a slider from 0 to 100), "Sex" (a dropdown menu), "Colour of eyes" (a dropdown menu), and "Colour of hair" (a dropdown menu). A blue "SEARCH" button with a magnifying glass icon is at the bottom right of the search area.

Burimi: <http://www.interpol.int>

3.5 Si realizohet komunikimi ndërmjet ZQK-ve, përmes kartelave paralajmëruese të INTERPOL?

Një ndër mënyrat më të rëndësishme të shkëmbimit të informacionit nëpërmjet kanalit të INTERPOL-it janë kartelat e saj. Kartelat e INTERPOL-it janë alerte ndërkombëtare që bëjnë të mundur shkëmbim të rëndësishëm informacioni kriminal në gjithë vendet anëtare. Ato publikohen nga Sekretariati i Përgjithshëm me kërkesë të ZQK-ve ose organizmave të autorizuar, mundësisht në të katër gjuhët zyrtare të organizatës, të cilat janë: Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht dhe Arabisht. Kartelat përmbajnë informacion të detajuar mbi identitetin e personit që është objekt i saj, mundësisht foto, gjurmë gishtash, profil AND, etj, si dhe një përmbledhje të shkurtër faktesh, informacion mbi dispozitat ligjore dhe mbi vendndodhjen e personit (në rastin e kartelës së kuqe)⁷³.

⁷³ Rregullore “Për funksionimin e ZQK Interpol-Tirana”, kapitulli mbi tipet e paralajmërimeve, miratuar me Urdhër nr. 759, datë 21.05.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në rastin e *Kartelës së Kuqe*, personat në fjalë janë të kërkuar nga juridiksione kombëtare dhe kartelat e kërkuara janë të bazuara në një urdhër arresti ose vendim gjykate. Roli i INTERPOL-it është të ndihmojë policitë kombëtare në identifikimin dhe lokalizimin e këtyre personave me qëllim arrestimin dhe ekstradimin e tyre.



Red Notice (Lajm i Kuq)⁷⁴. Me këtë kod ose lajm kërkohet nxjerrja e një urdhri arresti të menjëhershëm për një person që është i kërkuar ose që pritet të ekstradohet, bazuar kjo në vendimin e gjyqit.

Foto 2: Kartelë e kuqe e shfaqur në sistemin ASF2 të Interpol-it për një person të kërkuar

Legal Status	
Present family name:	ASSANGE
Forename:	JULIAN PAUL
Sex:	MALE
Date of birth:	3 July 1971 (39 years old)
Place of birth:	TOWNSVILLE, Australia
Language spoken:	English
Nationality:	Australia

Offences	
Categories of Offences:	SEX CRIMES

Burimi: <http://www.interpol.int>

Kartela⁷⁵ të tjera janë:

⁷⁴ <http://www.interpol.int>

⁷⁵ Rregullore “Për funksionimin e ZQK Interpol-Tirana”, kapitulli mbi tipet e paralajmërimeve, miratuar me Urdhër nr. 759, datë 21.05.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- *E Verdhë:*



Yellow Notice (Lajm i Verdhë)⁷⁶. Me këtë kod kërkohet ndihmë për gjetjen e personave të humbur, sidomos të mitur, ose persona që kanë humbur identitetin.

- *Kartela Blu:*



Blue Notice (Lajm Blu)⁷⁷. Me këtë kod kërkohet mbledhje e informacionit lidhur me identitetin, vendndodhjen ose aktivitetet ilegale të personit të kërkuar.

- *Kartela e Zezë:*



Black Notice (Lajm i Zi)⁷⁸. Me këtë kod kërkohet ndihmë për identifikimin e trupave të paidentifikuar.

- *Kartela Jeshile:*



Green Notice (Lajm Jeshil)⁷⁹. Me këtë kod kërkohet sigurimi i informacionit kriminal lidhur me një person që ka kryer krim ose ka kryer një fyerje të ligjit dhe ka mundësi ta përsëris të njëjtin akt edhe në vende të tjera.

⁷⁶ <http://www.interpol.int>

⁷⁷ <http://www.interpol.int>

⁷⁸ <http://www.interpol.int>

- *Kartelë Portokalli:*



Orange Notice, (Lajm Portokalli)⁸⁰. Ky kod paralajmëron policinë, entet publike dhe organizatat e tjera kundër krimit ndërkombëtar për akte dhe ngjarje kriminale që mund të kërcënojnë sigurinë publike.



Lajm Special, njoftimi për këtë lajm behet nga Këshilli i Sigurisë Speciale të vendeve anëtare, dhe njofton të gjitha grupet policore për rrezikun që mund t'u kanoset vendeve anëtare nga terrorizimi dhe sulmet talibane.⁸¹

E ngjashme me kartelat është edhe *Difuzioni*, i cili është një mekanizëm tjetër alerti, më pak formal se kartelat, por që gjithashtu përdoret për të kërkuar arrestimin ose lokalizimin e një personi ose informacion shtesë në lidhje me një hetim. Difuzioni qarkullohet direkt nga një ZQK te vende të tjera (nëpërmjet ZQK) sipas nevojës, ose tek të gjitha vendet anëtare.

⁷⁹ <http://www.interpol.int>

⁸⁰ <http://www.interpol.int>

⁸¹ Rregullore “Për funksionimin e ZQK Interpol-Tirana” miratuar me Urdhër nr. 759, datë 21.05.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Kapitulli mbi tipet e paralajmërimeve.

Kapitulli IV: BASHKËPUNIMIT POLICOR NË NIVEL RAJONAL

4.1 Bashkëpunimi policor përmes EUROPOL-it

4.1.1 Ç`është shërbimi policor european EUROPOL, objekti dhe detyrat e tij

EUROPOL ose Shërbimi Policor European është agjencia e zbatimit të ligjit në BE, me qendër në Hagë ⁸², që ka për mision të asistojë autoritetet e agjencive të zbatimit të ligjit në vendet anëtare në luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe formave të tjera të krimeve të rënda. EUROPOL-i si organizatë e BE-së për zbatimin e ligjit që trajton informacionin sekret kriminal, synon të përmirësojë efektivitetin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente të shteteve anëtare, për parandalimin dhe luftën kundër krimit të rëndë të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit. Objektivi i tij, sipas nenit 2 të Konventës EUROPOL⁸³, është përmirësimi i efektivitetit dhe bashkëpunimit të autoriteteve kompetente⁸⁴ në shtetet anëtare për të parandaluar dhe luftuar krimin e rëndë ndërkombëtar, nëse ka të dhëna ose arsye për të besuar që:

- Është e përfshirë një strukturë e organizuar kriminale; dhe
- preken dy ose më shumë shtete anëtare dhe kërkohet përqasje e përbashkët nga shtetet anëtare.

Krijimi i këtij shërbimi e ka zanafillën në vitin 1991, ku në Gjermani u hodh propozimi për krijimin e një policie evropiane ose korpus policor që më pas u quajt EUROPOL. Zyrtarisht

⁸² Shtabi i EUROPOL e ka vendndodhjen në Hagë, Holandë. Ka një staf prej 660 zyrtarë nga 27 vende anëtare evropiane. Personeli është i rekrutuar nga shumë agjenci të përforcimit të ligjeve, në vendet e tyre të origjinës ku përfshihen policitë, doganat, policia kufitare dhe shërbimet e sigurimit.

⁸³ Dr.Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit European”, Shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 215.

⁸⁴ Për qëllim të kësaj Konvente “autoritete kompetente” do të thotë të gjitha organet publike që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të cilat janë përgjegjëse sipas legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar veprat penale. Neni 2 i zëvendësuar nga Akti i Këshillit që miraton në bazë të nenit 43 (1) të Konventës për Krijimin e EUROPOL-it, një Protokoll që ndryshon atë Konventë (2004/C 2/01), Akti i Këshillit i 27 nëntorit 2003 (Fletore Zyrtare nr. 2, 06.01.2004, fq. 3).

akti i krijimit të Europol është datat 07.02.1992 në Mاستriht⁸⁵. Në vitin 1994 njësia evropiane kundër drogës, paraardhësja e EUROPOL-it pushoi së ekzistuari⁸⁶. Ky institucion nisi të funksionoj prej datës 01.07.1999, pasi të gjitha shtetet anëtare ratifikuan Konventën EUROPOL, dhe prej datës 01.01.2010 EUROPOL është bërë një Agjenci Evropiane.

“EUROPOL është një agjenci për forcimin e ligjit e krijuar nga një bashkim i vendeve evropiane për të qenë të gjitha koherente për përballimin e inteligjencës kriminale”⁸⁷.

Foto 3: Logo e EUROPOL



Burimi: <http://www.europol.europa.eu/>

Traktatin e Mاستrihtit në Nenin K.1, Titullit VII- Dispozita kryesore, Traktatit për Bashkimin European parashikon se shtetet anëtare të BE duhet të konsiderojnë si çështje të interesit të përbashkët:

“bashkëpunimin policor me qëllim parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe formave të tjera të krimeve të rënda, duke përfshirë disa aspekte të bashkëpunimit doganor, në lidhje me organizimin e një sistemi të gjerë në Bashkimin European për shkëmbimin e informacionit brenda EUROPOL-it”⁸⁸.

Misioni i kësaj agjencie policore është të japë një kontribut të rëndësishëm në veprimin e zbatimit të ligjit të BE-së kundër veprave të rënda kriminale transnacionale, duke vënë theksin në goditjen e organizatave kriminale. Konventa Europol përcakton format e krimit

⁸⁵ Dr.Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit European”, Shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 215.

⁸⁶ “Ten Years of Europol 1999 -2009”, European Police Office, Hague, 2009. ISBN 978-92-95018-76-1, p.12.

⁸⁷ Kushtetuta e EUROPOL-it. Akti i Këshillit i 26 korrik 1995 për Konventën bazuar në nenin K.3 të Traktatit për Bashkimin European për krijimin e Europol, OJ C 316, 27.11.1995 fq 2. Konventa e EUROPOL e vitit 1995 u ratifikua nga të gjitha shtetet anëtare të BE dhe hyri në fuqi në 1998. <http://www.europol.europa.eu/>

⁸⁸ Titullit VII i Traktatit për BE përmban dispozita për bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, e ashtuquajtur Shtylla e Tretë.

ndërkombëtar,⁸⁹ ku brenda kompetencave të saj përfshihen aktivitetet e zbatimit të ligjit të shteteve anëtare, kryesisht kundër:

- Trafikimit të paligjshëm të drogave;
- Rrjeteve të paligjshme të emigracionit;
- Akteve terroriste;
- Veprimtari të paligjshme të falsifikimit të Euro-s, dhe mjeteve të tjera të pagesës;
- Trafikimit të qenieve njerëzore (trafikimit të femrave për prostitucion, trafikimit të organeve, duke përfshirë abuzimin me fëmijët);
- Trafikimit të paligjshëm i automjeteve;
- Trafikut të substancave bërthamore dhe radioaktive;
- Krimit ekonomik e financiar dhe krimit kibernetikë;
- Pastrimit të parave.

EUROPOL në çdo vend anëtar të tij ka Pika kontakti,⁹⁰ ndërsa brenda organizatës së tij ka një Zyrë Ndërlidhëse⁹¹ prej 130 vetë⁹² me përfaqësinë e të 28 vendeve evropiane e cila siguron një databas-e dhe infrastrukture të sigurt për shkëmbimin e informacionit kriminal, ka mbi 100 analistë të kriminalistikës që përdorin mjete dhe metoda mjaft të sofistikuara, si dhe përfaqësi nga vendet që kanë lidhje bashkëpunimi me Europol-in si, Amerikë, Kanada, Kolumbi, Zvicër, si dhe përfaqësi të Interpol-it. Detyra kryesore e këtyre oficerëve është të shërbejnë si urë lidhëse mes agjencive të tyre lokale dhe Europol. Gjithashtu, ata kanë një rol shumë të rëndësishëm në koordinimin e operacioneve ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

⁸⁹ Shih: Vendimin e Këshillit të 6 dhjetorit 2001 që shtrinë mandatin e Europol për të përfshirë format e krimit të rëndë ndërkombëtare të renditura në Aneksin e Konventës Europol, OJ C 362, 18.12.2001, fq. 1.

⁹⁰ Pika e kontaktit me EUROPOL të vendeve anëtare quhen Njësi Kombëtare të EUROPOL-it (ENU).

⁹¹ Aktiviteti thelbësor i Zyrës Ndërlidhëse është të mbështesë vendet anëtare në mbledhjen, analizimin dhe organizimin e informacionit kriminal si dhe koordinimin e operacioneve policore.

⁹² The European Investigator, Targeting Criminals Across Borders, ISBN: 978-92-95018-90-7, Hague 2011.

4.1.2 Çfarë suporti u jep EUROPOL-i vendeve anëtare?

EUROPOL-i u jep mbështetje vendeve anëtare për problemet në fushën e sigurisë, lidhur me parandalimin e kriminalitetit në vende, dhe konkretisht për:

- *Lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis shteteve anëtare nëpërmjet oficerëve të tyre të ndërlidhjes të emëruar nga EUROPOL si përfaqësues të agjencive të tyre kombëtare të zbatimit të ligjit;*
- *Për kryerjen e analizave operationale në mbështetje të operationeve;*
- *Gjenerimin e raporteve strategjike (p.sh. vlerësimet e kërcënimit) dhe analizën e krimit mbi bazën e informacionit dhe informacionit sekret të dhënë nga shtetet anëtare dhe palët e treta;*
- *Për kryerjen e ekspertizës dhe mbështetjes teknike për hetime dhe operatione të kryera brenda BE-së, nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë ligjore të shteteve anëtare të interesuara.*⁹³

Europol është aktiv për promovimin e analizës së krimit dhe harmonizimin e teknikave hetimore brenda shteteve anëtare⁹⁴. Gjithashtu, bashkëpunon si me shteteve anëtare, edhe për njësitë e emëruara në çdo palë të tretë si pikë kontakti me Europol për shkëmbimin e informacionit brenda kuadrit të marrëveshjes së bashkëpunimit. Këto njësi quhen Pika Kombëtare të Kontaktit dhe operojnë si njësi kombëtare të Europol-it me përjashtimin që ato nuk kanë akses në sistemin e Europol-it. Ato mund të lidhen me Europol-in me linja elektronike të dedikuara të pajisura me pajisje kriptuese për mbrojtje të rritur. Në Shqipëri funksionon një zyrë kombëtare për komunikimin me Europol-in,⁹⁵ e cila shkëmben informacion të klasifikuar nëpërmjet kanalit të sigurt SIENA⁹⁶.

⁹³ Mathieu Deflem, Europol and the Policing of International Terrorism: Counter-Terrorism in a Global Perspective, Justice Quarterly, Volume 23 nr 3, shtator 2006, fq. 342.

⁹⁴ Dr.Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian”, Shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 221.

⁹⁵ ZKE - Zyra Kombëtare EUROPOL në Shqipëri, strukturë në Drejtorinë e Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë. Ngritur me Urdhër të ministrit të Brendshëm në dhjetor 2010.

⁹⁶ EUROPOL REVIEW: General Report on Europol Activities, Hague 2012, p.7. ISSN 1681-1550.

4.1.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me EUROPOL

Në lidhje me hapat e hedhur deri në ditët e sotme, mbi bashkëpunimin midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROPOL sqarojmë sa më poshtë:

- Më datë 05.02.2007 në Hagë, është nënshkruar Marrëveshja Strategjike e bashkëpunimit midis Europol dhe Republikës së Shqipërisë.⁹⁷
- Në kuadrin e bashkëpunimit me Europol, vendi ynë përfaqësohet me oficer kontakti të atashuar pranë Europol⁹⁸.
- Midis ministrisë tonë së Brendshme dhe Europol, më datë 26.02.2009 ka hyrë në fuqi Marrëveshja Ndërlidhëse, e cila funksionon mes Policisë së Shtetit dhe EUROPOL⁹⁹.
- Me VKM nr. 483, datë 06.05.2009, vendi ynë miratoi në parim “*Marrëveshjen me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës, për Privilegjet dhe Imunitetet e Oficerëve Ndërlidhës gjatë kohës që do të shërbejnë pranë Zyrës Shqiptare të Ndërlidhjes në EUROPOL*”.
- Më datën 30.07.2009 në Hagë, është nënshkruar kjo marrëveshje mes palëve¹⁰⁰.
- Më datë 01.12.2009 u zhvillua takimi zyrtar me Drejtorin e Europol-it,¹⁰¹ në të cilin u nënshkruan:
 - Plan Veprimi për implementimin e Marrëveshjes Strategjike të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Europol;
 - Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Dokumenti Teknik për mundësimin e krijimit të një linje të sigurt të komunikimit elektronik midis Europol dhe Republikës së

⁹⁷ Pala shqiptare përfaqësohej nga zëvendësministri i Brendshëm Z.Gjergj Lezhja, ndërsa EUROPOL përfaqësohej nga Drejtori i EUROPOL i asaj kohe, Z. Max-Peter Ratzel.

⁹⁸ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 02.07.2008, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe EUROPOL”.

⁹⁹ Marrëveshja Ndërlidhëse me EUROPOL është nënshkruar nga ministri i Brendshëm, Z. Bujar Nishani dhe Drejtori i EUROPOL, Z. Max-Peter Ratzel.

¹⁰⁰ Pala shqiptare përfaqësohej nga Ambasadori i Shqipërisë në Hagë, Z. Gazmend Barbullushi dhe Këshilltare Znj. Xhuljeta Keko.

¹⁰¹ Në datë 1 dhjetor 2009 u zhvillua takimi zyrtar midis ministrit të Brendshëm Z. Lulzim Basha dhe Drejtorit të EUROPOL, Z. Rob Wainwright në EUROPOL, Hagë, Holandë.

Shqipërisë, dokumente këto të cilat mundësojnë më pas çeljen e negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes operacionale.

Duhet theksuar se, vendi ynë ka treguar frymë pozitive për të përmbushur të gjitha detyrimet dhe objektivat me këtë agjenci, të cilat janë:

- *“Marrëveshjen Strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European”;*
- *“Plan Veprimi për Implementimin e Marrëveshjes Strategjike të Bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROPOL”;*
- *“Memorandumit të Mirëkuptimit mbi krijimin e linjave të sigurta të komunikimit elektronik midis EUROPOL dhe Republikës së Shqipërisë”;*
- *“Dokumentit Teknik, Marrëveshjes Bilaterale midis EUROPOL dhe Republikës së Shqipërisë për instalimin dhe lidhjen e Rrjeteve Kompjuterike”.*¹⁰²

Në kuadrin e detyrimeve që përmbahen në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Strategjik midis vendit tonë dhe Europol evidentohet realizmi i objektivave lidhur me instalimin e linjave të sigurta të komunikimit elektronik.¹⁰³ Për komunikimin me Europol që nga muaji mars 2012 është vënë në funksionim SIENA.

- Më datë 07.11.2011 është nënshkruar *“Memorandumi i Bashkëpunimit për ndërlidhjen e sistemeve kompjuterike mes EUROPOL dhe Ministrisë së Brendshme”.*
- Më datë 09.12.2013, u nënshkrua *“Marrëveshja Operacionale ndërmjet EUROPOL dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë”.*¹⁰⁴

¹⁰² Dokumete të nënshkruara në Hagë, më 01.12.2009

¹⁰³ Kanali i komunikimit SIENA. Në zbatim të “Plan Veprimit”, “Memorandumit të Mirëkuptimit” dhe “Dokumentit Teknik për instalimin dhe fillimin nga puna të linjave të sigurta të komunikimit elektronik ndërmjet EUROPOL dhe Policisë së Shtetit”, është ndjekur puna për instalimin e linjave të sigurta të komunikimit elektronik midis EUROPOL dhe Zyrës Kombëtare të EUROPOL në DPP. Instalimi i kësaj linje të sigurt komunikimi e cila u realizua më 28 qershor 2011, do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit operacional dhe strategjik midis EUROPOL dhe ZKE në Policinë e Shtetit.

¹⁰⁴ Marrëveshja është nënshkruar në Hagë nga Ministri i Brendshëm, Z. Saimir TAHIRI dhe Drejtori i EUROPOL, Z. Rob WAINWRIGHT.

Aktualisht marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Europol janë në drejtimin e duhur, pasi janë duke u plotësuar detyrimet që rrjedhin nga plani i veprimit për zbatimin e marrëveshjes strategjike dhe operacionale. Përfaqësimi me oficer ndërlidhës në Europol dhe shkëmbimi i informacioneve operacionale, është shprehje e vullnetit dhe interesit të palëve për të forcuar bashkëpunimin me këtë shërbim. Më datë 20 mars 2014 parlamenti shqiptar ratifikoi marrëveshjen operacionale të nënshkruar midis Policisë së Shtetit dhe Europol, çka do të thotë se tashmë Policia e Shtetit mund të operoj me Europol në nivel operacional.

4.1.4 Si realizohet bashkëpunimi EUROPOL-in dhe autoritetet kombëtare?

Në zbatim të Nenit 4 të Konventës së Europol, çdo shtet anëtar krijon një njësi ose zyrë kombëtare për komunikimin me shërbimin policor europian në dy mënyra:

- a. drejtpërdrejt, nëpërmjet linjave të sigurta të komunikimit elektronik;*
- b. nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse në Europol (ZNE).*

Bashkëpunimi midis Europol dhe ZKE mbahet nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në nivel strategjik dhe operacional, që kryhet në tre forma:

- a. kërkesat për kontrollet nga Europol ose nga zyrat ndërlidhëse të vendeve të BE-së, vendeve të treta dhe institucioneve të tjera që kanë marrëveshje me Europol;*
- b. kërkesat për kontrole operative nga autoritetet kompetente kombëtare në Sistemin e Informacionit të Europol dhe/ose kontrollet në disa vende të BE-së ose vendeve të treta nëpërmjet zyrave ndërlidhëse në Europol;*
- c. dërgimi i informacionit operativ në sistemin operacional të Europol.¹⁰⁵*

Në rastet kur kërkesat paraqiten nga Europol-i, në përputhje me llojin e veprës penale, kompetencat e autoriteteve kompetente kombëtare, si dhe përmbajtjen e vetë kërkesës, ZKE përcakton mënyrën e veprimit të mëtejshëm dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente kombëtare. Në rastin kur informacionet teknike dhe strategjike ose raportet janë subjekt i kërkesës së Europol dhe të paraqitura prej tij, që kanë për objekt propagandimin e inteligjencës për format e reja të krimit ose analizën analitike për situatën kriminale, ZKE i

¹⁰⁵ Shih: Rregullore e Zyrës Kombëtare të Europolit

përcjell ato në strukturat përkatëse organizative strategjike dhe analitike, brenda autoriteteve kompetente kombëtare, për informimin e tyre dhe për të vepruar mbi to.

Informacioni strategjik përfshin:

- a. veprime që mund të përdoren për goditjen e akteve kriminale, veçanërisht mënyra të specializuara të luftës kundër veprave penale;
- b. metodat e reja që përdoren në kryerjen e veprave penale;
- c. prirje dhe zhvillime në metodat e përdorura për kryerjen e veprave penale;
- d. vëzhgime dhe përfundime që dalin nga zbatimi me sukses i teknikave të reja të zbatimit të ligjit nga ana e autoriteteve kompetente kombëtare;
- e. rrugët dhe ndryshimet në rrugët e përdorura nga kontrabandistët ose ata që përfshihen në veprat penale të trafikimit të paligjshëm;
- f. strategji për parandalimin dhe metoda të menaxhimit në mënyrë që të vendosen prioritetet dhe veprimet për autoritetet kompetente kombëtare dhe
- g. vlerësime të kërcënimit dhe raporte për situatën kriminale.

Ndërsa informacioni teknik përfshin:

- a. mënyra për forcimin e strukturave administrative brenda autoriteteve kompetente kombëtare;
- b. metoda të policisë shkencore dhe procedura hetimore;
- c. metoda për trajnimin e zyrtarëve të interesuar;
- d. metoda dhe teknika të analizës së informacionit kriminal dhe
- e. identifikimi i ekspertizës/njohurive të specializuara për zbatimin e ligjit.

Gjithashtu, ZKE bashkëpunon me autoritetet të tjera kombëtare ligjzbatuese¹⁰⁶ me të cilat janë:

- Ministria e Financës (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Tatimeve; dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave);
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Mbrojtjes (Shërbimi Informativ i Ushtrisë);

¹⁰⁶ Sipas nenit 4 të Rregullores së ZKE

- Prokuroria e Përgjithshme;
- Shërbimi Informativ i Shtetit,
- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; si dhe,
- autoritete të tjera që kanë kompetencën për të vepruar sipas mandatit të Europol-it.

Bashkëpunimi i ZKE me autoritetet kompetente kombëtare, rregullohet me aktet ligjore kombëtare (strategjitë, plan veprimet, protokollet për bashkëpunim në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar), si dhe protokolle të tjera dypalëshe ndërmjet Policisë së Shtetit dhe autoriteteve kompetente kombëtare përkatëse. Me qëllim realizimin e këtij bashkëpunimi, në autoritetet kompetente kombëtare caktohen Pika Kontakti me ZKE. Pika të tilla caktohen dhe në strukturat qendrore dhe vendore të policisë, të cilat kanë kompetencën për të vepruar sipas mandatit të Europol. Komunikimi reciprok i ZKE me rrjetin e pikave të kontaktit realizohet drejtpërdrejtë.

4.2 Bashkëpunimi policor përmes iniciativave rajonale në kuadër të SELEC

4.2.1 Qendra SECI si organizatë bashkëpunimi policor në Evropën Juglindore¹⁰⁷

Bashkimi European ka treguar një vëmendje të veçantë drejt aktiviteteve dhe funksionimit të Qendrës SECI¹⁰⁸, si një institucion i vetëm i formatit të bashkëpunimit të agjencive të zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit të organizuar dhe ndërkufitar. Qendra funksionon nëpërmjet përfaqësuesve të policive dhe doganave të vendeve anëtare, të cilët grumbullojnë informacion nga strukturat e vendeve që përfaqësojnë. Informacioni mund të kërkohej nga një vend ose më shumë vende. Në rastet kur përfshihen më shumë se dy vende në një shkëmbim informacioni, Qendra ndërhyr dhe koordinon hetimin e përbashkët dhe më pas operacionin. I gjithë informacioni i grumbulluar kalon në sektorin e Analizës që ka qendra për analiza rajonale sipas problematikës dhe gjeografisë. Informacionet sipas marrëveshjes

¹⁰⁷ Qendra SECI - Southeast European Cooperative Initiative – Nisma për Bashkëpunim në Evropën Juglindore. Marrëveshja e SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër Krimit Ndërkufitar, është nënshkruar në Bukuresht, më 26 maj 1999. Ratifikuar me ligjin nr. 8541, datë 21.10.1999. Fletore Zyrtare nr. 31, faqe 1175.

¹⁰⁸ <http://www.secicenter.org/>

ndjekin rrugën nëpërmjet Pikave Fokale Kombëtare të cilat janë zyra ku merret, përpunohet informacioni dhe shpërndahet në destinacionet e kërkuara për procedim. Edhe përgjigjet ndjekin të njëjtën rrugë në kthim, nga pikat e kontaktit për tek përfaqësuesit e vendeve që kanë bërë kërkesën.

Qendra SECI (aktualisht SELEC) përbëhet nga 13 vende anëtare të cilat janë: Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Mali i Zi, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.¹⁰⁹

Foto 4: Logo e Qendrës SECI



Burimi: <http://www.secicenter.org/>

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, Qendra SECI¹¹⁰ është kthyer në një organizatë shumë efektive në rajonin e Evropës Juglindore, në të cilën punojnë çdo ditë oficerë ndërlidhës nga aparatet policore dhe doganore të vendeve anëtare, një staf ekspertësh dhe analistë kriminalistë. Gjithashtu, japin kontributin e tyre oficerë ndërlidhës nga Departamenti i Shtetit, Departamenti i Drejtësisë, FBI, DEA dhe Guardia di Finanza. Gjithashtu Qendra SECI bashkëpunon ngushtë edhe me shtetet vëzhguese si Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Spanja, Belgjika, Austria, Zvicra, Holanda, Republika Çeke, Sllovakia, Polonia, Rusia, Kanadaja e Japonia, nëpërmjet oficerëve ndërlidhës të atashuar pranë ambasadave të vendeve respektive në Bukuresht. Kjo

¹⁰⁹ <http://www.secicenter.org/>

¹¹⁰ Shqipëria ka ratifikuar Kartën për Qendrën SECI me ligjin nr. 8639, datë 13.07.2000 “Për ratifikimin e “Kartës për organizimin e funksionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar” .

organizatë bashkëpunon edhe me organizata të ngjashme si: INTERPOL, EUROPOL, WCO¹¹¹, UNODC¹¹² etj. Në Qendrën SECI operojnë 8 Task Forca rajonale të cilat janë me mision të përcaktuar: për antidrogën; kundër trafikimit të qenieve njerëzore; kundër terrorizmit; për sigurinë e kufijve; kundër krimit kompjuterik dhe financiar; kundër kontrabandës dhe mashtimit; kundër makinave të vjedhura; dhe për sigurinë e kontenierëve. Qendra SECI, për herë të parë, në vitin 2009, realizoi SEE-OCTA-s¹¹³, për vlerësimin e rrezikshmërisë ndaj krimit të organizuar për vendet e Europës Juglindore, vlerësim i cili u krye nga analistët e SECI-t, mbi bazën e të dhënave të dërguara nga vendet që aderojnë në Evropën Juglindore. Në Konferencën e 31-të të JCC¹¹⁴, u miratua konventa e re e SELEC, e cila në vijimësi do të mbështetet financiarisht nga Komisioni Evropian. Nga perspektiva operacionale, SELEC¹¹⁵ ruan fleksibilitetin dhe efikasitetin operacional, ndërkohë që forcon kapacitetin analitik me një sistem të gjerë informacioni dhe përshtat një nivel mbrojtje të të dhënave personale, në linjë me standardet e kërkuara nga BE. Konventa e re e SELEC është një bazë ligjore ndërkombëtare e cila përcakton dhe mbështet Qendrën të bashkëpunojë me organizata të tjera madhore ndërkombëtare që merren me zbatimin e ligjit.

¹¹¹ WCO - World Customs Organization

¹¹² UNODC - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin

¹¹³ SEE-OCTA-s – Vlerësimi i Rrezikshmërisë ndaj Krimit të Organizuar për vendet e Europës Juglindore, i cili ishte përfundimi i projektit të ideuar në Konferencën Ministrorë, në Brdo Slloveni, mbajtur më datë 04.10.2007 ku Shqipëria ishte pjesëmarrëse në këtë Konferencë.

¹¹⁴ JCC - Joint Cooperation Committee – Bordi Drejtues i SELEC. Në Konferencën e 31-të të JCC, që u mbajt në datën 10 shtator 2009, në Selanik/Greqi, u miratua konventa e re e Qendrës SECI-SELEC. Ajo hyri në fuqi pas ratifikimit nga parlamentet e 13 vendeve anëtare dhe kjo organizatë do të ketë një funksionim gati të njëjtë me atë të Europol-it.

¹¹⁵ Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) hyri në fuqi më datë 07.10.2011. Nisma për Bashkëpunim në Evropën Juglindore zëvendësohet me SELEC, bashkë me kapacitetet operacionale dhe strategjike. Objektivi kryesor i SELEC është bashkëpunimi midis agjencive ligj zbatuese, mbështetja ndaj vendeve anëtare dhe koordinimi në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe ndërkufitar. Ndryshimi i emrit nga SECI në SELEC u bazua në Konventën e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore, e cila u hartua pas një pune 4-vjeçare të kryer nga ekspertë ligjorë nga 13 vendet anëtare të asistuar nga Komisioni Evropian. Duhet theksuar fakti se 14 takimet për hartimin e konventës së SELEC u mbështetën financiarisht nga Komisioni Evropian. Kjo Konventë pas ratifikimit që iu bë nga parlamentet e 13 vendeve anëtare, njihet ndërkombëtarisht nëpërmjet bazës ligjore të saj, duke përfshirë dhe Bashkimin Evropian.

Foto 5: Logo e SELEC



Burimi: <http://www.selec.org/>

4.2.2 Anëtarësimi në SELEC dhe detyrimet e shteteve anëtare

Shteti shqiptar është vend anëtar në organizatën rajonale SELEC, që prej vitit 2001, periudhë kur ratifikoi konventën e Qendrës SECI.

- *Kriteret për t`u anëtarësuar në SELEC*

Çdo vend demokratik që ka afërsi gjeografike me rajonin e Evropës Juglindore mund të anëtarësohet në SELEC. Ministria e Jashtme e vendit të interesuar nëpërmjet përfaqësisë së saj diplomatike në Bukuresht i dërgon një notë zyrtare SELEC, ku specifikohet kërkesa për t`u bërë vend anëtar i organizatës, kërkesë e cila i kalon Këshillit, i cili si organi më i lartë vendimmarrës, i përbërë nga përfaqësues të 13 vendeve anëtare, merr vendim me konsensus. Në rastin kur një vend anëtar kundërshton anëtarësimin, atëherë shteti që ka bërë kërkesën nuk mund të anëtarësohet në SELEC.¹¹⁶

- *Detyrimet e shteteve anëtare¹¹⁷ të SELEC.*

Çdo vend anëtar duhet të përmbush disa detyrime kundrejt organizatës. Fillimisht, duhet të dërgojnë minimalisht një oficer ndërlidhës që mbulon njëkohësisht policinë dhe doganat. Në shumicën e rasteve shtetet dërgojnë dy oficerë ndërlidhës, një nga policia dhe një nga doganat. Vendet anëtare detyrohen të mbulojnë të gjitha shpenzimet financiare për

¹¹⁶ Shih: Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) <http://www.selec.org/>

¹¹⁷ Vende anëtare në SELEC janë 13 shtete: Shqipëri, Greqi, Turqi, Bullgari, Rumani, Moldavi, Hungari, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnje-Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedoni. Në janar 2013 Sllovenia ka kërkuar tërheqjen nga SELEC.

përfaqësuesit e tyre të atashuar pranë SELEC. Një tjetër detyrim kundrejt organizatës është kontributi financiar vjetor që është sa 0.2% e GDP-së¹¹⁸.

- *Detyrimet e vendeve vëzhguese¹¹⁹ të SELEC*

SELEC mbështetet nga vendet vëzhguese dhe partnerët operacionalë. Ndryshimi mes vendeve vëzhguese dhe partnerëve operacionalë është se këta të fundit kanë zyrën e tyre ndërlidhëse pranë ambienteve të SELEC. Shkëmbimi i informacionit me vendet vëzhguese kryhet nëpërmjet oficerëve ndërlidhës të atashuar pranë përfaqësive diplomatike të këtyre shteteve në Bukuresht. Kontributi financiar vjetor i partnerëve operacionalë (SHBA) që derdhen në buxhetin e SELEC është shumë herë më i madh se kontributi i vendeve vëzhguese.

4.2.3 Iniciativat rajonale të SELEC dhe funksionimi i Task-forcave

Në kuadër të rritjes së sigurisë në vendet e Europës Juglindore, të luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe atij ndërkufitar etj., SELEC ka ngritur disa iniciativa rajonale, të cilat janë:

- *Procesi i bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEEC¹²⁰)*

Funksionimi i SEEC bazohet në takime të përvitshëm të kryetarëve të shteteve të Evropës Juglindore, takime të përvitshëm të Ministrave të Jashtëm, takime sektoriale të Ministrave ku diskutohet rreth çështjes së kompetencave të tyre, si dhe takime të përvitshëm të kryetarëve të parlamenteve të vendeve të Evropës Juglindore. Prioritetet e SEEC janë zhvillimi ekonomik dhe social, energjia dhe infrastruktura, drejtësia dhe punët e brendshme, bashkëpunimi mbi sigurinë, ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe bashkëpunimi parlamentar.

¹¹⁸ Shih: Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) <http://www.selec.org/>

¹¹⁹ Vende vëzhguese të SELEC janë 18 shtete: Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Kanadaja, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Izraeli, Italia, Japoni, Holanda, Polonia, Portugalia, Spanja, Sllovakia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, SHBA.

¹²⁰ Procesi i bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEEC¹²⁰)- është një forum për dialog diplomatik dhe politik, ku vendet pjesëmarrëse janë të hapur për të bashkëpunuar për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit, për definimin e pikëpamjeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e eksperiencave. Kjo iniciativë është lançuar në vitin 1996 në Sofje, Bullgari, gjatë takimit të Ministrave të Jashtëm të vendeve të Evropës Juglindore. Ajo ishte një kohë ndryshimesh për vendet e rajonit të shënuara nga procesi i reformave demokratike.

- *Iniciativa kundër krimit të organizuar (SPOC¹²¹)*

Sekretariati i SPOC shërben për sigurimin e ekspertizës ligjore për vendet e rajonit në harmonizimin e bazës ligjore në përputhje me standardet e BE-së. Ky organizëm mbështet dhe forcon mekanizmat e reja të bashkëpunimit rajonal kundër krimit të organizuar. Sekretariati i SPOC është i ndarë në dy zyra, ku njëra ndodhet në ambientet e Parlamentit Rumun dhe tjetra në Bruksel pranë Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

- *Iniciativa kundër Korrupsionit (RAI)¹²².*

Aktualisht, iniciativa RAI konsiston në 9 vende anëtare nga rajoni, Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe një vëzhgues UNMIK, duke siguruar koordinimin e punës, optimizmin e përpjekjeve dhe dialogun e përhershëm me partnerët të angazhuar në luftën kundër korrupsionit.

- *Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG¹²³).*

Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore përbëhet nga prokurorë të Prokurorive të Përgjithshme nga 13 vendet anëtare të SELEC. Ky grup është një mekanizëm ndërkombëtar i bashkëpunimit gjyqësor, me një shprehje të qartë të vullnetit për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor në hetimet dhe rastet e krimit ndërkufitar. Funkcioni kryesor i SEEPAG është të ndihmojë dhe mbështesë hetimet e përbashkëta mes vendeve anëtare, të këshillojë dhe të jap asistencë agjencive ligj zbatuese në përputhje me bazën ligjore të secilit vend anëtar dhe me traktatet ndërkombëtare. Ky Grup Këshillues mblidhet dy herë në vit në secilin nga vendet anëtare dhe shkëmben pikëpamje dhe

¹²¹ SPOC -Iniciativa kundër krimit të organizuar, ka objektiv kryesor forcimin e kapaciteteve rajonale në luftën kundër krimit të organizuar në përputhje me standardet e njohura nga BE-ja. Mandati i SPOC është lehtësimi i dialogut me përfaqësues ndërkombëtarë dhe rajonalë ligjorë, akademik, drejtues dhe zbatimit të ligjit.

¹²² RAI - Iniciativa kundër Korrupsionit, është adoptuar fillimisht në vitin 2000 në Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë bazuar në Iniciativën e Paktit të Stabilitetit Kundër Korrupsionit, për të adresuar çështjet e korrupsionit, një nga kërcënimet më serioze të zhvillimit të vendeve të Evropës Juglindore.

¹²³ SEEPAG - Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore përbëhet nga prokurorë të Prokurorive të Përgjithshme nga 13 vendet anëtare të SELEC. Ky grup është një mekanizëm ndërkombëtar i bashkëpunimit gjyqësor, me një shprehje të qartë të vullnetit për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor në hetimet dhe rastet e krimit ndërkufitar.

praktikat më të mira në interesin e përbashkët, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e gjyqimit të krimeve në Evropën Juglindore.

- *Forcimi i Policisë, asosacioni i shteteve të Policisë në Evropën Juglindore (SEPCA)*¹²⁴

Asosacioni është i përkushtuar në ndërtimin e sigurisë publike në Evropën Juglindore nëpërmjet bashkëpunimit policor, bashkë me qytetarët dhe organizatat partnere. SEPCA promovon transformimin e policive me vizioni për të forcuar efektivitetin dhe demokratizimin e policive në Evropën Juglindore për mirëqenien e qytetarëve. SEPCA kontribuon në sigurinë rajonale dhe synon të jetë organizata lider në bashkëpunimin policor. Me një sekretariat fleksibël dhe nën-borde, ajo fokusohet në nivelin strategjik. Gjithashtu SEPCA favorizon partneritetin duke reduktuar dublikimet dhe synon rritjen e sinergjive midis institucioneve të sigurisë publike dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, duke qenë një partner i BE-së për bashkëpunimin policor strategjik. Vendet anëtare të SEPCA janë Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia.

- *Iniciativa rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI)*¹²⁵

Objektivi i MARRI është kontribuimi për lëvizjen e lirë dhe sipas rregullave të njerëzve në interes të sigurisë dhe prosperitetit duke u fokusuar në migracionin, azilin, menaxhimin e integruar të kufijve, politika e vizave dhe bashkëpunimi konsullor dhe integrimi i personave të kthyer. MARRI qeveriset nga 6 vende anëtare të cilët janë Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

- *Funksionimi i Task Forcave të ngritura SELEC*

¹²⁴ SEPCA - Forcimi i Policisë, Asosacioni i Shteteve të Policisë në Evropën Juglindore, u krijua në Janar 2002 në Pula, Kroaci dhe statuti i saj është miratuar në Tetor të 2002 në Bukuresht, Rumani. Në të njëjtën kohë, u zgjodhën Bordi Ekzekutiv dhe Menaxhmenti i asosacionit. Takimi i parë i përvitshëm zyrtar u mbajt në Qershor 2003 në Beograd, Serbi, ku u ngrit dhe zyra e sekretariatit.

¹²⁵ MARRI - Iniciativa rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët u krijua në vitin 2003 brenda kontekstit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Që prej vitit 2004 MARRI funksionon nëpërmjet dy mekanizmave, forumi rajonal i MARRI i cili siguron mbështetje politike dhe qendra rajonale MARRI me seli në Shkup, Maqedoni që zhvillon bashkëpunim praktik dhe mbështet zbatimin e vendimeve të marra nga forumi rajonal.

Aktualisht SELEC ka në përbërje të saj 8 Task Forca, të cilat janë:

- Task Forca kundër narkotikëve;
- Task Forca kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- Task Forca kundër terrorizmit;
- Task Forca kundër kontrabandës dhe mashtrimit financiar;
- Task Forca kundër trafikimit të mjeteve motorike;
- Task Forca kundër krimit kompjuterik;
- Task Forca kundër krimit ndaj natyrës dhe ambientit;
- Task Forca për sigurinë e kontenierëve.¹²⁶

Çdo vit organizohen takime të këtyre 8 Task Forcave ku marrin pjesë specialistë të fushës nga aparatet policore dhe doganore të vendeve anëtare, vendeve vëzhguese dhe përfaqësues nga organizatat partnere që kanë marrëveshje operationale me SELEC. Gjatë këtyre Task Forcave diskutohen hetimet e përbashkëta dhe operationet rajonale të zhvilluara në vitin paraardhës dhe bëhen propozimet për aktivitetet operationale të vitit në vazhdim. Në përfundim të vitit kalendarik, Sektori Analitik në SELEC përgatit Raportin Vjetor Operacional, ku përfshihen të dhënat vjetore mbi aktivitetin operacional të vendeve anëtare të koordinuara nga SELEC. Në këtë raport përfshihen të dhënat mbi sekuestrimet e lëndëve narkotike gjatë një viti, trafikimi i qenieve njerëzore dhe kalimi i paligjshëm i kufirit, sekuestrimi i cigareve dhe mallrave kontrabandë etj.

4.2.4 Kanalet e komunikimit të SELEC me vendet anëtare

SELEC bashkëpunon me shumë organizata ndërkombëtare ligj zbatuese siç janë INTERPOL, EUROPOL, WCO¹²⁷, CARRIC¹²⁸, EUBAM,¹²⁹ etj. Të gjitha këto organizata marrin pjesë në takimet vjetore të 8 Task Forcave të SELEC, që organizohen në Rumani dhe në vendet e tjera anëtare të SELEC. Gjatë këtyre takimeve diskutohet rreth mënyrave më të përshtatshme për shkëmbimin e informacionit, pjesëmarrjen në hetime të përbashkëta

¹²⁶ Shih: Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) <http://www.selec.org/>

¹²⁷ WCO - Organizata Botërore e Doganave

¹²⁸ CARRIC - Qendra Rajonale Aziatike për Koordinimin e Informacionit Kundër Narkotikëve

¹²⁹ EUBAM - Misioni i BE-së për Sigurinë e Kufijve të Moldavisë dhe Ukrainës

dhe përfshirja në operacione rajonale. Konventa e SELEC¹³⁰ përbën bazën ligjore të bashkëpunimit policor rajonal, në luftën kundër krimit ndërkufitar, në zbatim të së cilës, autoritetet angazhohen për forcimin e bashkëpunimit gjatë operacioneve dhe hetimeve me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin dhe për të luftuar kundër kërcënimeve duke:

- *“Vendosur forcat në zonat kufitare fqinje në përputhje me një planifikim të koordinuar,*
- *Planifikuar dhe realizuar programe të përbashkëta në fushën e parandalimit të krimit,*
- *Zhvilluar takime dhe bisedime në intervale kohore të rregullta në mënyrë që të mbahet nën kontroll dhe të ruhet cilësia e bashkëpunimit, të diskutohen strategji të reja, të koordinohen planet e patrullimit, kërkimit dhe operacioneve, të shkëmbehen të dhëna statistikore, dhe të koordinohen programet e punës,*
- *Lehtësuar vizitat e ndërsjellta studimore dhe trajnuese sipas marrëveshjeve të departamenteve të interesuara,*
- *Ftuar përfaqësues të palëve të tjera kontraktuese për të marrë pjesë në operacionet speciale si vëzhgues”¹³¹.*

SELEC ka detyrat e mëposhtme:

- *“Mbështetje për hetimet dhe aktivitetet e parandalimit të krimit në shtetet anëtare dhe në përputhje me Konventën;*
- *Mundësim të shkëmbimit të informacionit dhe informatave dhe të kërkesave për ndihmë operative;*
- *Njoftim dhe informim të Pikave Kombëtare të Kontaktit të shteteve anëtare për lidhjet me personave të dyshuar, kriminelët apo krimet e lidhura me mandatin e SELEC;*
- *Mbledhja, përpilimi, analizimi, përpunimi dhe përhapja e informacionit dhe informatave penale;*
- *Ofrimi i analizës strategjike dhe nxjerrja e vlerësimeve të rreziqeve në lidhje me objektivin e SELEC;*
- *Ngritja, vënia në shfrytëzim dhe mirëmbajtja e një sistemi informacioni të kompjuterizuar;*

¹³⁰ Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC)¹³⁰ nënshkruar në Bukuresht, Rumani, më 26 maj 1999, ratifikuar me Ligjin nr. 10299, datë 15.7.2010 “Për ratifikimin e Konventës së Qendrës së Zbatimit të Ligjit në Europën Juglindore”, shpallur me dekretin nr. 6649, datë 21.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

¹³¹ Shih: Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore, Neni 3- Masa të përgjithshme të bashkëpunimit, pika 2

- *Të veprojnë si ruajtës i praktikës së mirë për metodat dhe teknikat e forcave të ligjit dhe të nxisë të njëjtën gjë përmes trajnimeve dhe konferencave shumëkombëshe për shtetet anëtare, etj*".¹³²

4.2.5 Roli i oficerit ndërlidhës dhe sfera e informacioneve që shkëmbehen

Në zbatim të Nenit 9 të Konventës SELEC, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 02.07.2008 *"Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Greqi, Turqi, Itali, Kosovë, në Qendrën SECI, Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë dhe EUROPOL"*, shteti shqiptar përfaqësohet në SELEC me një oficer kontakti/ndërlidhës i atashuar në selinë e SELEC në Bukuresht. Detyrat e oficerit ndërlidhës i përcaktohen në Nenin 9 të Konventës, dhe për oficerët shqiptarë të atashuar në selitë e organizatave policore ndërkombëtare dhe në selitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, gjithashtu detyrat i specifikon Urdhri i ministrit të Brendshëm, i cili shprehet si më poshtë:

"Oficeri ndërlidhës ka detyrë të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin midis strukturave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve përkatëse të zbatimit të ligjit në vendin/organizatën ku është akredituar, për parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit në interes të palëve, si dhe lehtësimin e aktiviteteve gjyqësore të të dy vendeve".¹³³

Oficeri i kontaktit/ndërlidhës ka për detyrë¹³⁴:

- Të prezantojë pranë autoriteteve përkatëse në vendin apo organizatën ku është atashuar, në tërësi ose pjesërisht programin vjetor të Policisë së Shtetit, duke u bazuar në prioritetet e programit vjetor të Ministrisë së Brendshme, si dhe përmbledhjet e analizave vjetore të punës.
- Të ofrojë sugjerime për probleme dhe politika të ndryshme që mund të jenë me interes, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me strukturat përkatëse homologe.

¹³² Neni 2 dhe 3 i Konventës SELEC.

¹³³ Urdhër i ministrit të Brendshëm, nr. 1366, datë 26.11.2008, "Për detyrat dhe të drejtat e përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë që shërbejnë si oficer kontakti në ministritë homologe..."

¹³⁴ Marrë nga: Urdhër i ministrit të Brendshëm, nr. 1366, datë 26.11.2008, "Për detyrat dhe të drejtat e përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë që shërbejnë si oficer kontakti në ministritë homologe..."

- Të jap mendimin e tij në përgatitjen dhe miratimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e bashkëpunimit policor.
- Të kontribuojë në shpërndarjen dhe qartësimin e politikave të vendit në fushën e politikave të sigurisë.
- Të shkëmbej reciprokisht informacione zyrtare lidhur me krimin e organizuar, krimin ekonomik e financiar, krimet e rënda, format e rënda të krimit ndërkufitar, ndjekjen dhe kapjen e personave në kërkim, etj., dhe organizimin e operacioneve të përbashkëta policore në këto fusha.
- Të grumbullojë dhe analizojë informacione mbi ecurinë e kriminalitetit, organizatave kriminale, krimit të organizuar dhe krimeve të rënda të kryera nga shtetas shqiptarë në vendin ku është atashuar.
- Të kontribuojë me asistencë juridike ndërkombëtare për kapjen dhe ekstradimin e personave të kërkuar nga drejtësia e vendeve të interesuara.
- Të lehtësoj punën e institucioneve tona të zbatimit të ligjit, në rastet e hetimeve apo operacioneve të përbashkëta me institucionet e zbatimit të ligjit në vendin ku është i akredituar.

Aktualisht shteti shqiptar ka përfaqësuesit e tij në disa organizata policore ndërkombëtare dhe në përfaqësitë diplomatike në disa shtete, të cilët shërbejnë si oficer kontakti/ndërlidhës për bashkëpunimin policor. Ata përfaqësojnë Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit në këto vende:

- Në Itali, me dy oficerë ndërlidhës të atashuar në Romë.
- Në Greqi, me dy oficerë ndërlidhës të atashuar në Athinë dhe Selanik.
- Në Turqi, me një oficer ndërlidhës të atashuar në Stamboll¹³⁵, i cili ka juridiksion përfaqësimi edhe në Bullgari dhe Egjipt;
- Në Kosovë me një oficer ndërlidhës, të atashuar në Prishtinë i cili ka juridiksion përfaqësimi edhe në Maqedoni, Serbi, dhe Malin e Zi;


¹³⁵ Përfaqësimi në shtetet e tjera përcaktohet me Urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 253, datë 28.04.2009.

- Në Belgjikë me një oficer ndërlidhës të atashuar në Bruksel, i cili ka juridiksion përfaqësimi edhe në Luksemburg;
- Në Britaninë e Madhe me një oficer ndërlidhës të atashuar në Londër i cili ka juridiksion përfaqësimi edhe në Irlandë;
- Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me një oficer ndërlidhës të atashuar në Uashington;
- Në Gjermani, me një oficer ndërlidhës, të atashuar në Berlin;
- Në Francë, me një oficer ndërlidhës, të atashuar në Paris.

Përfaqësimi funksionon edhe me organizatat policore ndërkombëtare, europiane dhe rajonale, si:

- Në INTERPOL, me një oficer ndërlidhës, të atashuar pranë Interpol-it, në Lion;
- Në EUROPOL, me një oficer ndërlidhës, të atashuar në Europol, në Hagë;
- Në SELEC, me një oficer ndërlidhës, të atashuar në SELEC, në Bukuresht.

Foto 5: Skema e shpërndarjes së oficerëve shqiptar ndërlidhës të atashuar në vende të ndryshme



Burimi: ILECU-s Albania

Konventa SELEC, në Nenin 5 të saj identifikon sferën e informacioneve që shkëmbehen ndërmjet vendeve anëtare, të cilat kanë synim: parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, në veçanti krimin e organizuar, dhe konkretisht, ato informacione që lidhen me:

- *“Të dhënat e individëve të përfshirë në krimin e organizuar, të dhënat për lidhjet ndërmjet të dyshuarve dhe personave për të cilët ka dyshime në lidhje me kryerjen e veprave penale, njohuritë e tyre për strukturën e grupeve dhe organizatave kriminale, mbi modelet e sjelljes tipike të të dyshuarve dhe personave për të cilët ka dyshime apo të grupeve të dyshuara dhe grupeve për të cilët ka dyshime, informacion mbi veprat penale të përgatitura, në tentativë apo të kryera, sidomos për kohën, vendngjarjen dhe llojin e krimit, detaje mbi viktimat apo pronën e dëmtuar, të dhëna mbi rrethanat e veçanta dhe mbi dispozitat ligjore përkatëse, në rast se kërkohet të parandalohen, zbulohen dhe hetohen veprat penale;*
- *Mbi metodat dhe format e reja të krimit ndërkufitar;*
- *Mbi rezultatet kërkimore në lidhje me krimin dhe kriminologjinë, detaje mbi praktikën e zhvillimit të hetimeve, metodat dhe mjetet e punës, me synim zhvillimin e tyre të mëtejshëm,*
- *Mbi të dhënat e përpunuara dhe/ose kampionet (mostrat) e sendeve apo pronës që janë dëmtuar gjatë veprës penale, ose që janë përdorur apo tentuar të përdoren për kryerjen e një vepre penale, ose që kanë qenë rezultat i një vepre penale të kryer;*
- *Mbi produktet kriminale dhe asetet e përfituara nëpërmjet kryerjes apo përfshirjes në krim”¹³⁶.*

Nga një analizë e punës së bashkëpunimit policor ndërkombëtar, lidhur me aktivitetin e oficerëve ndërlidhës, konstatohet, se, nga viti në vit, për periudhen kohore që shtrihet ky studim, është rritur niveli i përfaqësimit në 9 shtete dhe 3 organizata policore ndërkombëtare. Për rrjedhojë, është rritur sasia e informacioneve të shkëmbyera, të cilat janë transmetuar nëpër linja të sigurta komunikimi. Po kështu, oficerët ndërlidhës kanë dhënë kontribut duke u përfshirë në operacione policore dhe hetime të përbashkëta, madje duke kryer veprime hetimore të deleguara edhe jashtë shtetit, në vendet ku janë atashuar.

¹³⁶ Shih: Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore, Neni 5- Sfera e informacioneve që shkëmbehen.

Kapitulli V: BASHKËPUNITIT POLICOR NË NIVEL DYPALËSH

5.1 Bashkëpunimi dypalësh për ekstradimin e personave

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet penale, Shqipëria i është përgjigjur pozitivisht kërkesave dhe është e interesuar për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit, lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për ekstradimin e ndërsjellët të personave. Këto marrëveshje burojnë nga Konventa Europiane për ekstradim, dhe fokusohen në ekstradimin e personave pavarësisht shtetësisë së tyre. Të tilla marrëveshje janë ajo me SHBA-në vitit 1935, me Italinë e vitit 2011, dhe me Kosovën e vitit 2013.

5.1.1 Legjislacioni për ekstradimin e personave të proceduar penalisht

Shqipëria bën pjesë në vendet e Europës Juglindore me kriminalitet relativisht të lartë. Duke iu referuar komunikatave ditore të policisë konstatohet se çdo ditë ndodhin ngjarje me natyrë kriminale, për të cilat kryhen veprime hetimore si, këqyrje, mbledhje dhe administrim i provave materiale, marrja e deklarimeve, ekspertime hetimore etj, për të cilat referohet fillimi i procedimit penal. Por, duke bërë një analizë të përgjithshme lidhur me autorët e ngjarjeve kriminale, rezulton se, disa identifikohen dhe kapen në flagrancë menjëherë mbas kryerjes së krimit, disa identifikohen me vonesë pas ekzaminimit dhe ekspertimit të gjurmëve, ndërsa të tjerë largohen jashtë shtetit për t'u fshehur apo për t'iu shmangur përballjes me hetimin. Për kapjen e tyre, angazhohen shërbimet policore të shteteve të ndryshme, të cilat koordinojnë nëpërmjet tyre për ekstradimin në vendin kërkues. Dy janë kushtet kryesore për akordimin e ekstradimit nga brenda jashtë, sipas legjislacionit shqiptar:

- a. Identiteti i normave, që do të thotë që vepra penale të parashikohet si e tillë në legjislacionin penal shqiptar;
- b. Parimi i specialitetit, që i referohet kushteve të ekstradimit, që sipas nenit 490, pika 1 e Kodit të Procedurës. Penale, ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti

tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.¹³⁷

Një definicion paraprak lidhur me ekstradimin e personit, mund ta përshkruajmë si: *dorëzimin e ndërsjellët, sipas kushteve dhe rregullave të caktuara, të personave që ndiqen penalisht për një vepër penale, ose kërkohen me qëllim ekzekutimi të një vendimi dënimi ose mase sigurie nga autoritet gjyqësore të palës kërkuese*¹³⁸. Pra, shteti të cilit i kërkohet, i dorëzon një person të gjendur në territorin e tij një shteti tjetër.¹³⁹

Në procesin e ekstradimit si bazë ligjore shërbejnë; Kushtetuta e Interpolit, Kodi i Procedurës Penale, si dhe ligji ndërkombëtar për marrëveshjet dypalëshe, konventat shumëpalëshe, siç është Konventa Evropiane e Ekstradimit, si dhe dokumentet themelore të Interpol-it, etj. Gjithsesi, ekstradimi bëhet për tre qëllime:

1. *Për transferimin e personave, ndaj të cilëve ka filluar çështja penale në shtetin e kërimit;*
2. *Për zbatimin e një mase sigurie, sipas vendimit të autoritetit gjyqësor të shtetit të kërimit;*
3. *Për vënien në ekzekutim të një vendimi dënimi të formës së prerë, të dhënë nga gjykata e shtetit kërkues.*¹⁴⁰

Procesi për shpalljen në kërkim ndërkombëtar, kryhet nëpërmjet organizatës së INTERPOL-it,¹⁴¹ në të cilën aderojnë të gjitha ato shtete të cilat kanë pranuar dhe ratifikuar me ligj Kushtetutën e organizatës.

¹³⁷ Jola Xhafo, E Drejta Penale Ndërkombëtare, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë 2007, faqe 288.

¹³⁸ Sipas Konventës Evropiane të Ekstradimit, viti 1957

¹³⁹ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 488.

¹⁴⁰ Revista Shkencore “Hulumtime Shkencore 4”, botim i UV. Kristal, Tiranë, Albania. ISSN: 2226-1605, Qershor 2013, fq. 55.

¹⁴¹ Kushtetuta e Interpolit, viti 1956, neni 2, pika 1 dhe 2, parashikon se: “Interpol-i ka si qëllim të sigurojë bashkëpunimin e ndërsjellët midis të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kufijve të ligjeve ekzistuese në vende të ndryshme dhe nën frymën e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe të vendos e zhvillojë asistencë të përbashkët midis të autoriteteve policore dhe të gjitha institucioneve që kontribuojnë efektshmëri në parandalimin dhe luftën kundër krimit”

a. Kërkesa për ekstradimin e personit të kërkuar

Sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar rezultojnë dy lloje ekstradimi; ekstradim për jashtë ose ekstradim *pasiv*, dhe nga jashtë brenda ose *aktiv*. Kërkesa për ekstradim është një dokument i formuluar me shkrim që i drejtohet shtetit të kërkuar në rrugë diplomatike. Është kusht që shteti kërkuar të jetë palë e marrëveshjes në kuadrin e Konventës së Evropës dhe protokolleve shtesë të saj. Kur ndaj një personi që gjendet jashtë shtetit është caktuar një masë sigurimi për kufizimin e lirisë, ose nëse ndaj tij është dhënë një vendim dënimi me burgim i formës së prerë, ministri i Drejtësisë mund të paraqesë kërkesë për ekstradimin e tij, bazuar mbi informacionin dhe dokumentet e përcjella nga Prokurori i Përgjithshëm. Kërkesa përcillet nëpërmjet ministrisë së Jashtme¹⁴² dhe shoqërohet edhe nga dokumentacioni plotësues, në të cilin përfshihen këto materiale shkresore, të detyrueshme, të renditura si më poshtë:

- Originali ose kopja e vërtetuar autentike, e vendimit për një dënim për t'u zbatuar, e një urdhri arresti, apo çdo akti tjetër që ka të njëjtën fuqi vepruese, lëshuar sipas rregullave që përmban ligji i palës kërkuar.
- Një pasqyrë e fakteve në bazë të të cilave është kërkuar ekstradimi, sikurse janë koha dhe vendi i kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes së shkeljeve në fjalë, cilësimi i tyre ligjor dhe referimet ndaj depozitave ligjore që janë të zbatueshme në këto raste, të cilat duhet të zbatohen sa më saktë që të jetë e mundur, si dhe një relacion i plotë lidhur me aktet procedurale, mbi bazën e të cilave identifikohet personi si autor i ngjarjes.
- Një kopje e dispozitave ligjore të zbatueshme, ose në rast se kjo nuk është e mundur, një deklaratë mbi të drejtën e zbatueshme, si dhe një përshkrim sa më të saktë të tipareve të individit të kërkuar, si dhe çdo informacion që mund të shërbejë për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e tij, në lidhje me provat që vërtetojnë

¹⁴² Kodi i Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar me ligjin nr. 9276, datë 16.09.2004.

identifikimin e plotë të personit, si fotografi, pasaportë, kartelë daktiloskopike e gjurmëve, etj.¹⁴³

Eksperiencat policore, lidhur me procedurat për kryerjen e ekstradimit të personave në vende të ndryshme të Evropës, konstatojnë se, autoritetet ndeshen me fakte të tjera si; kërkesë për ekstradim nga disa shtete njëherësh për të njëjtin person, apo dhe refuzim të ekstradimit, për arsye nga më të ndryshmet të cilat mund të jenë për shkak të dokumentacionit jo të plotë apo arsye të tjera të pa parashikuara, etj. Prandaj është e domosdoshme të bëhet një analizë e shkaqeve se përse ndodh ky refuzim, si dhe marrja e masave paraprake për ta parandaluar.

Rast studimor: Konkurrin i kërkesave për ekstradim, ku kërkohet njëkohësisht nga disa shtete ekstradimi i një shtetasi shqiptar.

Objekt studimi është kërkesa për ekstradimin e shtetasit shqiptar A.Sh, i kërkuar për disa krime të rënda në Shqipëri, dhe njëkohësisht i kërkuar për trafikim ndërkombëtar droge nga disa shtete.

Nga ana e ZQK Interpol Tirana, më datë 21.01.2003 është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar i shtetasit shqiptar A.Sh¹⁴⁴, i cili nga Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin nr. 289, datë 21.12.2001 është dënuar me 7 vjet burg për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjithashtu, ky shtetas ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, pasi Gjykata e Torinos kishte vendosur ndaj tij masën e sigurisë “arrest në burg” për akuzën e trafikut ndërkombëtar të drogës.

Shtetasi në kërkim u arrestua më datë 25.03.2006 në lagjen “Batiken” në Ankara, me qëllim ekstradimi, bazuar në kërkesën e ZQK Interpol Tirana. Ministria e Drejtësisë nëpërmjet kanaleve diplomatike dërgoi në Ankara kërkesën për ekstradimin e shtetasit A.Sh., por një kërkesë e tillë u bë edhe nga ministria e Drejtësisë së Italisë. Njëkohësisht, këtë shtetas e kërkonin dhe vende të tjera si Gjermania, Bullgaria, Rumania, Maqedonia,

¹⁴³ Interpretimi pasqyrohet në Kodin e Procedurës Penale, neni 489, i cili i referohet Konventës Evropiane e Ekstradimit, viti 1957, nenin 12.

¹⁴⁴ http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=509%3A-ekstradohet-aldo-bare&catid=82%3Aekstradime-2009&Itemid=249&lang=sq

ku sipas kërkesës së tyre për ekstradim, ai rezultonte si drejtues i një rrjeti të trafikut ndërkombëtar të drogës.

Gjithashtu, prej vitit 1997 e në vijim ky person ishte nën hetim për disa vepra të rënda kriminale ndodhur në Shqipëri, si: për më tepër se 20 vrasje, për vrasje dhe dekapitim (prerjen e kokës dhe shëtitjen në publik), për rrëmbim personi, shkatërrim prone, dhunim varresh, kryerje veprash penale në bashkëpunim nga organizata kriminale, etj.

Shtetasi shqiptar fillimisht kërkoi azil politik në Turqi, por kërkesa e tij nuk u miratua nga autoritetet e Turqisë, me arsyetimin se nuk përmbushte kriteret e kërkuara ligjore.

Pasi përfunduan të gjitha procedurat ligjore përkatëse, autoritetet turke miratuan ekstradimin e shtetasit shqiptar drejt Shqipërisë, ekstradim i cili u krye më datë 25.11.2009.

Si përfundim, duhet theksuar se, arrestimi i shtetasit të sipërcituar u arrit si rezultat i një pune inteligjente policore në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar, nëpërmjet së cilës u finalizua identifikimi i tij, i cili përbën një sukses për strukturat kombëtare. Ndërsa ekstradim tregoi rritjen e shkallës së besimit të ndërsjellët dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve ligjzbatuese të të dy vendeve.

Kur vepra penale mbi bazën e të cilit kërkohet ekstradimi të ndëshkohet me vdekje nga ligji i palës kërkuese dhe, në rast se ky dënim nuk parashikohet si dënim në legjislacionin e palës së kërkuar, ose kur në përgjithësi nuk zbatohet në atë vend, ekstradimi mund të mos akordohet, përveçse me kusht, që pala kërkuese të jap sigurime të vlerësuar dhe të mjaftueshme, se dënimi me vdekje nuk do të zbatohet.¹⁴⁵ Konkretisht, rast tipik është refuzimi i ekstradimit nga pala shqiptare, i kërkesës së Interpol-Pekinit/Kinë, lidhur me ekstradimin e pesë ujugurëve kinezë të cilët janë akomoduar në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve, në Linzë, Tiranë. Pra, vepra penale për të cilën akuzohen ujugurët kinezë, në kodin penal kinez parashikohet dënim me vdekje, dhe në rast se do të ekstradoheshin në Kinë, ky dënim do të ekzekutohej. Në rastin konkret, vendimi për refuzim është bërë duke i`u përmbajtur jo vetëm dokumenteve themelore ndërkombëtare lidhur me ekstradimin, si; Konventa Evropiane për Ekstradim, Statuti i Romës, dhe Kushtetuta e Interpol-it, por dhe legjislacionit tonë të brendshëm. Kjo e drejtë buron nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, të cilën vendi ynë e ka ratifikuar atë me ligj.

¹⁴⁵ Interpretim sipas Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, ekstradimi nuk akordohet edhe në rast se shkelja për të cilën është kërkuar, konsiderohet nga pala e kërkuar si shkelje politike, ose si një fakt që lidhet me këtë shkelje.

Rast studimor: Refuzimi i kërkesës për ekstradim.

Sipas legjislacionit ndërkombëtar, refuzimi i kërkesës për ekstradim ndodh kur, pala e kërkuar ka arsye serioze të besojë se kërkesa për ekstradim të personit të shpallur në kërkim ndërkombëtar është motivuar me një shkelje që përbën faj ordiner, por është paraqitur me qëllim që të ndiqet ose të dënohet një individ për arsye race, feje, kombësie dhe opinionin politik, ose kur pozita e këtij individ rrezikon të dënohet për njërën ose tjetrën nga këto arsye.¹⁴⁶

Si rast studimor, lidhur me refuzimin e ekstradimit dhe marrjen e azilit politik, shqyrtojmë rastin e kërkesës së ekstradimit të shtetasit shqiptar H.H, i arrestuar në Suedi:

Nga ana e ZQK Interpol Tirana, më datë 13.03.2006 është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar i shtetasit shqiptar H.H, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me Vendimin nr. 18, datë 17.05.2005 ka caktuar masën e sigurisë “arrest në burg” pasi akuzohet për veprën penale të vrasjes. Në dosjen hetimore rezulton se ky shtetas është autor i një vrasjeje të ndodhur në Tropojë në vitin 1993, vrasje e ndodhur në vitin 1998, si dhe vrasjen e dy shtetasve shqiptar, ndodhur në Tropojë në vitin 2005. Dosja e transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila e ka dënuar shtetasin në fjalë me 25 vjet burgim.

Shtetasi i mësipërm më datën 12.02.2007 u arrestua në qytetin Goteborg në Suedi, me qëllim ekstradimi drejt Shqipërisë, bazuar në kërkesën e ZQK Interpol Tirana për shpalljen në kërkim ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë nëpërmjet kanaleve diplomatike, dërgoi në Goteborg kërkesën së bashku me dokumentacionin përkatës për ekstradimin në Shqipëri të shtetasit H.H, për tu hetuar dhe gjykuar për veprat penale për të cilat akuzohej.

Gjykata e Shkallës së Parë e Goteborgut në Suedi, pasi u njoh me kërkesën e autoriteteve shqiptare për ekstradimin shtetasit, si dhe dëgjoji pretendimet e palës mbrojtëse të shtetasit shqiptar H.H, vendosi mos akordimin e ekstradimit. Të njëjtin vendim dha edhe Gjykata suedeze e Apelit, bazuar në kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme shqiptare e cila apeloj vendimin e Gjykatës së Goteborgut. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë suedeze (HD), la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të Suedisë, me arsyetimin se të drejtat e tij në Shqipëri nuk do të respektoheshin dhe jeta e tij nuk do të ishte e sigurt. Madje, në arsyetimin e vendimit, gjykata duke marr në konsideratë kërkesën e shtetasit H.H për azil politik në Suedi, ka cituar një raport të vitit 2007 të Ministrisë së Jashtme suedeze mbi situatën e të

¹⁴⁶ Konventa Evropiane e Ekstradimit, viti 1957, nenet 10 dhe 11.

drejtave të njeriut në Shqipëri. Gjithashtu, gjykata i`u referua dhe komenteve të disa politikanëve shqiptarë të pasqyruara në disa media vizive dhe të shkruara në Shqipëri, lidhur me vrasjet e ndodhura dhe rrezikshmërinë e të dënuarit H.H dhe të afërmeve të tij. Kështu, që prej vitit 2008, shtetasi shqiptar H.H gëzon statusin e azilantit politik në Suedi.

Si përfundim, mund të themi se, sistemi i drejtësisë shqiptare mundi të përmbushur misionin e saj, lidhur me fajësinë e autorit për krimet e kryera, por dështoj në përpjekjet për ekstradimin e tij, pasi nuk mundi t`i rrëzonte pretendimet e palës mbrojtëse për azil.

5.1.2 Marrëveshja e ekstradimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Për disa dekada me radhë, Traktati i Ekstradimit me SHBA-të¹⁴⁷ ka qenë marrëveshja e vetme nëpërmjet së cilës Shqipëria pranonte ekstradimin e shtetasve të vet për jashtë shtetit¹⁴⁸. Për kohën në të cilën u nënshkrua, ky Traktat ishte një arritje e madhe për vendin tonë, jo vetëm për efektin juridik të saj, por edhe në aspektin politik, pasi nënshkruhej ndërmjet një vendi të vogël dhe shteteve më të fuqishme të botës. Për të evidentuar rëndësinë e kësaj marrëveshje mjafton të përmendësh faktin se kanë kaluar shumë vjet nga ratifikimi i saj dhe vazhdon ti shërbej ende qëllimit për të cilin u nënshkrua vite më parë.¹⁴⁹ Hyrja e Traktatit parashikon gatishmërinë ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA për të bashkëpunuar ndërmjet tyre në fushën e ekstradimeve. Neni 1 dhe 2 parashikojnë përkatësisht të drejtat dhe detyrimet në kuadër të këtij Traktati, dhe listën prej prej 26 veprash penale, për të cilat mund të aplikohet për ekstradim të autorëve. Ndërsa Neni 3 parashikon refuzimin e ekstradimit për çështje të karakterit politik, sipas së cilit: "*Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi ose gjykatat e këtij shteti, do të vendosin nëse çështja ka karakter politik*". Neni 3 parashikon, gjithashtu, se:

¹⁴⁷ Traktati u nënshkrua në Tiranë më datë 1 mars 1933. Senati e dhe pëlqimin për ratifikim më datë 2 shkurt 1934. Traktati u ratifikua nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 21 shkurt 1934. Traktati është ratifikuar nga Shqipëria më 20 prill 1935. Ratifikimet u shkëmbyen në Uashington DC, më 14 nëntor 1935. Traktati hyri në fuqi 14 nëntor 1935, dhe u shpall nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 19 nëntor 1935.

http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_United_States_extradition_treaties

¹⁴⁸ Po aty. http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_United_States_extradition_treaties

¹⁴⁹ Halim Hasalami, Artan Hoxha, Ilir Panda: "Procedura Penale", Shtëpia Botuese "MORAVA", Tirane 2006, faqe 661 dhe 662.

"Kur faji i ngarkuar është ose vrasje ose asgjësimin ose helmim, qoftë i kryer, qoftë i tentuar, fakti që faji është kryer ose tentuar kundër jetës së sovranit ose shefit të shtetit të njëjës nga palët e larta kontraktuese, ose kundër sovranit ose shefit të një shteti të huaj, ose kundër jetës së ndonjërit prej anëtarëve të familjes së tij , mjafton për të mos i dhënë këtij delikti karakter politik as për ta lidhur këtë me delikte me karakter politik".¹⁵⁰

Neni 4 parashikon se, personi i ekstraduar nuk duhet të gjykohet apo të dënohet për një vepër tjetër penale përveç asaj për të cilën është dhënë ekstradimi:

"...Askush nuk do të gjykohet për ndonjë delikt të kryer përpara ekstradimit të tij, veç se për deliktin për të cilin është dorëzuar, ose rastit kur ky ka qenë i lirë për një muaj rresht të dalë jashtë shtetit pasi të ketë qenë gjykuar, ose në rast dënimi, të ketë vuajtur dënimin ose të jetë falur".

Neni 5 parashikon, se, nuk mund të kërkohet ekstradimi i një personi për një vepër penale që është parashkrua.:

"...Asnjë kriminel i arratisur nuk do të dorëzohet në mbështetje të dispozitave të këtij traktati kur, për shkak parashkrimi ose për arsye tjetër ligjore sipas ligjeve përkatëse të shtetit kërkues. Krimineli përjashtohet nga ndjekja ose ndëshkimi për deliktin për të cilin kërkohet ekstradimi".

Neni 6 lidhet me shtyrjen e ekstradimit në rastet kur personi që kërkohet të ekstradohet është arratisur. Sipas këtij neni, kur personi i kërkuar është arratisur, ka kërkuar strehim në një shtet në të cilin është duke vuajtur dënimin për një vepër penale të kryer, atëherë ekstradimi duhet të shtyhet deri në momentin kur personi përfundon dënimin sipas legjislacionit të shtetit në të cilin ndodhet. Konkretisht ky nen parashikon, se:

"... kur një kriminel i arratisur, ekstradimi i të cilit kërkohet sipas përcaktimeve të këtij Traktati, kur ndodhet në ndjekje, është i liruar me garanci, ose mbahet i burgosur për ndonjë delikt të kryer në shtetin ku ka kërkuar strehim ose ka qenë dënuar për atë delikt, ekstradimi i tij mund të shlyhet deri sa ndjekjet në fjalë të jenë përfunduar, dhe ai të jetë liruar sipas dispozitave ligjore".

Ndërsa Neni 7 lidhet me rastet e konkurrimit të kërkesave për ekstradim, sipas të cilit , në rastin kur janë paraqitur disa kërkesa për ekstradimin e një personi, duhet të favorizohet

¹⁵⁰ Neni 3, i Traktatit për ekstradim ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

kërkesa që është paraqitur më përpara në kohë, duke përjashtuar rastin kur hiqet dorë nga kërkesa. Ky nen parashikon, se:

"...Kur një kriminel i arratisur që reklamohet prej njëres nga dy palët e kësaj marrëveshjeje kërkohet edhe më shumë se nga dy shtete ne bazë të dispozitave të traktateve për delikte të kryer përbrenda juridiksioneve të tyre, ky kriminel do ti dorëzohet atij shteti, kërkesa e të cilit ka mbërritur e para, veç kur hiqet dorë nga kërkesa".

Neni 8 parashikon mungesën e detyrimit për ekstradimin e shtetasve respektivë përveç kur shtetësia është marrë pas kryerjes së deliktit për të cilin kërkohet ekstradimi. Në të tilla raste i takon shtetit të cilit i kërkohet ekstradimi të evidentojë nëse personi që kërkohet është apo jo shtetas i tij. Ndër të tjera Neni 8 parashikon, se:

"...Sipas marrëveshjeve të këtij traktati asnjëra nga palët e larta kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të ekstradojë shtetasit e vet, veç kur shtetësia është marrë pas kryerjes së deliktit për të cilin kërkohet ekstradimi. Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi vendos nëse personi i reklamuar është shtetas i tij".

Neni 9 parashikon aspektet teknike lidhur me, shpenzimet përkatëse të ekstradimit; asistencën teknike të palëve gjatë ndjekjes së procedurave; si dhe me përfitimet e nëpunësve që merren me procedurat e ekstradimit, nga shteti të cilit i kërkohet ekstradimi, dhe konkretisht:

"...Shpenzimet e transportimit të të arratisurit do të paguhet prej qeverisë që paraqet kërkesën për ekstradim. Nëpunësit kompetent të drejtësisë së shtetit ku janë duke u kryer veprimet e ekstradimit do të ndihmojnë nëpunësit e qeverisë që kërkon ekstradimin përpara gjykatësve dhe magjistratëve përkatës me të gjitha mjetet ligjore që disponojnë, dhe asnjë shpenzim nuk do të kërkohet nga qeveria që reklamon ekstradimin përveç shpenzimeve për ushqim dhe fjetje të të arratisurit përpara dorëzimit të tij, të shkaktuara prej arrestimit, burgimit, hetimit dhe ekstradimit të të arratisurit sipas këtij traktati".

"...Nëpunësi ose nëpunësit e qeverisë dorëzuese që ndihmojnë, të cilët në vazhdim të rregullt të detyrës së tyre nuk kanë për të marrë asnjë rrogë ose shpërblim veç taksave specifike për shërbime të kryera, do të kenë të drejtë të marrin nga qeveria që kërkon ekstradimin taksa të zakonshme për veprimet ose shërbimet e kryera prej tyre në mënyrën dhe në sasinë sikur këto veprime ose shërbime të ishin kryer në proceset penale ordinere sipas ligjeve të shtetit në shërbim të të cilit ndodhen si nëpunës".

Neni i 10, parashikon dorëzimin e sendeve që burojnë nga vepra penale, që kanë lidhje me të, apo që shërbejnë si provë në dokumentimin e veprës penale. Sipas këtij neni sendet duhet ti kalojnë shtetit kërkues së bashku me personin që kërkohet të ekstradohet. Ndërsa neni i 12-të, parashikon shtrirjen territoriale të këtij traktati, duke nënvizuar se ky traktat është njësoj i vlefshëm për tërë territorin mbi të cilin secili nga shtetet ka pushtet efektiv, titullarin kompetent për të ngritur kërkesën për ekstradim kur personi që kërkohet të ekstradohet ka statusin e të arratisurit nga drejtësia; si dhe kryerjen e procedurave të arrestimit të personit subjekt ekstradimi bazuar në legjislacionin kombëtar të palëve nënshkruese. Ndërsa paragrafi i katërt parashikon:

"...Çdo i arrestuar përkohësisht do të lirohet veç në rastin kur brenda dy muajve nga data e arrestimit në Shqipëri ose në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kërkesa formale për dorëzim së bashku me dokumentet provuese të parashikuar këtu poshtë do të jenë paraqitur sikundër përmendet këtu sipër prej agjentit diplomatik të qeverisë kërkuese ose në mungesë të tij, prej një nëpunësi konsullor të asaj qeverie".

Sipas nenit 12 të këtij Traktati, në rastin e arrestimit të përkohshëm, secila palë kërkuese duhet që brenda dy muajve ti drejtoj shtetit të kërkuar kërkesën për ekstradim së bashku me dokumentacionin përkatës, në të kundërt shteti i kërkuar liron personin e arrestuar përkohësisht. Ndërsa, Neni i 13-të, parashikon periudhën kohore të mbajtjes në fuqi dhe kushtet e ndërprerjes së fuqisë së marrëveshjes. Konkretisht, ky nen parashikon:

"...Ky traktat do të mbetet në fuqi për një periudhë prej pesë vjetësh dhe në rast se asnjëra nga palët e nalta kontraktuese nuk do të ketë njoftuar një vit përpara mbarimit t' kësaj periudhe qëllimin e vet për ti dhënë fund traktatit, ky do të vazhdojë të mbesë në fuqi deri në mbarimin e një viti prej datës në të cilën të jetë dhënë një njoftim i tillë prej njëres ose tjetrës nga palët e nalta kontraktuese.¹⁵¹

Aktualisht ky traktat është në fuqi, përderisa nuk ka ndonjë kërkesë për dhënien fund të tij.

Rast studimor: *Mos respektimi i sistemit të drejtësisë nga Ministria e Drejtësisë, lidhur me përfundimin e procedurave ligjore të ekstradimit.*

Objekt studimi është çështja e ekstradimit të shtetasit A.R drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 2010, i kërkuar për vrasje në New York.

¹⁵¹ Nenet 2-13, Traktati i ekstradimit midis SH.B.A dhe R.SH, nënshkruar me 1 mars 1933.

Departamenti i Drejtësisë së Uashingtonit me shkresën e datës 24.08.2010, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë në rrugë diplomatike, ka paraqitur kërkesën për ekstradim të shtetasit shqiptar A.R, dhe ka dorëzuar kërkesën për ekstradim. Kjo kërkesë shoqërohej nga akt akuza e Gjykatës së Distriktit të New York me nr. ref S5 10Cr.464, vendimi i së njëjtës gjykatë i datës 19.08.2010 për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, si dhe dokumentacioni përkatës për rrethanat e ngjarjes dhe identifikimin e personit.

Ekstradimi i shtetasit shqiptar A.R kërkohej në kuadër të hetimit dhe gjykimit të tij penal për akuzat “Anëtarësim në organizatë kriminale për qëllim shantazhi, vrasje, rrëmbim, shpërndarje narkotikësh, vjedhje, marrje parash me force”, “Bashkëpunim në organizatë kriminale me qëllim shantazhi”, “Përdorim dhe mbajtje e armëve të zjarrit”, “Bashkëpunim dhe shpërndarje të lëndëve narkotike”, “Bashkëpunim në grabitje”, “Pengmarrje me anë të shantazhit”, “Mbajtje të armëve me qëllim pengmarrje”, “Vrasje”, vepra penale të parashikuara nga Kreu 18 i Kodit Penal të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Paragrafi 1962, Kreu 21, paragrafi 812, 841/a, 841/b, 846, Kreu 18, paragrafi 1951, Kreu 18, paragrafi C, 924 (C), 1959, Kreu 18, paragrafi 924, Kreu 18, paragrafi 1959.¹⁵²

Më datë 02.05.2010 shtetasi shqiptar u arrestua në Tiranë nga strukturat policore shqiptare, me qëllim ekstradimi, bazuar në urdhër arrestin ndërkombëtar të mbërritur në ZQK Interpol Tirana, nga zyra homologe amerikane.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 39/2 të Kushtetutës¹⁵³ së Shqipërisë, në nenet 488 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në Traktatin mbi Ekstradimet ndërmjet Shqipërisë dhe Shtetit të Bashkuara të Amerikës, të nënshkruar në vitin 1933, me Vendimin nr. 1275, datë 30.09.2010 vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për ekstradimin e shtetasit A.R drejt shtetit kërkuar të ekstradimit SHBA, për hetimin dhe gjykimin e tij në lidhje me veprat penale të parashtruara në kërkesën për ekstradim. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin nr. 861, datë 01.11.2010.

Shtetasi AR nëpërmjet mbrojtësit të tij ligjor bëri rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës për ekstradim, me pretendimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka administruar garancinë e lëshuar nga organi kompetent në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për mosaplikimin e dënimit me vdekje për të. Ndërkohë, më datë 24.11.2010 u realizua ekstradimi i shtetasit të mësipërm drejt Sh.B.A-ve, bazuar Vendimin nr. 861, datë 01.11.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁵² Shih: Vendimi nr. 234, datë 02.03.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁵³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e sanksionon qartë në nenin 39/2 të saj se, ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor.

Dy ditë pas ekstradimit të personit, më datë 26.11.2010, Gjykata e Lartë me Vendimin nr. 44, ka vendosur prishjen e Vendimit nr. 861, datë 01.11.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Vendimin nr. 1275, datë 30.09.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Çështja kaloi përsëri për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila me Vendimin Nr. 257 datë 28.09.2011 vendosi ekstradimin e shtetasit shqiptar A.R, e mandej në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila me Vendimin nr. 234, datë 02.03.2012 vendosi lënien në fuqi të Vendimit nr. 257 akti, datë 28.09.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë që tashmë personi kishte dy vjet që ishte ekstraduar drejt shtetit kërkues, madje pasi kishte pranuar fajësinë për 9 vepra penale për të cilat ishte akuzuar, kishte marr garancinë nga Gjykatës se Distriktit të New York se dënimi i tij do të ishte maksimalisht burgim i përjetshëm.¹⁵⁴

Duke ju referuar legjislacionit kombëtar, por edhe atij ndërkombëtar, ministria e Drejtësisë mund të refuzoj akordimin e ekstradimit edhe pa kaluar në procedurat gjyqësore, për arsye të ndryshme, si: në rast se shteti kërkues nuk është palë në Konventën për Ekstradim, nuk ka marrëveshje dypalëshe ekstradimi, apo kur subjekti kërkohet për krime politike, fetare, etj, por nuk mund të miratoj dhe urdhëroj asnjëherë ekstradimin, pa përfunduar procedurat gjyqësore, deri në një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Sa sipër, vërehet se, ministria jonë e Drejtësisë, është nxituar në ekstradimin e shtetasit të mësipërm, pasi miratoi ekstradimin e shtetasit pa përfunduar procesi në të gjitha shkallët e gjyqësorit, pavarësisht se veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi parashikohen si të tilla edhe nga legjislacioni ynë i brendshëm. Ngërçi do të ishte nëse në përfundim të shqyrtimit gjyqësor do të vendosej që shtetasit në fjalë të mos ekstradohej. Në të tilla rastet pyetjet do të ishin:

- *Çfarë fuqie ligjore do të kishte vendimi i Gjykatës?*
- *Si do të justifikonte ministri i Drejtësisë miratimin e ekstradimit?*
- *Po nëse, gjykata amerikane do të vendoste dënimin me vdekje të shtetasit shqiptar?.*

5.1.3 Marrëveshja e ekstradimit me Italinë

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar marrëveshjen për ekstradim me Italinë¹⁵⁵ sipas së cilës palët kontraktuese pranojnë ekstradimin e shtetasve të saj mbi baza reciprociteti në

¹⁵⁴ Shih Vendimin nr. 234, datë 02.03.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁵⁵ Ratifikuar me Ligjin nr. 9872, datë 11.02.2008.

përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane "Për Ekstradimet" duke specifikuar gjithashtu edhe organet kompetente për ndjekjen e procedurave.¹⁵⁶ Qëllimi që kanë palët lidhet së pari me lehtësimin e zbatimit dhe me plotësimin e konventës për ekstradimet. Të dy shtetet heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë siç parashikohet në nenin 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane "Për ekstradimin". Sipas marrëveshjes, palët kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit¹⁵⁷.

Marrëveshja në fjalë, në nenin 18 të saj "Ekstradimet e shtetasve" ka parashikuar:

"...Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat apo kërkesat e Konventës Evropiane "Për ekstradimin". Palët kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit.¹⁵⁸ Kërkesat për ekstradim bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore. Për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra pranë Ministrisë së Drejtësisë; Për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë".

Lidhur me ekstradimin, legjislacioni italian parashikon se, vendimi për ekstradimin e një shtetasi të huaji nuk mund të jepet pa vendimin favorit të Gjykatës së Apelit¹⁵⁹, ndërsa Neni 703 ka parashikuar vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili merr kërkesën për ekstradim nga Ministria e Drejtësisë, i kërkon autoritetit kompetent të huaj nëpërmjet ministrisë së Drejtësisë dokumentet dhe informacionin e nevojshëm, dhe ka detyrimin që brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës nga Ministria e Drejtësisë t'ia kalojë

¹⁵⁶ Neni 18, pika 3 e Marrëveshjes parashikon se, kërkesat për ekstradimin bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore: për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra II, pranë Ministrisë së Drejtësisë; ndërsa për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë.

¹⁵⁷ Neni 18, pika 2 e Marrëveshjes.

¹⁵⁸ Neni 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane "Për ekstradimin" ka parashikuar se shtetet ratifikuese kanë të drejtë të heqin dorë nga ekstradimi i shtetasve të tyre, duke iu lënë mundësi që për një çështje të tillë, shtetet të mund të disponojnë mbi bazë reciprociteti.

¹⁵⁹ Neni 701 i K.Pr.Penale italian parashikon se Gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjeve të ekstradimit është Gjykata e Apelit, ndërsa Neni 704 ka parashikuar procedurën e kësaj gjykate.

çështjen për shqyrtim gjykatës,¹⁶⁰ e cila ka detyrimin t'i komunikojë palëve datën e seancës gjyqësore dhjetë ditë përpara zhvillimit të saj, dhe vendos në dhomën e këshillimit pasi ka marrë të gjitha informacionet dhe pasi ka dëgjuar palët për lejimin ose jo të ekstradimit, dhe kur vendimi është në favor të ekstradimit caktohet data e dorëzimit të personit që do të ekstradohet.

Sipas legjislacionit italian, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Kasacionit nga personi i interesuar apo nga përfaqësuesi i tij, nga Prokurori i Përgjithshëm dhe nga përfaqësuesi i shtetit që e kërkon¹⁶¹. Pezullimin e dorëzimit të personit që kërkohet të ekstradohet parashikohet në Nenin 709, sipas së cilit pezullimi aplikohet në qoftë se personi duhet të gjykohej në territorin e shtetit të kërkuar, ose do t'i ulet dënimi për krimet e kryera para ose pas krimit për të cilin është dhënë ekstradimi, megjithatë pjesën e dënimit të mbetur (për një vepër penale të ndryshme nga ajo për të cilën kërkohet ekstradimi) personi mund ta vuaj në shtetin kërkuar. Gjithashtu legjislacioni procedural penal italian ka parashikuar gjithashtu mundësinë e arrestimit të personit nga ana e policisë gjyqësore¹⁶², sipas të cilit autoriteti që bën arrestimin në një rast të tillë informon ministrin e Drejtësisë dhe jo më vonë se 48 orë pas arrestimit ky i fundit lajmëron kryetarin e Gjykatës së Apelit, i cili brenda 96 orëve nga arrestimi i jep informacion Ministrisë së Drejtësisë për arsyet e mos lirit.

Gjatë implementimit të kësaj marrëveshje, por dhe nga vëzhgimet në terren rezulton se, nga strukturat e policisë, shpeshherë hasin probleme lidhur me identifikimin e shpejtë të personave të shpallur në kërkim për të cilët është kërkuar arrestimi dhe ekstradimi i tyre drejt Italisë. Problemet në përgjithësi kanë konsistuar në verifikimin e personave bazuar vetëm nga kartela daktiloskopike e ardhur nga shteti italian, pasi disa persona nuk kanë qenë daktiloskopuar më parë në Shqipëri, dhe gjeneralitetet e prezantuara nga pala italiane

¹⁶⁰ Nenet 700-722, Codice Penale e di Procedurale Penale e leggi complementari, Giustino Gatti, Rafaele Marino e Rossana Petrucci, edizioni Simone 1995.

¹⁶¹ Neni 706 ka parashikuar një mundësi të tillë për rekurs në Gjykatën e Kasacionit.

¹⁶² Neni 715 parashikon se në rastet e urgjencës policia gjyqësore autorizohet për arrestimin dhe sekuestrimin e personit dhe sekuestrimin e objekteve që kanë shërbyer për realizimin e veprës penale ose janë produkt i saj.

kanë qenë jo reale. Në përgjithësi, kontingjenti kriminal përdor identitete të ndryshme jashtë vendit, apo përfiton nga procedurat për të ndryshuar gjeneralitetet në zyrat e gjendjes civile në vendin tonë, ndryshime këto që në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile nuk evidentohen në ndonjë rubrikë të veçantë,¹⁶³verifikimi i shpejt i të cilëve kërkon kohë më shumë se një identifikim i zakonshëm.

Si përfundim, mund të themi se kjo marrëveshje ka qenë e nevojshme për faktin se u nënshkrua nga dy vende fqinje ku shtetas të shumtë të tyre rezultojnë të përfshirë në aktivitete kriminale, dhe lufta kundër kriminalitetit e kërkonte një marrëveshje të tillë për ekstradimit e ndërsjellët të shtetasve. Deri para hyrjes në fuqi të marrëveshjes në fjalë, një numër i konsiderueshëm shtetas shqiptarë kanë përfituar nga mungesa e një marrëveshje ekstradimi dy palësh me Italinë, dhe për t'iu shmangur ndjekjes penale janë kthyer në Shqipëri. Aktualisht, nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje disa shtetas shqiptarë të cilët më parë ishin shpallur në kërkim nga autoritetet italiane, janë ekstraduar drejt Italisë, apo janë duke iu nënshtruar procedurave gjyqësore për këtë qëllim. Statistikat tregojnë se, prej hyrjes në fuqi të marrëveshjes bilaterale me Italinë, në Shqipëri janë arrestuar me qëllim ekstradimi drejt Italisë, 152 shtetas shqiptarë, nga të cilët 82 tashmë janë ekstraduar.¹⁶⁴

5.1.4 Marrëveshja e ekstradimit me Egjiptin

Në vitin 2002, autoritetet shqiptare dhe ato egjiptiane pas disa negociatave të bëra lidhur me procedurat e ekstradimit, hartuan një draft marrëveshjeje, e cila konsistonte në faktin që palët të binin dakord të këmbëjnë ekstradim të personave në territorin e tyre të cilët janë akuzuar ose dënuar nga gjyqësori i shtetit tjetër. Marrëveshja u nënshkrua në Kajro më datë 02.04.2002, e cila u kaloi parlamenteve respektive për ratifikim. Shteti shqiptar e ratifikoi atë me Ligjin nr. 9214, datë 01.04.2004¹⁶⁵. Në tërësinë e saj marrëveshja konsiston në

¹⁶³ Elezi M, "Agreement of Extradition" between Albania and Italia", Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol. 2, No. 9, p. 68, October 2013, Romë, Itali. www.mcser.org

¹⁶⁴ Sipas statistikave të Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol-Tirana, raporti i Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar në analizën vjetore të Policisë së Shtetit, Tiranë, Janar 2013.

¹⁶⁵ Ligji nr. 9214, datë 01.04.2004, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit".

identifikimin e veprave të ekstradueshme, shkaqet e detyrueshme dhe ato alternative të mos ekstradimit, autoritetet përkatëse dhe procedurat e ekstradimit, etj.

Neni 2 i marrëveshjes, parashikon rastet kur lejohet ekzekutimi i ekstradimit. Sipas të cilit ekstradimi do të kryhet, për:

“a) Të gjitha veprat që përbëjnë vepra të dënueshme me privim të lirisë për të paktën një vit, ose me një dënim më të rëndë.

b) Në varësi të paragrafit (a) të këtij neni, një vepër do të jetë vepër e ekstradueshme edhe nëse përbën një tentativë ose komplot, duke ndihmuar ose duke bashkëpunuar, ose duke qenë bashkëpunëtor para ose pas faktit, për kryerjen e një veprë të përshkruar në paragrafin (a).

c) Të gjitha dënimet e dhëna nga gjykata e shtetit kërkues, të krimeve të përshkruara në paragrafin (a) të këtij neni, me kusht që periudha e paraburgimit të mos jetë më pak se gjashtë muaj.

d) Për qëllimet e këtij neni, një vepër do të jetë vepër e ekstradueshme në mënyrë të pavarur, në rast se vepra specifikohet brenda së njëjtës kategori shkëlqesh ose përshkruhet me të njëjtën terminologji sipas ligjeve të Palëve Kontraktuese.

e) Në rast se është pranuar ekstradimi për një vepër të ekstradueshme, ai do të pranohet edhe për çdo vepër tjetër të specifikuar në kërkesë, edhe pse vepra e fundit është e dënueshme me më pak se një vit privim lirie, me kusht që të përmbushen të gjitha kërkesat e tjera të ekstradimit”.

Neni 3, parashikon shkaqet e detyrueshme të mospranimit, sipas së cilit:

“a. Ekstradimi nuk do të pranohet nëse rast se personi që kërkohet të ekstradohet është shtetas i shtetit të cilit i bëhet kërkesa; shteti të cilit i bëhet kërkesa, nëse e kërkon shteti tjetër, ua përcjell çështjen autoriteteve kompetente të tij dhe shfrytëzon hetimet e kryera nga shteti kërkues”.

b) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi është krim politik ose e lidhur me një krim politik në shtetin të cilit i bëhet kërkesa.

Megjithatë, sulmi kundër jetës së presidentëve të shtetit ose ndonjëres prej familjeve të tyre, si dhe veprat terroriste, nuk do të konsiderohen krime politike.

c) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi është vepër në bazë të ligjit ushtarak.

d) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi, është kryer tërësisht ose pjesërisht në shtetin të cilit i është bërë kërkesa ose në juridiksionin e tij.

e) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi, jepet nga një gjykim përfundimtar ose një urdhër për vazhdimin e çështjes, ose mund të jetë i anulueshëm.

f) Në rast se për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi çështja penale ka përfunduar ose dënimi është dhënë sipas ligjit të shtetit kërkues në kohën e marrjes së kërkesës.

g) Në rast se vepra për të cilën kërkohet ekstradimi fiton imunitet ndaj procedimit ose dënimit për shkak amnistie sipas secilit shtet.

Ndërsa shkaqet alternative të mos ekstradimit, parashikohen në Nenin 4, sipas të cilit:

“Ekstradimi mund të mos pranohet:

1) Në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa ka motive thelbësore për të besuar se dënimi i mundshëm i veprës në shtetin kërkues është cilësisht i ndryshëm nga dënimi i mundshëm i dhënë për të njëjtën vepër në gjykatat e shtetit të cilit i është bërë kërkesa.

2) Në rast se personi i kërkuar është shpallur fajtor në mungesë, autoritetet kompetente të vendit të cilit i është bërë kërkesa mund të mos e pranojnë ekstradimin, në rast se shteti kërkues nuk i jep shtetit tjetër informacionin që demonstroi që personit i është ofruar mundësi e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

3) Ekstradimi nuk pranohet në rast se shteti të cilit i është bërë kërkesa ka motive materiale për të besuar se kërkesa për ekstradim është bërë me qëllim ndjekjen ose dënimin e një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, të drejtave politike dhe kushtetuese të atij personi, ose që pozita e personit në fjalë mund të paragjykohet për ndonjërin prej këtyre arsyeve”.

Nenet e tjera të marrëveshjes në fjalë lidhen me procedurat e ekstradimit, rastet e konkurrimit të kërkesave për ekstradim, kalimin transit etj, të cilat në thelb janë të ngjashme me nene të veçanta të Konventës Europiane për Ekstradimin. Aktualisht, marrëveshja është në fuqi, por ka gjetur zbatim shumë pak, pasi në përgjithësi shtetasit shqiptar nuk preferojnë të qëndrojnë në Egjipt për shkak të situatës aktuale atje dhe diferencave të kulturave të të dy vendeve. Anasjelltas, edhe shtetasit egjiptianë kanë vijuar të jenë sa më pak frekuentues të vendit tonë, kjo për shkak edhe të rritjes së standardeve të kontrollit kufitar dhe të nivelit të sigurisë, por edhe pasigurisë së tyre për t'iu shmangur evidentimit nga strukturat ligjzbatuese në vend.

5.1.5 Marrëveshja e ekstradimit me Kosovën

Në muajin nëntor 2012, në Tiranë është nënshkruar Marrëveshja¹⁶⁶ ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për ekstradimin e ndërsjellët të shtetasve, e cila u ratifikua nga parlamenti shqiptar

¹⁶⁶ Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi ekstradimin është ratifikuar me Ligjin nr. 2/2013, datë 31.01.2013.

dy muaj më vonë, me Ligjin nr. 2/2013, datë 31.01.2013. Sipas Nenit 1, palët marrin përsipër të dorëzojnë t'i njëra-tjetra, të gjithë personat, kundër të cilëve autoritetet kompetente të palës kërkuese kanë filluar procedurën gjyqësore për vepër penale ose që janë të kërkuar nga autoritetet e saj për ekzekutimin e një dënimi apo urdhër arresti.¹⁶⁷

- *Cilat janë risitë e marrëveshjes?*

Risitë gjenden në nenin 6, paragrafët 2 dhe 3, të cilat i referohen respektivisht shtetësisë së personit subjekt i ekstradimit, dhe kanaleve të komunikimit ndërmjet autoriteteve të palëve nënshkruese. Konkretisht, neni 6, lidhur me ekstradimin e shtetasve, në paragrafin 2 të tij, parashikon se: *“Palët nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit”*, ndërsa në paragrafin 3 parashikon se: *“Kërkesat për ekstradimin bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve të tyre qendrore”*. Marrëveshja në fjalë nuk përjashton mundësinë e komunikimit nëpërmjet kanaleve diplomatike, kjo e parashikuar në Nenin 13 të marrëveshjes në fjalë, i cili në paragrafin 1, në Kapitullin e Dytë *“Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese”*, ku thekson se:

“Palët i paraqesin me shkrim kërkesat për ekstradim dhe dokumentet e tjera shoqëruese në rastin e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe ose serbe dhe në rastin e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës drejtuar Ministrisë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë në gjuhën shqipe.

Megjithatë, komunikimi përmes kanaleve diplomatike mes palëve nuk përjashtohet”.

Pra siç lexohet, nuk është i detyrueshëm përdorimi i kanaleve diplomatike, pasi autoritetet gjyqësore komunikojnë direkt ndërmjet tyre. Gjithashtu praktika gjyqësore me ekstradimin aktualisht kryhet edhe për personat që nuk janë shpallur në kërkim ndërkombëtar, mjafton që për ta të ketë një vendim gjykate dënimi apo një urdhër arresti. Kjo procedurë kryhet vetëm me shtetin e Kosovës. Kjo është e vetme marrëveshje e cila lehtëson në maksimum procedurat për ekstradimin e personave, dhe janë këto nene të cilat përbëjnë suksesin e marrëveshjes në fjalë.

¹⁶⁷ Sipas Nenit 2 të Marrëveshjes, “Urdhër arrest” nënkupton çdo Vendim apo Urdhër për privimin e lirisë të dhënë nga autoriteti gjyqësor kompetent, në kuadër të një procedure penale.

5.2 Përfshirja e Mandat Arrestit European në legjislacionin kombëtar

5.2.1. Ç'është Mandat Arrestit European?

MAE është një vendim gjykatë i dhënë nga autoritet gjyqësor i një shteti anëtar i BE-së në drejtim të ndalimit dhe dorëzimit të një personi nga një Shtet tjetër anëtar, me qëllim që ndaj tij të ekzekutohet vendimi i dënimit ose të ushtrohet ndjekja penale. Ky dokument është i miratuar nga Këshilli i Bashkimit European me Vendimin - Kuadër nr. 2002/584/JHA të datës 13 qershor 2002, dhe ka qëllim zëvendësimin e procedurave klasike të ekstradimit, me procedura me të thjeshta, duke pasur parasysh se faza e tërë politike dhe administrative zëvendësohet nga një mekanizëm gjyqësor, duke eliminuar çdo ndërhyrje të autoriteteve politike. Ky Vendim është bazuar në Traktatin e Amsterdimit, i cili synon të kthejë BE në *një hapësirë të lirisë sigurisë*, dhe drejtësisë ka hyr në fuqi më datë 01 Janar 2004. Sipas Vendimit të sipërcituar, MAE¹⁶⁸ u kërkon autoriteteve gjyqësore kombëtare të shteteve anëtare, të njohin, *ipso facto*, dhe me një minimum prej formaliteteve, kërkesën për dorëzimin e një personi të bërë nga autoriteti gjyqësor i një tjetër Shtet anëtar dhe pas një kontrolli minimal, të dorëzojnë personin e kërkuar. Gjithashtu, Vendimi - Kuadër u njeh të drejtën shteteve anëtare të lidhin marrëveshje bilaterale ndërmjet tyre, për aq kohë sa një marrëveshje e tillë ndikon pozitivisht në lehtësimin e procedurave të dorëzimit të personit.

5.2.2. Procedurat e MAE

Sipas Vendimit Kuadër, MAE është çdo vendim gjyqësor i lëshuar nga një Shtet Anëtar, me qëllim arrestimin ose dorëzimin nga një shtet tjetër anëtar të një personi të kërkuar, për:

- kryerjen e ndjekjes penale;
- ekzekutimin e një dënimi penal;
- ekzekutimin e një urdhër arresti.

¹⁶⁸ Vendim - Kuadër i Këshillit të BE-së nr. 2002/584/JHA, datë 13 qershor 2002. Official Journal OJ L 190, 18.07.2002.

Neni 1, paragrafi 2 i Vendimit Kuadër për MAE parashikon që shtetet anëtare “do të ekzekutojnë çdo urdhër European Arresti”, ndërsa neni 2 parashikohen rastet kur autoriteti gjyqësor kompetent lëshon MAE, të cilat janë:

- Për kryerjen e ndjekjes penale apo gjykimit, nëse vepra penale ndëshkohet nga ligji i shtetit lëshues me heqje lirie së paku 12 muaj;
- Për ekzekutimin e një mase sigurimi me heqje lirie më shumë se 4 muaj;
- Për ekzekutimin e një dënimi, të formës së prere, është më i lartë se 4 muaj;
- Për vepra penale të dënueshme me burgim ose të një urdhër-arrest për një periudhë maksimale prej të paktën një viti.¹⁶⁹

MAE duhet të përmbajë informacion mbi identitetin dhe shtetësinë e personit të kërkuar, autoritetin lëshues gjyqësor, vendimin e gjykimit përfundimtar, karakterin e fakteve të kryera dhe cilësimin juridik të tyre, përshkrimin e rrethanave në të cilën ka ndodhur vepra, natyrën e veprës penale etj, sipas një formulari tip të miratuar të përcaktuar në Vendim,¹⁷⁰ dhe i dërgohet autoritetit gjyqësor në territorin e të cilit ndodhet personi i kërkuar direkt me çdo mjet të sigurt, ose nëpërmjet Sistemit Informativ Schengen (SIS), nëpërmjet Rrjetit Gjyqësor European EUROJUST, apo zyrave të Interpol-it.

Bazuar në fuqinë juridike të kushteve për akordimin e MAE, Vendimi - kuadër në nenet 3 dhe 4 të tij parashikon rastet kur MAE nuk zbatohet, duke sanksionuar kushtet e detyrueshme, dhe kushtet fakultative. Kushtet e detyrueshme të cilat janë:

- Parimi “*ne bis in idem*”¹⁷¹, askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale;
- Vepra penale është amnistuar në vendin e ekzekutimit të MAE -së;
- Personi nuk ka përgjegjësi penale, për shkak të moshës, sipas ligjit të vendit të ekzekutimit.¹⁷²

¹⁶⁹ Council Framework Decision [2002/584/JHA](#) of 13 June 2002 on the European Arrest Warrant, General principles.

¹⁷⁰ Neni 8 i Vendimit Kuadër për MAE.

¹⁷¹ Paolo Tonino, “Manuale di Procedura Penale”, dodicesima edizione, Giuffrè Editore, Milano, 2011.

¹⁷² Holta Kotherja, Rezarta Abdiu, Klodjana Gega, “Manual: Intervistimi i të miturve nga punonjësit e policisë”, shtypshkronja “KLEAN”, Tiranë, 2008.

Ndërsa kushtet fakultative të cilat i referohen bindjes së brendshme të gjyqtarit dhe fakteve ta paraqitura në proces, janë:

- Nuk përmbushet kushti i fajësimit të dyfishtë, më përjashtim të veprave penale në fushën e tatimeve, taksave, doganave e këmbimeve valutore;
- Personi është duke ju nënshtruar një procedure penale në vendin e ekzekutimit të MAE, për të njëjtin fakt objekt i MAE-së;
- Personi është gjykuar me vendim të formës së prerë nga një vend jo anëtar i BE-së;
- MAE përfshin vepra penale, të cilat sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit, janë kryer në territorin e këtij shteti;
- Sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit fakti objekt i MAE -së është parashkruar, etj.

5.2.3. Ku ndryshon UEN nga ekstradimi

Vendimi - kuadër dhe kuadri ligjor i Ekstradimit janë dy mekanizma që thelbin dhe qëllimin e kanë të njëjtë, por ndryshojnë në formë. Formë e thjeshtë ka bërë që MAE të karakterizohet nga sukcesi. Ndryshimet ndërmjet tyre konsistojnë në dy drejtime:

- a. Ndryshimi i parë lidhet me kushtet, ku MAE e ka reduktuar ndjeshëm numrin e kushteve të detyrueshme nga 10 në 3, madje disa kushte si për motive politike, apo veprat penale që kryhen nga ushtarakët nuk i ka përfshirë as në kushtet fakultative;
- b. Ndryshimi i dytë lidhet me procedurat, ku MAE e ka eliminuar fazën administrative, dhe autoriteti qendror tashmë informohet thjesht për kortezi.

Ndryshe nga mekanizmi i ekstradimit, ku procedura administrative zhvillohet nga autoritet qendror që është Ministria e Drejtësisë e cila verifikon nëse dokumentacioni i dërguar plotëson ose jo kushtet e parashikuara në Konventën Europiane për Ekstradimet, në procedurën e ekzekutimit të MAE dhe dorëzimit të personit të kërkuar, vendimi i ekzekutimit është kompetencë e autoriteteve gjyqësore, ku bëhet vlerësimi paraprak i legjitimitetit të MAE, duke eliminuar filtrin e ushtruar nga autoriteti politik.¹⁷³ Pra, në rastin e MAE, Vendimi Kuadër nuk parashikon procedurë me dy etapat si në rastet e ekstradimit,

¹⁷³ Artan Hoxha, “*Ekstradimi dhe Urdhri European i Ndalimit*”, shtëpia botuese Morava, Tiranë 2011, faqe 211.

lëshimin e urdhrit nga gjykata, dhe miratimin nga organi administrativ, por kryerjen e një procedure të vetme, duke e bërë që MAE të ketë sukses në këtë drejtim. Në rastet e ndalimit të një personi të kërkuar, dokumentet për ekstradim i dërgohen autoriteteve gjyqësore të shtetit të ekzekutimit në rrugë diplomatike brenda 40 ditësh, ndërsa në rastet kur aplikohet MAE, ky urdhër dërgohet brenda 48 orësh.

Vendimin për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim e ka çdo gjykatë në territorin e së cilës është arrestuar subjekti, ndërsa lidhur me MAE, si rregull këtë të drejtë e kanë gjykatat e Apelit në juridiksionin e së cilës është gjendur personi i kërkuar, por kjo varet nga përcaktimi i parashikuar në legjislacionin e brendshëm të shteteve anëtare. Vendimi kuadër për MAE parashikon procedurë të përsheptuar në rastet ku personi ndaj të cilin është lëshuar ky urdhër jep pëlqimin e tij për dorëzim, dhe brenda 10 ditësh¹⁷⁴ nga momenti kur vendimi ka marrë formë të prerë, personi duhet t'i dorëzohet autoriteteve të shtetit që e kërkon. Ndërsa në rastet e një procedure normale dorëzimi i personit duhet të bëhet brenda 60 ditëve. Një procedurë e tillë nuk parashikohet në rastet e ekstradimit. Në rastet e ekstradimit kusht i detyrueshëm është fajësimi i dyfishtë, pra vepra penale për të cilin kërkohet ekstradimi të parashikohet si në vendin kërkues edhe në atë ekzekutues, ndërsa në rastet e MAE parashikohet dorëzimi i menjëhershëm për 32 vepra penale të cilat parashikojnë dënim me 3 vjet burgim, pa qenë i nevojshëm verifikimi i fajësimit të dyfishtë në legjislacionin e brendshëm të shteteve anëtare.¹⁷⁵

Sipas Nenit 3, paragrafit të parë të Konventës Europiane “Për ekstradimin”, parashikohet refuzimi i ekstradimit në rastet se vepra penale për të cilin është kërkuar ekstradimi konsiderohet si shkelje politike, ndërsa në Vendimin Kuadër për MAE nuk parashikohet refuzimi i dorëzimit të personit për vepra të karakterit politik dhe ushtarak. MAE parashikon afatin brenda 24 orësh për animimin e vendimit në Gjykatën e Apelit, ndërsa kur bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë afati është brenda 5 ditësh, dhe Gjykata e Lartë duhet të shprehet brenda 3 ditësh nga data që depozitohet kërkesa. Në rastet kur ka konkurrim kërkesash, pra, një MAE dhe një kërkesë për ekstradim, ose më shumë se një MAE, gjykata

¹⁷⁴ Shiko: Neni 13 i Vendimit Kuadër për MAE.

¹⁷⁵ Neni 2, paragrafi i dytë i Vendimit Kuadër.

kompetente ka të drejtën të vendos se cilit shtet do t'i dorëzoj personin e kërkuar, ndërsa në rast se kërkesa për ekstradim vjen nga Gjykata Ndërkombëtare Penale, kjo e fundit ka përparësi¹⁷⁶. Gjithashtu, Vendimi Kuadër parashikon dorëzimin e përkohshëm të personit para se vendimi i ekzekutimit të MAE të ketë marrë formë të prerë, me qëllim për të dhënë deklarime para organeve gjyqësore që kanë lëshuar MAE, dhe rikthimin për t'iu nënshtruar procedurave gjyqësore për ekzekutim. Edhe dorëzimi i përkohshëm nuk parashikohet në procedurat e ekstradimit. Vendimi kuadër për MAE ka shfuqizuar parimin e shtetësisë, në ndryshim nga procedura e ekstradimit, e cila parashikon refuzimin e ekstradimit në rastet kur subjekti i kërkuar është shtetas i palës së kërkuar dhe shtetet nuk kanë marrëveshje dypalëshe ekstradimi ndërmjet tyre. Një kufizim i tillë parashikohet edhe nenin 491¹⁷⁷ të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë.

5.2.4. Implementimi i MAE në sistemin ligjor kombëtar

Me qëllim përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të vendeve të Bashkimit European, vendi ynë ka bërë progres në këtë drejtim, pasi shumë ligje të hartuara nga ana jonë janë të lidhura me detyrimet në kuadër të nënshkrimit të MSA-së, si një vend që aspirojnë për tu anëtarësuar në BE. Lidhur me MAE, strukturat ligjzbatuese në vend duhet të jenë të përgatitur për implementimin e tij, në një të ardhme jo të largët. Përgatitja konsiston në njohjen e MAE, dhe procedurat ligjore për përfshirje në legjislacionin tonë penal, duke analizuar më parë përputhshmërinë me Kushtetutën, dhe me nevojën për ndryshime kushtetuese ose jo, për të parë nëse dhe në çfarë mase MAE do të jetë i pajtueshëm me parimet e rendit juridik shqiptar, si dhe procedurat e ndjekura nga vende të tjera, para përfshirjes së MAE në legjislacionin e tyre të brendshëm.¹⁷⁸

¹⁷⁶ Shiko: Neni 16, paragrafi i katërt i Vendimit Kuadër.

¹⁷⁷ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2009. Neni 491- Mospranimi i kërkesës për ekstradim, pika 1, paragrafi “f”, parashikon se: “Nuk mund të jepet ekstradimi kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikoj ndryshe”.

¹⁷⁸ Marrë nga: Valbona Ndrepepaj, “Urdhri european i ndalimit”, artikull i publikuar në: <http://drejtesiashqiptare.com/?p=1126>, 11.08.2011.

Ndryshe nga marrëveshjet ndërkombëtare, ku përfshihet dhe Konventa Europiane “Për ekstradimin”, të cilat ratifikohen me ligj të posaçëm dhe pastaj gjejnë zbatim në legjislacionin kombëtar, Vendimi Kuadër nuk ratifikohet, por dispozitat e tij për MAE duhet të përfshihen në një akt normativ, i cili kërkon jo vetëm ndryshime të Kodit Penal dhe atij procedural, por dhe të ligjit themeltar të vendit. Ndryshimet duhet të bëjnë të mundur pajtueshmërinë e MAE me Kushtetutën e vendit, apo sipas rastit, të parashikojnë regjimin juridik të MAE, në frymën e parimeve kushtetuese.¹⁷⁹

Tashmë është koha që ekspertët e fushës së drejtësisë, të fillojnë punën përgatitore për modalitetet e përgatitjes së terrenit kushtetues, për përfshirjen e MAE në legjislacionin e brendshëm, në mënyrë që kur të anëtarësohemi në BE të jemi gati për ta zbatuar atë.

5.3 Bashkëpunimi dypalësh për Menaxhimin e Integruar të Kufijve

Republika e Shqipërisë ka patur marrëveshje dhe protokolle me fqinjët edhe me parë para vitit 1990, por duke patur parasysh realitetin e ri në Ballkan, është e angazhuar në bashkëpunim me fqinjët për rishikimin dhe hartimin e marrëveshjeve të reja dy e shumë palësh. Bashkëpunimi me vendet fqinje është i mbështetur në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare; marrëveshjet dy palësh dhe ligjet kombëtare. Kryesisht bashkëpunimi ndërkufitar bazohet në Konventën e bashkëpunimit policor për Evropën Juglindore¹⁸⁰, e cila përcakton fushat e bashkëpunimit, si, patrulla të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror, bashkëpunimin në qendra të përbashkët, ndërtimin e pikave të përbashkëta të kalimit të kufirit, operacione të përbashkëta dhe takime në tre nivelet, atë lokal (ndërmjet PKK-ve), rajonal (në nivel drejtorie rajonale të kufirit), dhe qendror (ndërmjet departamenteve qendrore të vendeve respektive).

¹⁷⁹ Artan Hoxha, “Ekstradimi dhe Urdhri European i Ndalimit”, shtëpia botuese Morava, Tiranë 2011, faqe 318.

¹⁸⁰ “Konventa e Bashkëpunimit Policor për vendeve të Europës Juglindore” është nënshkruar më 05.05.2006 në Vjenë, dhe hyri në fuqi më 10.10. 2007. Shqipëria, si vend depozitues i Konventës është vendi i parë që ka ratifikuar atë, me Ligjin Nr. 9604, datë 11.9.2006, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 107, datë 13.10.2006, fq. 4199.

5.3.1 Legjislacioni shqiptar për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve.

Me qëllim menaxhimin e integruar të kufijve, i cili mbështetet mbi tri shtyllat: bashkëpunimi brenda shërbimit, bashkëpunimi ndërmjet agjencive, dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, të cilat përfshijnë çështjet që lidhen me: kuadrin ligjor rregullator; menaxhimin dhe organizimin; procedurat; trajnimin dhe burimet njerëzore; shkëmbimin e informacionit dhe TI; dhe infrastrukturën dhe pajisjet, shteti shqiptar në përputhje me legjislacionin e BE-së, ka miratuar kuadrin ligjor rregullator, i cili përbëhet nga:

- Ligji Nr. 9749, datë 04.05.2007 “Për Policinë e Shtetit”¹⁸¹ i cili shprehet për përgjegjësitë e Policisë së Shtetit dhe konkretisht “*të mbikëqyr dhe të kontrolloj kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë*”¹⁸², ndërsa në Nenet 46, 47, 48, kreu IV, pjesa e II, sanksionon bashkëpunimin me struktura të tjera dhe organizata jo qeveritare dhe ndërkombëtare në interes të çështjeve të kufirit dhe migracionit.

- Ligji nr. 9861, dt. 24.01.2008 “*Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit*”¹⁸³, i cili është përafruar me legjislacionin e BE-se¹⁸⁴ dhe praktikën e mira të vendeve të BE-se, i cili rregullon:

- Përfshirjen e koncepteve të reja që kanë të bëjnë me kufirin shtetëror; vijën dhe zonën e kufirit; agjentët që veprojnë në kufi; menaxhimin e kufirit; kontrollet kufitare etj.
- Kompetencat, i ndan ato, si dhe detajon detyrat e Policisë Kufitare dhe Migracionit për realizimin e efektshëm të menaxhimit të kufirit shtetëror dhe migracionit si në kufi dhe në territor.

¹⁸¹ Ligji për Policinë e Shtetit ka hyrë në fuqi më datë 04.07.2007. Fletore Zyrtare nr 73, datë 19.06.2007, faqe 2171

¹⁸² Germa d, pika 1, e nenit 4, pjesa I, e Ligjit.

¹⁸³ Fletorja Zyrtare nr 10, datë 13.02.2008, faqe 319.

¹⁸⁴ Për hartimin e ligjit është marrë si referim Rregullorja (EC) nr. 562/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 15 mars 2006 “Për krijimin e kodit të komunitetit rreth rregullave mbi lëvizjen e personave në kufij”.

- Kompetencat e Policisë Kufitare dhe Migracionit në të gjithë territorin e shtetit, me qëllim zbulimin dhe parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e kalimit të paligjshëm të kufirit duke bashkëpunuar dhe me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.
- Bashkëpunim policor ndërkufitar, i cili konsiston në krijimin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, shkëmbim informacioni (në nivel lokal, rajonal dhe qendror), shkëmbimin e oficerëve të kontaktit, kryerjen e patrullimeve dhe të operacioneve të përbashkëta;
- Kompetencat e Policisë Kufitare dhe Migracionit për të grumbulluar, ruajtur dhe përpunuar të dhënat personale si dhe mbajtjen e evidencës për kërkesa të kryerjes së efektshme të kontrollit kufitar.

- Ligji Nr. 9959, dt. 17.07.2008 “*Për të Huajt*”¹⁸⁵, me anë të së cilit janë përcaktuar konceptet dhe përkufizimet mbi çështjet e migracionit, si dhe:

- Të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Republikën e Shqipërisë, kushtet për hyrje, qëndrim tranzitim dhe daljen nga territori shqiptar;
- Lëshimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit dhe lejeve të punës për të huajt,
- Kushtet e përgjithshme për refuzimin, largimin dhe dëbimin e të huajve, mbikëqyrjen dhe trajtimin e të huajve;
- Mbledhjen dhe administrimin e të dhënave personale për të huajt në territorin shqiptar, integrimin e të huajve në jetën ekonomike, kulturore, dhe shoqërore;
- Sanksionet ndaj të huajve apo subjekteve të tjera që merren me pritjen, punësimin, transportin, akomodimin e të huajve në territorin shqiptar.

Ligji ka patur parasysh instrumentet specifike të së drejtës ndërkombëtare në fushën e migracionit si:

- Konventën e OKB-se “*Mbi statusin e refugjatit*” dhe Protokolli i saj zbatues e 22 Prillit 1954¹⁸⁶;

¹⁸⁵ Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 124, datë 01.08.2008, faqe 5479, dhe hyrë në fuqi më datë 01.12.2008.

- Konventa e OKB-se “*Mbi statusin e personave pa shtetësi*” e vitit 1954¹⁸⁷ e cila ka hyrë në fuqi më 6 Qershor 1960;
- Konventa Ndërkombëtare “*Për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punëtoreve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre*”¹⁸⁸, të vitit 1998 e cila ka hyrë në fuqi më 01 Korrik 2003.

- Ndryshime në Ligjin “*Për Rojën Bregdetare*”¹⁸⁹.

- Ndryshime në Ligjin “*Për Azilin*”¹⁹⁰, i cili në kreu IV, germën “a”, neni 21, rregullon procedurat e azilit në kufi dhe në territor, kur shtetasi i huaj i drejtohet organeve të Policisë Kufitare dhe Migracionit për kërkesën për azil.

Gjithashtu në funksion të MIK, qeveria shqiptare ka miratuar strategjinë¹⁹¹ përkatëse, dhe planin e veprimit¹⁹² prej të cilës rrjedhin detyrime për agjencisë ligj zbatuese, lidhur me këtë qëllim. Strategjia ndjek udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve të KE-së dhe përqendrohet tek katër agjencitë kryesore që kanë përgjegjësi në kufi: Policia Kufitare dhe Migracionit, Shërbimi Doganor, Shërbimi Veterinar dhe ai Fitosanitar¹⁹³, si dhe i

¹⁸⁶ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Dekretin nr. 200 të datës 3.6.1992 dhe hyrë në fuqi më datë 18 Gusht 1992, “Për ratifikimin e Konventës së OKB-se “Mbi statusin e refugjatit” dhe Protokolli i saj zbatues e 22 Prillit 1954”.

¹⁸⁷ Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventën e OKB-së “Mbi statusin e personave pa shtetësi” të vitit 1954, më datë 23 Qershor 2003.

¹⁸⁸ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Dekretin Nr. 200 të datës 3.6.1992, “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punëtoreve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre” të vitit 1998.

¹⁸⁹ Ligji Nr. 9788, datë 19.07.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8875, datë 04.04.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”. Fletorja Zyrtare: Viti 2007, Nr 103, Faqe 2982; Data e botimit: 06-08-2007.

¹⁹⁰ Ligji nr. 10060, datë 26.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, faqe 209, datë 09-02-2009, dhe hyrë në fuqi më 24.02.2009.


¹⁹¹ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plan Veprimit, e miratuar me VKM Nr. 668, datë 29.07.2007, Fletorja Zyrtare Nr. 147, datë 05.11.2007.

¹⁹² Plan i Veprimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1021, date 14.10.2009, “Për miratimin e Planit të Veprimit të Përditësuar të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit”. Fletore Zyrtare: nr 157, Faqe 7015; Data e botimit: 22-11-2009.

¹⁹³ Ky bashkëpunim është rregulluar me zbatimin e kërkesave të Rregullores për bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit, Shërbimit Doganor, Shërbimit Veterinar dhe Shërbimit Fitosanitar të miratuar nga Ministri i Brendshëm nr. 8575, datë 04.11.2009, Ministri i Financave nr. 10952/6, datë 10.11.2009 dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 6581, datë 10.11.2009.

referohet disa agjencive dhe operatorëve të tjerë që janë aktivë në fushën e menaxhimit të kufirit. Gjithashtu janë firmosur, ratifikuar dhe zbatohen marrëveshje për mirëmbajtjen e shenjave kufitare me Maqedoninë, Malin e Zi dhe protokolle për mirëmbajtjen e shenjave kufitare me Greqinë.

Skema 1: Shërbimi kufitar në vendet fqinje



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë

5.3.2. Bashkëpunimi ndërkufitar me Republikën e Kosovës

Me Republikën e Kosovës, që prej pavarësisë së saj, po bashkëpunohet në drejtim të rritjes së sistemit të sigurisë kufitare dhe lehtësimin e lëvizjes së shtetasve, mjeteve dhe mallrave. Në këtë kuadër janë nënshkruar një sërë marrëveshjes dhe protokollesh si;

- Memorandum i Mirëkuptimit “Mbi bashkëpunimin policor ndërkufitar” midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), datë 09.09.2002.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, “Për bashkëpunimin policor ndërkufitar”, nënshkruar në Prishtinë më 06.10.2009.
- Marrëveshje dhe protokoll ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, “Për ripranimin e personave në kufi”, nënshkruar në Prishtinë më 06.10.2009.
- Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Shqipërisë edhe Republikës së Kosovës, datë 10 mars 2012.


Gjithashtu, ndërmjet dy shteteve respektive janë miratuar marrëveshje lidhur me PKK-të, si:

- Memorandum i Mirëkuptimit midis Policisë Shqiptare dhe Policisë Kufitare të UNMIK-ut “Për hapjen e dy Pikave të kalimit Kufitar/Vendkalime Kufitare në jug të Dragashit” (Shishtavec, Orgjost).¹⁹⁴
- Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës “Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në Pikat e Kalimit Kufitar Morinë (Kukës) - Vermicë (Prizren)”, datë 30.04.2011
- Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës “Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në Pikat e Kalimit Kufitar Qafë Morinë (Tropojë) - Qafë Morinë (Gjakovë)”, datë 30.04.2011
- Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës “Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në Pikat e Kalimit Kufitar Qafë Prush (Has) – Qafë Prush (Gjakovë)”, datë 30.04.2011.

¹⁹⁴ Miratuar me VKM nr. 423, datë 12.09.2002.

Në fushën e Kufirit dhe Migracionit, me Republikën e Kosovës, janë vendosur dhe funksionojnë normalisht pikat e kontaktit në të tre nivelet për shkëmbimin e informacioneve në fushën e Kufirit e Migracionit. Si rezultat i masave të marra, në kufirin me Kosovën janë arritur rezultate në parandalimin dhe luftën ndaj krimit të organizuar, trafikimit të lëndëve narkotike, të qenieve njerëzore, kontrabandës së mallrave të ndryshme, parandalimit të kalimeve ilegale të kufirit, menaxhimit të fluksit të hyrje daljeve të shtetasve dhe mjeteve gjatë festave dhe periudhës së verës etj.

Skema 2: Bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracioni, Tiranë

5.3.3. Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet dy vendeve bazohet në marrëveshje të nënshkruara midis tyre, të renditura më poshtë:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë “Për masat për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve në kufirin shqiptaro-maqedon”, nënshkruar më datë 04.12.1997, në Tiranë.

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë “*Për riparimin dhe mirëmbajtjen e vijës së kufirit dhe shenjave kufitare*”, nënshkruar më 04.12.1997, në Tiranë.
- Marrëveshja “*Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimin të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme*”, nënshkruar më datë 14.03.2007¹⁹⁵
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “*Për riparimin e personave*”, nënshkruar në Shkup, më datë 17.06.2004¹⁹⁶.
- Protokoli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “*Për zbatimin e Marrëveshjes së riparimit të personave*”, nënshkruar në Shkup, më datë 17.06.2004.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “*Për patrullimin e përbashkët midis Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Maqedonisë për patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror*”, nënshkruar në Budva, më datë 22.02.2008.
- Protokoll ndërmjet Ministrive të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Maqedonisë “*Për organizimin e zhvillimin e takimeve ndërmjet drejtuesve të Policisë Kufitare në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal*”, nënshkruar në Budva, më datë 22.02.2008.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “*Për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve dhe të protokollit të saj për qarkullimin në zonat kufitare*”.¹⁹⁷

¹⁹⁵ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 19.12.2004.

¹⁹⁶ Ratifikuar me Ligjin nr. 9306, datë 04.11.2004, botuar në Fletore Zyrtare nr. 90, datë 09.12.2004, faqe 6414.

¹⁹⁷ Ratifikuar me Ligjin nr. 9894, datë 27.03.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 46, datë 09.04.2008, faqe 2077.

Të gjitha marrëveshjet e sipërcituara aktualisht janë në zbatim nga policitë kufitare të vendeve respektive. Por ka edhe marrëveshje të cilat janë nënshkruar, ratifikuar nga parlamenti, por nuk kanë gjetur zbatim, si:

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë *“Për hapjen e Pikës së Re të kalimit kufitar rrugor ndërkombëtar midis dy vendeve, Xhepisht - Trebisht”*, nënshkruar në Tiranë, më datë 16.11.2005¹⁹⁸.

Bashkëpunimi operacional me Maqedoninë ka sjellë disa zhvillime, si:

- Pika Kombëtare e Kontaktit ndërmjet drejtorive të Policisë Kufitare është operacionale që prej 22 Shkurtit 2008;
- Mbledhje të rregullta midis drejtuesve të Policive Kufitare në tri nivele: lokal, rajonal dhe qendror;
- Kryerje të patrullime të përbashkëta në kufiri prej vitit 2008;
- Shkëmbim të dhënash statistikore për migracionin e paligjshëm prej 2009;
- Trajnime të përbashkëta të efektivave të policive kufitare respektive.

5.3.4. Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Malin e Zi

Në fushën e kontrollit kufitar bashkëpunimi me Malin e Zi synon, lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve dhe mallrave, krijimin e kufijve të hapur por të sigurt, dhe kryesisht parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale që zhvillohen në të dy anët e kufirit. Bashkëpunimi mbështetet në një sërë marrëveshjesh që rregullojnë përcaktimin dhe mirëmbajtjen, patrullimin e përbashkët, masa për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare, regjimin e vizave, pikat e kalimit kufitar, përfshirë pikën e përbashkët Muriqan/Sukobinë me financimin e Bashkimit European e cila funksionon normalisht, ndihmë ligjore në çështje civile dhe penale, të ripranimit etj. Bashkëpunimi ndërkufitar realizohet edhe nëpërmjet programit “Instrument për Ndihmë para-anëtarësimit (IPA) 2007-2013”. Në kuadrin e këtij programi të dy vendet synojnë nxitjen e iniciativave

¹⁹⁸ VKM nr. 385, dt 14.06.2006, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 01.07.2006, faqe1854.

ndërkufitare në fusha të zhvillimit social dhe ekonomik, mbrojtjen e ambientit, shëndetit publik, nxitjen e veprimtarive ndërkufitare dhe kontaktet mes banorëve të të dy anëve të kufirit, bashkëpunimi juridik dhe administrativ mes strukturave të pushtetit lokal, dhe elementë të tjerë.

Bashkëpunimi policor kufitar bazohet në marrëveshjet dhe protokollet dypalëshe të mëposhtme, të cilat ndër të tjera përbëjnë kuadrin ligjor:

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, *“Për bashkëpunimin policor ndërkufitar”*, nënshkruar në Podgoricë, më datë 01.02.2008;¹⁹⁹
- Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi, *“Mbi vendosjen e qarkullimit të përhershëm ndërkombëtar ndërmjet PKK Hani i Hotit – Bozhaj, Bashkim-Grancar dhe Sukobinë - VKK Muriqan”*, nënshkruar në Shkodër, më datë 24.01.2000;
- Protokoll ndërmjet Ministrive të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi *“Për organizimin e zhvillimit të takimeve ndërmjet drejtuesve të Policisë Kufitare të Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal”*. nënshkruar në Budva, më datë 22.02.2008;
- Protokoll ndërmjet Ministrive të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme dhe Administratës Publike të Malit të Zi *“Për patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi”*, nënshkruar në Budva më 22.02.2008;²⁰⁰
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi *“Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera ilegale”* nënshkruar në Podgoricë, Mal i Zi, më 31 tetor 2003;²⁰¹

¹⁹⁹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 46, datë 09.04.2008, faqe 2069.

²⁰⁰ Fletoren Zyrtare nr. 46, datë 09.04.2008, faqe 2069.

²⁰¹ Ratifikuar me Ligjin nr. 483 datë 16.07.2004, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 52, datë 30.07.2004.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi “*Për Hapjen e Pikës së Përbashkët Kufitare Muriqan-Sukobinë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi*”, nënshkruar më datë 17.01.2007;²⁰²
- Protokoll ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “*Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në PKK e përbashkët Muriqan/Sukobinë*”, nënshkruar në Shkodër më 18.06.2009;²⁰³
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “*Për ripranimit të personave që kanë hyrë dhe qëndrojnë ilegalisht*”, nënshkruar në Podgoricë më 05.11.2009;
- Protokoll ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “*Për zbatimin e Marrëveshjes së ripranimit të personave*”, nënshkruar në Podgoricë më 05.11.2009;²⁰⁴
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “*Për rindërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e shenjave treguese në kufirin shtetëror*”, nënshkruar në Podgoricë më 05.11.2009;
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “*Për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve*”, nënshkruar në Podgoricë më 05.11.2009.

Marrëveshjet e mësipërme zbatohen nga strukturat policore kufitare të vendeve respektive. Por ka dhe një marrëveshje ndërqeveritare e cila është nënshkruar, dhe ratifikuar, por ende nuk ka gjetur zbatim. Kjo marrëveshje i përket hapjes së një pike të re kufitare:

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “*Për hapjen e Pikës së Kalimit Kufitar Ura e Bunës në Liqenin e Shkodrës*”.²⁰⁵

²⁰² Ratifikuar me Ligjin nr. 9702, datë 02.04.2007; botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 25.04.2007.

²⁰³ Ratifikuar me Ligjin nr. 10195, datë 10.12.2009.

²⁰⁴ Ratifikuar me Ligjin nr. 10205, datë 23.12.2009, Fletore Zyrtare nr. 194, datë 20.01.2009, faqe 8563.

Skema 3: Bashkëpunimit kufitar me Malin e Zi



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë

5.3.5. Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Greqinë

Niveli i bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, në fushën e kufirit tokësor dhe detar, por dhe lidhur me çështjet e migracionit, është institucionalizuar mbi bazën e Traktatit të Fqinjësisë së Mirë e Bashkëpunimit, që ka hyrë në fuqi më dt 04.02.1998, si dhe në disa marrëveshje e protokolle bashkëpunimi. Në mënyrë periodike zhvillohen takimet e Komisionit të Përbashkët shqiptaro - grek²⁰⁵, për çështjet kufitare, i cili mbledhet rregullisht në zbatim të Protokollit të përbashkët²⁰⁷ për çështjet e kufirit me vullnetin e përbashkët për të biseduar e sqaruar gjithë problematikën që lidhet me këto çështje; si mirëmbajtja e piramidave,

²⁰⁵ Ratifikuar me Ligjin nr. 9319, datë 25.11.2004, Fletore Zyrtare nr 98, datë 20.12.2004, fq. 6680.

²⁰⁶ Protokollit i Komisionit Kryesor i Përbashkët Shqiptaro - Grek "Për çështje kufitare", nënshkruar në Janinë, më datë 03.11.2005.

²⁰⁷ Protokollit ndërmjet Ministrive të Rendit Publik të Republikës së Greqisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë "Për bashkëpunimit për çështjet e kufirit", nënshkruar në Tiranë në 14 shkurt 1991.

përshtatja e teknologjive të reja moderne në procesin e rritjes së sigurisë kufitare, bashkëpunimi i strukturave të Policisë Kufitare, shkëmbimi i ndërsjelle i informacionit dhe trajnimet e përbashkëta. Menaxhimi i integruar tokësor ndërmjet dy vendeve, bazohet në marrëveshjet e mëposhtme:

- Protokolli ndërmjet Ministrive të Rendit Publik të Republikës së Greqisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë *“Për bashkëpunimit për çështjet e kufirit”*, nënshkruar në Tiranë në 14 shkurt 1991;
- Marrëveshje *“Për bashkëpunimin midis Ministrive të Rendit Publik të Republikës së Greqisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë në fushën e kriminalitetit të organizuar”*, nënshkruar në vitin 1992;
- Protokoll bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Marinës Tregtare të Republikës së Greqisë, *“Për patrullimin e përbashkët nga policia kufitare dhe trupat greke të mbrojtjes së limaneve për një mbrojtje efikase të kufirit bregdetar midis dy vendeve”*. Nënshkruar me dt. 09.03.1998.

Me këto marrëveshje rregullohet mënyrat e bashkëpunimit dhe rrugët që duhen ndjekur për të qenë efikase për të gjitha drejtimet që mbulojnë ministritë respektive në kuadër të bashkëpunimit dypalësh. Ndërsa lidhur me kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit dhe hapësirës detare, bashkëpunimi bazohet në protokollet e mëposhtme:

- Protokoll ndërmjet Ministrisë së Marinës Tregtare të Republikës së Greqisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë *“Për bashkëpunimin ndërmjet Policisë Kufitare Shqiptare dhe Rojës Bregdetare Greke për kontrollin e hapësirës detare ndërmjet të dy vendeve”*, nënshkruar në Tiranë 19.12.2005. Ky protokoll ka hyrë në fuqi më datë 05.03.2007.

Bashkëpunimi operacional ndërkufitar me Greqinë konsiston, në:

- Patrullime të përbashkëta në det së bashku me Marinën Greke;
- Operacione të përbashkëta në kufi (bashkëpunim me FRONTEX);
- Koordinimi i patrullimit në kufi;
- Bashkëpunimi përmes oficerëve të kontaktit;

- Mbledhje dhe analiza të përbashkëta në tri nivelet: lokal, rajonal dhe qendror.

Skema 4: Pamje e kufirit tokësor Shqipëri – Greqi sipas seksioneve dhe piramidave



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë

5.3.6 Bashkëpunimi policor ndërkufitar me Italinë

Aktualisht bashkëpunimi kufitar me Italinë është në një nivel të mirë. Në këtë kuadër, një rëndësi tepër të veçantë zë fushën e bashkëpunimit policor, e cila mund të konsiderohet si tepër e rëndësishme për bashkëpunim efikas dhe institucional në luftën kundër krimit ndërkufitar. Ky bashkëpunim mbështetet në kuadrin ligjor të mëposhtëm të renditura sipas viteve:

- “Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrit të Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit të Brendshëm të Republikës Italiane në luftën kundër

trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope dhe kundër kriminalitetit të organizuar”, nënshkruar më 24 gusht 1991²⁰⁸.

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Italiane *“Mbi përcaktimin e Shelfit Kontinental”*, nënshkruar më 18.12.1992²⁰⁹.
- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Italiane, *“Për ripranimin e personave në kufi”*, nënshkruar në Tiranë më datë 18.11.1997.
- Protokolli i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Italiane, *“Për ripranimin e personave në kufi”*, nënshkruar në Tiranë më datë 18.11.1997.
- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për asistencën administrative *“Për parandalimin, zbulimin ndëshkimin e shkeljeve doganore”*, nënshkruar më 12.03.1998, hyrë në fuqi më 01.03.2005;
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane *“Për krijimin e një sistemi të detyrueshëm të raportimit në detin Adriatik”*, nënshkruar më 19.05.2000;
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane *“Për krijimin e një sistemi të përbashkët kursesh të një skeme të ndarjes së trafikut në pjesën jugore të detit Adriatik”*. 19.05.2000;
- Protokolli i Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane *“Për zhvillimin e programeve të mbështetjes së Forcave të Policisë shqiptare dhe bashkëpunimit midis dy vendeve në luftë kundër kriminalitetit nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit (oficerëve) shqiptarë i kontaktit në Itali”*, nënshkruar në Leçe, më datë 13.11.2002;

²⁰⁸ Kjo Marrëveshje është rinovuar me nënshkrimin në qershor 2007 të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane në Luftën kundër Kriminalitetit”, nënshkruar në Tiranë më 19.05.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 124, datë 27.09.2007.

²⁰⁹ Hyrë në fuqi më 26.02.1999.

- Protokoll i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë “*Për ripranimin e personave në kufi*”, nënshkruar në Tiranë me dt 31.10.2008, etj.

- *Bashkëpunimi me Guardia di Finanza-n italiane*

Bashkëpunimi policor kufitar shqiptaro-italian ndër të tjera i kushton rendësi të veçantë kontrollit të hapësirës detare. Në kuadrin operacional, prej muajit nëntor 1997, ky bashkëpunim për ruajtjen dhe sigurinë kufitare, realizohet me forcat policore italiane të Nuklit të Kufirit Detar të Guardia di Finanza, rregulluar me Protokoll Mirëkuptimi ndërmjet qeverive të shteteve respektive, qëllimi i të cilit është parandalimin e trafikeve të pa ligjshme nëpërmjet hapësirës detare. Bashkëpunim konsiston në organizimin e masave të përbashkëta për rritjen e sigurisë në porte, zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, regjimin e lundrimit të mjeteve në ujërat e brendshme dhe territoriale, si dhe shkëmbimin e informacionit, në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe marrjen e masave efektive dhe konkrete në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së paligjshme që zhvillohet nëpërmjet detit.

“Rëndësi e veçantë gjatë këtij bashkëpunimi i është kushtuar koordinimit të forcave dhe mjeteve dhe shkëmbimit të informacionit të ndërsjellë gjatë veprimeve operacionale në hapësirën detare. Edhe kur nuk ka qenë i mundur bllokimi i aktiviteteve kriminale në ujërat tona territoriale, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në kohë reale me palën italiane (Salla Operative në Bari), ato janë bllokuar në bregdetin italian. Ndërsa me vënien në funksionim të QNOD-së,²¹⁰ ky bashkëpunim është rritur ndjeshëm. Statistikat tregojnë se, vetëm gjatë vitit 2012 janë kryer dhjetëra operacione në ndjekje të situatave të krijuara në hapësirën detare dhe në 6 raste është bërë e mundur kapja dhe sekuestrimi në të dy brigjet i 6 mjeteve lundruese, një sasi e konsiderueshme lënde narkotike (rreth 13 ton) dhe 24 klandestinë shtetas irakianë që lundronin me gomone nga ishulli i Korfuzit në Greqi për në Itali”²¹¹

Bashkëpunimi operacional ndërkufitar me Italinë konsiston, në:

²¹⁰ QNOD - Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, vënë në funksionim në Janar 2010, me godinë në Durrës, ngritur me VKM Nr. 954, datë 30.09.2009 “Për organizimin, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore që kane interesa në det”. Fletore Zyrtare nr 155, datë 20.11.2009, faqe 6951.

²¹¹ Raporti vjetor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në Policinë e Shtetit, Tiranë, 2012.

- Patrullime të përbashkëta në det me Guardia di Financën;
- Operacione të përbashkëta detare, qysh nga viti 2010;
- Shkëmbim informacioni përmes rrjetit të oficerëve ndërlidhës të porteve dhe aeroporteve;
- Bashkëpunimi mes oficerëve të kontaktit të atashuar në Bari, Romë dhe Tiranë.

5.3.7. Risitë e bashkëpunimit dypalësh për kontrollin e kufijve

Në kuadër të aspiratave për tu anëtarësuar në BE, sistemi i kontrollit kufitar shqiptar ka pësuar evoluime nga viti në vit, me prirje për t'iu përshtatur standardeve të vendeve anëtare të BE-së. Disa nga risitë e bashkëpunimit ndërkufitar, janë:

- Shkëmbimi i informacionit, lidhur me imigracionin ilegal në rajon, ndërmjet autoriteteve kufitare të vendeve të rajonit; Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Bosnje-Hercegovine dhe Kroaci, nën kujdesin e FRONTEX, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit.²¹²
- Kryerja e operacioneve kufitare të përbashkëta për goditjen e krimeve ndërkufitare.
- Rritja e cilësisë së kontrollit të dokumenteve të udhëtimit të shtetasve që kalojnë nëpërmjet PKK-ve, shkëmbimin permanent të informacionit për specimentet e vëna në qarkullim si dhe rastet e konstatuara false.
- Kryerja e përbashkët e analizës së riskut, për marrjen e masave për të parandaluar krimet ndërkufitare, etj²¹³.

Aktualisht, të gjitha PKK-të janë të lidhura online me sistemin TIMS dhe sistemin ASF2 të Interpolit, ku evidentohen hyrje/daljet në kufirin shtetëror për shtetasit dhe mjetet dhe njoftimet e ndryshme në kufi, etj. Nga informacioni i mësipërm, konstatohet se ka rritje të ndjeshme edhe në fushën operacionale, kryesisht atë që lidhet me konceptin e Menaxhimit

²¹² Memorandumin e Mirëkuptimit “Për shkëmbimin e informacionit dhe paralajmërimin e hershëm me vendet e Ballkanit Perëndimor”, 20.11.2008 në Shkup, nën kujdesin e FRONTEX.

²¹³ Analiza e Riskut në Policinë Kufitare dhe Migracionit, rregullohet me Urdhrin nr. 1016, datë 08.09.2009, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Mbi rregullimin e veprimtarisë dhe funksionimin e Analizës së Riskut dhe Krimit Ndërkufitar në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe rregullimin e bashkëpunimit për këtë qëllim me strukturat e tjera”.

të Integruar të Kufijve, si p.sh: kontrollin e lëvizjes së njerëzve dhe automjeteve në PKK, gjë e cila tregohet nëpërmjet statistikave të mëposhtme për periudhën kohore 2005 -2013:

Tabela 1: Tregues të veprave penale ndërkufitare, 2005 - 2013

Nr.	VEPRA PENALE	V I T I								
		2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
1	Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit	-	-	-	97	49	96	14	11	17
2	Raste droge të kapur në kufi	7	17	7	15	20	16	42	84	118
3	Dokumente udhëtimi të falsifikuara	829	1310	1287	1602	273	311	186	298	190
4	Shtetas shqiptarë të kapur për kalim të paligjshëm të kufirit	6270	8893	12704	16464	17663	19094	1275	658	41
5	Të huaj të kapur në tentativa për kalim të paligjshëm të kufirit	152	93	106	16	29	54	421	1126	-
6	Automjete të trafikuar të kapura nga përdorimi i Interpol-it	-	-	-	15	16	85	154	80	54
7	Viktima trafiku të evidentuara	72	15	118	29	8	23	5	5	3
8	Trafikim i armëve	-	-	-	-	2	10	12	30	6

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, në Policinë e Shtetit

Si përfundim, mund të themi se, miratimi dhe implementimi i ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve në përshtatje me legjislacionin e Bashkimit Europian, zbatimi i detyrimeve të BE-së në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave, pajisja e PKK-vë me sisteme dhe pajisje moderne, bashkëpunimi në nivel lokal, rajonal dhe qendror ndërmjet strukturave kufitare me ata të vendeve fqinjë, jo vetëm për shkëmbim informacioni por dhe operacione të përbashkëta, kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e kontrollit dhe sigurisë së kufijve në vendin tonë, sipas konceptit europian të MIK.

Kapitulli VI: BASHKËPUNIMI PËRMES KËRKESAVE DHE LETËR-POROSIVE

6.1 Njoftimet e akteve të procedimit penal

Njoftimet e akteve janë një procedurë ligjore, e cila ka lidhje me marrjen dijeni të një personi të proceduar penalisht, lidhur me aktet e procedimit penal ndaj tij. Konteksti i punimit tonë ka lidhje me rastet kur për kryerjen e njoftimit të akteve, angazhohen strukturat e policisë vendase dhe të vendeve të tjera. Kjo ndodh në rastet kur personi të cilit do ti njoftohen aktet ndodhet jashtë territorit të vendit i cili e ka proceduar atë. P.sh: kur personi ndodhet në burg jashtë shtetit për një vepër penale të kryer jashtë territorit shqiptar, ndërkohë që ndaj tij ka filluar një procedim penal në Shqipëri. Në këtë rast njoftimi i akteve realizohet nëpërmjet përfaqësuesit të policisë shqiptare i atashuar jashtë shtetit, i cili me atributet e oficerit të policisë gjyqësore gëzon të drejtën të kryej veprime procedurale në zbatim të një urdhri të prokurorit apo vendimit të gjykatës e njëjta gjë bëhet edhe për oficerët e policive të vendeve partnere të atashuar në vendin tonë, pranë përfaqësive të tyre diplomatike, për çështjet që i përkasin vendit të tyre.

Por mund të ndodh që i pandehuri të cilit i duhet bërë njoftimi i akteve ndodhet jashtë shtetit, jo në izolim, në punë, në spital, në një adresë të caktuar, ose pa adresë. Sigurisht, edhe në të tilla raste nevojitet bashkëpunimi policor ndërkombëtar për identifikimin e personit, gjetjen e tij dhe njoftimin e akteve. Ky veprim evidentohet në proces verbal i cili nënshkruhet nga i njoftuari. Kodi ynë procedural, lidhur me njoftimin e të pandehurit i cili ndodhet jashtë shtetit, parashikon, se:

“Kur vendbanimi ose qëndrimi i të pandehurit jashtë shtetit është i njohur, autoriteti procedues i dërgon atij letër rekomande me lajmërim marrje, me të cilën e njofton për veprën penale që akuzohet dhe i kërkon të deklarojë ose të zgjedhë banesën në territorin shqiptar. Në qoftë se pas tri ditëve nga marrja e letrës rekomande nuk bëhet deklarimi ose zgjedhja e banesës ose kur kjo nuk lajmërohet, njoftimi bëhet nëpërmjet dorëzimit të mbrojtësi.

Kur del se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vepruar sipas paragrafit 1, autoriteti procedues, para se të nxjerrë vendimin e mos gjetjes, urdhëron të bëhen kërkime edhe jashtë territorit të shtetit sipas rregullave të caktuara në marrëveshjet ndërkombëtare”.²¹⁴

Duhet theksuar, se, njoftimi i akteve si procedurë, rrjedh nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe është i parashikuar si i tillë edhe në legjislacionin e brendshëm të vendeve. P.sh: Konventa për dhënien e ndihmës juridike për çështje civile, familjare dhe penale, midis Republikës dhe Gjermanisë, lidhur me njoftimet mbi vendimet penale, ndër të tjera thekson:

“1. Palët Kontraktonjëse do ti dërgojnë çdo vit njëra tjetrës njoftime mbi vendimet që kanë marrë formë të prerë, të dhëna nga gjykatat e njërës nga Palët Kontraktonjëse kundrejt shtetasve të Palës tjetër Kontraktonjëse, duke mare njëkohësisht masat për të dërguar shenjat e gishtave të të dënuarve që disponohen.

2. Palët Kontraktonjëse do ti dërgojnë me kërkesë njëra tjetrës njoftime mbi dënimet e personave që më parë banonin në territorin e Palës Kontraktonjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, në qoftë se këta persona do të merren në përgjegjësi penale në territorin e Palës Kontraktonjëse, që ka paraqitur kërkesën”²¹⁵.

Ndërsa një tjetër marrëveshje bilaterale e hershme, e cila përfshin njoftimet, lidhur me çështjet e legjislacionit, është marrëveshja midis Shqipërisë dhe Çekosllovakisë e vitit 1959, e cila parashikon, se: *“Ministritë e drejtësisë të të dy Palëve Kontraktonjëse me kërkesë i japin njëra tjetrës njoftime për çështje juridike”*.²¹⁶ Ndërsa, legjislacioni ynë aktual sqaron qartë se, cilat janë organet dhe format e njoftimeve. Sipas ligjit, gjyqtari, kur e çmon të nevojshme, mund të urdhërojë që njoftimet të bëhen nga policia gjyqësore, apo nga ftuesi gjyqësor ose nëpërmjet shërbimit postar.²¹⁷ Ndërsa lidhur me format e njoftimit, Kodi parashikon se ato mund të bëhen me shkresë zyrtare, ose edhe me telefon, me fakt apo me telegraf, nëse situata është urgjente. Referuar Kodit, konstatohet, se:

²¹⁴ Shih: Neni 142 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë .

²¹⁵ Neni 76, paragrafi 1 dhe 2 i “Konventës midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Demokratike Gjermane mbi dhënien e ndihmës juridike për çështje civile, familjare dhe penale”, e vitit 1959.

²¹⁶ “Konventa midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Çekosllovake mbi dhënien e ndihmës juridike për çështje civile, familjare dhe penale”, bërë në Pragë më, 16 janar 1959, Neni 14 - Njoftime për çështje të legjislacionit.

²¹⁷ Shih: Neni 132 i Kodit të Procedurës Penale. (Kreu II- Njoftimet).

“Gjykata në raste të ngutshme mund të urdhërojë që personat e kërkuar nga palët, përveç të pandehurit, të lajmërohen me telefon nga sekretaria e gjykatës ose nga policia gjyqësore. Në origjinalin e lajmërimit shënohet numri i telefonit të kërkuar, emri dhe detyra që kryen personi që merr njoftimin, marrëdhëniet e tij me atë që njoftohet, data dhe ora e telefonatës. Gjykata, në rrethana të veçanta, mund të disponojë, me urdhër të arsyetuar në fund të aktit, që njoftimi i një personi, përveç të pandehurit, të bëhet duke përdorur mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin”.²¹⁸

Gjithashtu legjislacioni ynë, parashikon procedurat e njoftimit të pandehurit të burgosur²¹⁹, njoftimin e pandehurit të lirë²²⁰, njoftimin e pandehurit i cili nuk gjendet²²¹, si dhe rastet e kur shpallet pavlefshmëria e njoftimit, të mëposhtme:

- kur akti është njoftuar jo i plotë, me përjashtim të rasteve kur ligji lejon njoftimin me ekstrakt;
- kur në kopjen e aktit të njoftuar mungon nënshkrimi i atij që ka bërë njoftimin;
- kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t’i dorëzohet kopja;
- kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë;
- kur në origjinalin e aktit të njoftuar mungon nënshkrimi i personit që ka marrë përsipër njoftimin;
- kur nuk janë respektuar format për njoftimin me mjete teknike të veçanta dhe që për këtë shkak ai që duhej njoftuar nuk ka ardhur në dijeni të aktit.²²²

6.2 Marrja e akteve të tjera dhe provave të procedimit penal

Lidhur me dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur në territorin e një prej shteteve, nevojitet bashkëpunim ndërmjet strukturave ligjzbatuese, si për shkëmbimin e informacioneve, ashtu dhe për plotësimin e dosjes me prova dhe akte të procedimit penal. Disa prej tyre mund të shkëmbehen në rrugë diplomatike, nëpërmjet ministrisë së Drejtësisë

²¹⁸ Shiko: Neni 133 i Kodit të Procedurës Penale

²¹⁹ Po aty, Neni 139

²²⁰ Neni 140.

²²¹ Neni 141.

²²² Neni 143-Pavlefshmëria e njoftimeve

dhe të Jashtme, duke respektuar afatet kohore, por disa mund të shkëmbehen në mënyrë të drejtpërdrejtë polici - polici, nëpërmjet oficerëve ndërlidhës.

Për sa sipër, shtetet mund ti referohen Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Jug-Lindore, e cila lidhur me kërkesa për mbledhjen e provave në rast të rrezikut imediat, parashikon, se:

“1. Në rast të rrezikut imediat, kërkesat mund të paraqiten nga autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit për aq sa janë të autorizuar për të vepruar në këtë mënyrë sipas ligjit kombëtar, për të mbledhur prova duke përfshirë ekzaminime fizike si dhe kontrolle dhe sekuestre, për aq sa parashikohet nga legjislacioni kombëtar. Kërkesat duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent të zbatimit të ligjit.

2. Ekzekutimi i kërkesës duke përfshirë vendimin nëse ekziston në të vërtetë një rrezik imediat varet nga ligji i Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën, e cila duhet të informojë pa vonesë për këtë vendim Palën Kontraktuese që ka drejtuar kërkesën.

3. Nëse kërkesa që referohet në paragrafin 1 nuk është bërë nga autoriteti gjyqësor, autoriteti gjyqësor i ngarkuar duhet të njoftohet pa vonesë që kërkesa është bërë duke përfshirë edhe rrethanat e veçanta të çështjes, duke nënkuptuar rrezikun imediat.

4. Duke qenë se ligji i Palës Kontraktuese që merr kërkesën kërkon një urdhër gjykate për të dhënë ose lënë në fuqi masën në territorin e Palës Kontraktuese që merr kërkesën, një urdhër ose shpjegim nga gjykata kompetente e Palës Kontraktuese që paraqet kërkesën duhet të depozitohet pa vonesë. Palët Kontraktuese duhet të informojnë njëra-tjetrën rreth dispozitave përkatëse të ligjit të tyre kombëtar.

*5. Transmetimi i rezultateve të masave të marra për Palën Kontraktuese që paraqet kërkesën e bën të domosdoshme përpilimin e një letër porosie zyrtare nga autoriteti kompetent gjyqësor. Nëse rezultatet e masave të marra duhet të transmetohen si një nevojë e ngutshme, autoriteti që merr kërkesën mund të transmetojë rezultatet drejtpërdrejt tek autoriteti që paraqet kërkesën. Në rast se autoriteti që merr kërkesën nuk është një autoritet gjyqësor, transmetimi i rezultateve do të kërkojë miratim paraprak nga autoriteti kompetent gjyqësor“.*²²³

Gjithashtu, Konventa ka një nen të veçantë lidhur me kërkesat për ekzaminim fizik. Ky ekzaminim mund të kërkohet për një person të dyshuar apo dhe individë të tjera, të cilët janë banor të një shteti, ndodhet brenda territorit të një shteti etj., por që kanë lidhje me një procedim penal të kryer në territorin e një shteti tjetër. Ndër të tjera, Konventa thekson:

²²³ Shih: Neni 18, i Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Jug-Lindore.

“Për aq sa lejohet nga ligji i Palës Kontraktuese që merr kërkesën, autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese duhet t’i japin njëri-tjetrit asistencë të ndërsjelltë lidhur me ekzaminimin fizik të personit të dyshuar dhe individëve të tjerë;

Kërkesat do të aprovohen vetëm nëse, ekzaminimi kërkohet për të përcaktuar faktet që kanë lidhje me çështjen dhe është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale;

*Një urdhër për ekzaminim fizik dërgohet nga një shërbim i autorizuar për kryerjen e një ekzaminimi të tillë në bazë të ligjit kombëtar të Palës Kontraktuese që paraqet kërkesën, ose bëhet e qartë nga një mesazh i një shërbimi të tillë se janë plotësuar kushtet paraprake për një ekzaminim të tillë, në rast se personi i dyshuar ose persona të tjerë ndodhen në territorin e Palës Kontraktuese që paraqet kërkesën “.*²²⁴

Ndërsa sipas legjislacionit shqiptar, marrja e akteve bëhet me vendim të gjykatës, në përgjigje të kërkesës së prokurorit i cili ka në ndjekje procedimin penal. Gjithashtu këtë të drejtë legjislacioni ynë përveç prokurorisë, i`a njeh edhe institucioneve të tjera që cilat kanë në fokus të punës së tyre çështje të sigurisë kombëtare, si Policia e Shtetit dhe Shërbimi Informativ Kombëtar., me qëllim parandalimin e veprave penale. Më konkretisht shohim interpretimin e ligjit:

“1. Prokurori ka të drejtë, kur është e nevojshme të kryhen hetime, të kërkojë nga gjykata, edhe në rastet e detyrimit të sekretit, kopje të akteve që kanë lidhje me çështje të tjera penale që ai ndjek, si dhe informacione me shkrim mbi përmbajtjen e tyre.

2. Brenda pesë ditëve, gjykata i përgjigjet kërkesës ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar.

*3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe për kërkesat e bëra nga Ministri i Rendit Publik dhe kryetari i Shërbimit Informativ, kur kopje të akteve dhe informacionet u duhen atyre për parandalimin e veprave penale”.*²²⁵

6.3 Shkëmbimi i Letërporosive

Sikurse e kemi theksuar, një nga format e bashkëpunimit për çështjet penale realizohet nëpërmjet letërporosive, si një proces që përdorin shtetet për të dhënë dhe marrë ndihmë formale qeveri me qeveri në hetimet dhe ndjekjet penale. Pothuajse, të gjitha konventat ndërkombëtare përmendin ndihmën e ndërsjelltë juridike, dhe kanë rubrika të veçantë në

²²⁴ Po aty, Neni 19.

²²⁵ Shih: Neni 106 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, (Kërkesa e prokurorit për kopje të akteve dhe për informacione).

këtë drejtim. Përmendim këtu Statutin e Romës²²⁶, i cili thekson se: “Shtetet Palë, bashkëpunojnë plotësisht me Gjykatën për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës”.²²⁷ Po ashtu Konventa Europiane për ndihmë të ndërsjellë juridike²²⁸, identifikon format dhe rrugët e ndihmës nëpërmjet Letër-porositë, ku ndër të tjera thekson se:

*“Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutoj, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letër-porositë që lidhen me një procedim penal që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore ose të kalimit të provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve”.*²²⁹

Por, Konventa gjithashtu, në nenin 5 të saj, rezervon edhe kushtet për të vënë ekzekutimin e letër-porositë të cilat janë:

- a) Krimi, i cili motivon letër-porositë duhet të jetë i dënueshëm sipas ligjit të palës kërkuese dhe të palës e cila pranon kërkesën;
- b) Krimi, i cili motivon letër-porositë duhet të jetë i tillë që të lejoj ekstradimin në vendin ku drejtohet kërkesa;
- c) Ekzekutimi i letër-porositë duhet të jetë në përputhje me ligjin e palës së cilës i drejtohet kërkesa.

Ndërsa legjislacioni ynë kombëtar parashikon kapituj të veçantë lidhur me bashkëpunimin për ndihmë të ndërsjellë juridike për çështjet penale, dhe kryesisht për letërporositë, e cila aplikohet vetëm me vendim gjykatë, duke i klasifikuar në dy lloje: letërporositë nga jashtë shtetit dhe letërporositë për jashtë shtetit.

6.3.1. Letërporositë nga jashtë shtetit

²²⁶ Statuti i Romës, bërë në Romë, më 17 korrik 1998, ratifikuar me ligjin nr 8984, datë 23.12.2002 “Për ratifikimin e statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”.

²²⁷ Shih: Pjesa 9 - Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma gjyqësore, Neni 86 - Detyrimi i përgjithshëm për bashkëpunim.

²²⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në fushën penale” dhe Protokollin e saj shtesë”.

²²⁹ Shih: Neni 3, pika 1, të Konventës.

Kodi i Procedurës Penale shpreh qartë kompetencat institucionale për dhënien rrugë letërporosisë të cilat i takojnë Ministrisë së Drejtësisë, ekzekutimin e saj, si dhe rastet e mos ekzekutimit të letërporosisë, dhe konkretisht:

“Ministria e Drejtësisë vendos që t’i jepet rrugë letër-porosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit.

*Ministria nuk i jep rrugë letër-porosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letër-porosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letër-porosisë”.*²³⁰

Ndërsa, po sipas legjislacionit tonë kombëtar, mosdhënia rrugë letërporosisë e cila ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti, a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj, aplikohet kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur për paprekshmërinë e personit të thirrur. Pra, Ministria e Drejtësisë e ka këtë të drejtë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit. Gjithashtu ekzekutimi i letër-porosisë nuk pranohet edhe kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale. Duhet theksuar se është detyrim i palëve që, objektet, origjinalet e fashikujve dhe të dokumenteve, që janë dhënë gjatë komunikimit në ekzekutimin e një letër-porosisë, ti kthehen palës kërkuese, përveçse kur kjo e fundit heqë dorë.²³¹

Sipas legjislacionit procedural shqiptar, parimet bazë në të cilat bazohen institucionet gjyqësore lidhur me pranimin ose jo të letërporosisë ndërkombëtare janë: Identiteti i Normave; parimi i Specialitetit; dhe parimi i Reciprocitetit.

a. Identiteti i normave, i referohet kryesisht nenit 506, pika 4, paragrafi “b” të Kodit të Pr. Penale, si dhe Ligjit nr. 8498, datë 10.06.1999, sipas të cilit ekzekutimi i

²³⁰ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 506- Kompetencat për letërporositë.

²³¹ Shih: Neni 6, paragrafi 2 i Konventës së Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale", të datës 20 prill 1957, ratifikuar me ligjin nr. 8494, datë 10.6.1999.

letërporosisë ndërkombëtare nuk pranohet kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale.

- b. Parimi i reciprocitetit gjen zbatim në nenin 510, pika 1 të K. Pr. Penale, që lidhet me paprekshmërinë e personit të thirrur. Sipas Kodit, personi i thirrur në bazë të letërporosisë, kur paraqitet, nuk mund t'i nënshtrohet kufizimit të lirisë personale për fakte që kanë ndodhur para njoftimit për t'u paraqitur.*
- c. Parimi i reciprocitetit, parashikohet në K. Pr. Penale në nenin 505, pika 4, sipas të cilit, ministria e Drejtësisë ka të drejtë të mos i japë rrugë letërporosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit.²³²*

6.3.2 Letërporositë për jashtë shtetit

Lidhur me letërporositë për jashtë shtetit, sipas legjislacionit shqiptar, letërporositë e gjykatave dhe prokurorive për njoftimet dhe marrjen e provave, u drejtohen autoriteteve të huaja nëpërmjet ministrisë së Drejtësisë, e cila i përcjellë ato në rrugë diplomatike²³³. Duhet theksuar se, Shqipëria gëzon të drejtën të refuzoj dhënien e ndihmës juridike në fushën penale për dy lloj kategorie veprash penale:

- a. për vepra penale të cilat nuk parashikohen si të tilla nga legjislacioni penal shqiptar në fuqi; dhe,
- b. për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në një shtet tjetër.

Letërporositë fokusohen në ndihmën nga një shtet tjetër në funksion të një procedimi penal ose gjykimi, lidhur me disa nga veprimet e mëposhtme procedurale:

- Marrja e provave ose e dëshmive me shkrim;
- Lokalizimi dhe identifikimi i dëshmitarëve dhe i personave të dyshuar;
- Realizimi i shërbimit të dokumenteve gjyqësore;
- Ekzekutimi i kontrolleve dhe sekuestrove të pronave;

²³² Jola Xhafo, E Drejta Penale Ndërkombëtare, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë 2007, faqe 287, 293.

²³³ Shih: Neni 509 i Kodit të Procedurës Penale.

- Këqyrja e objekteve dhe vendeve;
- Dhënia e informacioneve, provave dhe vlerësimeve të ekspertëve;
- Dhënia e kopjeve origjinale apo të noterizuara të dokumenteve dhe të dhënave përkatëse;
- Identifikimi ose gjurmimi i produkteve të krimit;
- Mundësimi i paraqitjes vullnetare të personave në shtetin kërkues;
- Transferimi i të burgosurve për të dhënë dëshmi.

Gjithashtu, letërporosia mund të dërgohet edhe për thirrjen e një dëshmitari për të dëshmuar për një dijeninë që ka për një vepër, ose një ekspert të një fushe të caktuar për të dhënë mendimin e tij profesional, lidhur me çështjen për të cilën thirret. Kjo letërporosi ekzekutohet nëse legjislacioni tyre i brendshëm e parashikon një gjë të tillë. Në lidhje me këtë Konventa thekson:

*“Në qoftë se pala kërkuese dëshiron që dëshmitaret ose ekspertet të deponojnë pas një hetimi paraprak, ajo duhet të bëjë një kërkesë me shkrim, dhe pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, do të verifikoj nëse ligji i saj e lejon një gjë të tillë ose jo”.*²³⁴

Aktualisht, referuar legjislacionit kombëtar, strukturat policore angazhohen në komunikimin me anën e letërporosive për problemet që lidhen me ekstradimin e personave, kryesisht me kryerjen e verifikimeve për identifikimin e personave nëpërmjet gjurmëve apo në zyrat e gjendjes civile, verifikimin e të dhënave për përfshirjen në aktivitete të paligjshme, apo për përcaktimin e vendndodhjes, me qëllim kapjen dhe arrestimin e tyre. Gjithashtu, letërporositë aplikohen edhe në rastet e verifikimit të aseteve të personave (brenda apo jashtë vendit), kur të dhënat janë se këto asete burojnë nga aktivitete kriminale, si trafik droge, qeniesh njerëzore etj.

6.4 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të huaja

Me ekzekutim të vendimit penal kuptohet zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që, sipas ligjit, kanë ekzekutim të menjëhershëm, me

²³⁴ Shih: Neni 3, paragrafi 2 i Konventës së Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale", të datës 20 prill 1957.

synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proceduar padrejhtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridike të cenuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre. Urdhri i ekzekutimit është akti procedural mbi bazën e të cilit prokurori nis procedurën e ekzekutimit të vendimit penal²³⁵. Urdhri i ekzekutimit përmban vendimin penal që vihet në ekzekutim, identitetin e të dënuarit, vendndodhjen e tij, llojin dhe masën e dënimit kryesor që do të vuhet efektivisht, llojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij, detyrimin civil në procesin penal, si dhe organet që do të ekzekutojnë ose mbikëqyrin ekzekutimin e vendimit.²³⁶

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme²³⁷. Në *Kreun e Pestë* të tij, Kodi parashikon se për personat që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore: me burgim të përjetshëm; me burgim; dhe me gjobë. Ndërsa për personat që kanë kryer kundërvajtje penale jepen këto dënime kryesore: me burgim dhe me gjobë.²³⁸ Gjithashtu, Kodi Penal parashikon edhe dënime plotësuese²³⁹. Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese, të cilat janë:

- Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike.
- Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.
- Ndalimi për të drejtuar automjete.
- Heqja e dekoratave, titujve të nderit.
- Heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie.
- Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë.
- Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative.
- Nxjerrja jashtë territorit.

²³⁵ Gentjan Trenova, “Komente dhe praktikë për Procedurën Penale”, botimet “DITA 2000”, Tiranë, 2011, fq. 342.

²³⁶ Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, neni 13.

²³⁷ Ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, e në vijim.

²³⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Kreu V - Dënimet, Neni 29 - Dënimet kryesore.

²³⁹ Neni 30 - Dënime plotësuese (Ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, neni 3), (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, neni 3).

- Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.²⁴⁰

Gjykata, në raste të veçanta, kur dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme dhe kur ligji parashikon dënim me burgim deri në 3 vjet ose dënime të tjera më të lehta për veprën e kryer, mund të mjaftohet vetëm me caktimin e dënimit plotësues.

Edhe ligji penal amerikan parashikon shumë pengesa në legjislacion, të cilat mund të pengojë ose të vënë në rrezik fillimin e procedimit penal për krime ndërkombëtare. Ato kryesore janë:

- *Ligjet japin amnisti për kategori të gjera të krimeve;*
- *Statutet kombëtare të kufizimit;*
- *Ndalimin e rrezikut të dyfishtë (parimi ne bis idem), ku një person nuk mund të dalë në gjyq dy herë për të njëjtën vepër;*
- *Ligjet kombëtare për imunitetin nga ndjekja penale të kryetarëve të shteteve, anëtarë të qeverisë ose të parlamentarëve.*²⁴¹

6.4.1. Legjislacioni për njohjen e vendimeve penale të huaja

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale ofron rrugët nëpërmjet të cilës shtete të ndryshme, duke hequr dorë nga juridiksioni territorial, bëjnë të mundur realizimin e procedimit penal²⁴². Njohja e vendimeve të huaja si një formë bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale, ashtu sikurse parashikohet në konventat ndërkombëtare, edhe në legjislacionin tonë kombëtar rezervohet një kapitull i veçantë për këtë formë të bashkëpunimit të ndërsjellët. Kështu, Konventa e Këshillit të Europës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale” parashikon, dhënien e ndihmës:

“Palët kontraktuese angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me

²⁴⁰ Marrë nga artikulli: Elezi M, “Penal Decisions’ Execution in Albania”, The Macrotheme Review 2(6), Special Issue: International Macro Themes, 2013, Volume 2 Issue 7, p. 96, ISSN 1848-4735, http://macrotheme.com/current_issue

²⁴¹ Antonio Cassese, “International Criminal Law”, Oxford University Press, Oxford 2003, p. 312.

²⁴² Artan Hoxha, Ekstradimi dhe Urdhri Europian i Ndalimit, shtëpia botuese “Morava”, Tiranë 2011, faqe 21.

*krimet në të cilat shtrëngimi është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetence e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese”.*²⁴³

Ndërsa Protokollit Shtesë i kësaj Konvente thekson se bashkëpunimi i ndërsjellët gjen zbatim edhe për:

a) Dorëzimin e dokumenteve në lidhje me ekzekutimin e një dënimi, marrjen e një gjobe ose pagesën e shpenzimeve të procesit gjyqësor.

*b) Masën që rregullojnë pezullimin e shpalljes së një dënimi ose ekzekutimin e tij, lirimin me kusht, shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të një dënimi ose ndërprerjen e një ekzekutimi të tilla.*²⁴⁴

Ky lloj bashkëpunimi, për njohjen e ekzekutimeve të vendimeve të huaja, formalisht ka ekzistuar në Shqipëri edhe në periudhën e sistemit komunist. Po të shikojmë konventat dypalëshe të ratifikuara nga shteti shqiptar do të gjejmë në të vërtetë lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e ndërsjellët të vendimeve penale të huaja, por edhe raste të kufizimit të tyre. P.sh: Konventa e bashkëpunimit me Gjermaninë, parashikon se:

*“Për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve të gjykatave të njëjës Palë Kontraktonjëse, të cilët njihen në baze të Nenit në territorin e Palës tjetër Kontraktonjëse, me kërkesën përkatëse, Gjykata kompetente e Palës tjetër Kontraktonjëse jep lejen e nevojshme. Dokumentet që kanë shënimin për ekzekutim njihen si vendime të gjykatave. Dhënia e lejes për ekzekutim të detyrueshëm dhe ekzekutimi i detyrueshëm rregullohen nga legjislacioni i Palës Kontraktonjëse, në territorin e së cilës behet ekzekutimi”.*²⁴⁵

Lidhur me rastet e refuzimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve penale, Konventa parashikon se, lejimi i ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore, mund të refuzohet, kur:

“a) Kur personi, që paraqit kërkesën, ose i padituri nuk ka marrë pjesë në gjykimin për shkak se atij, ose përfaqësorëve të tij nuk iu dorëzua me kohe dhe në formën e duhur

²⁴³ Neni 1 paragrafi “1” i Konventës së Këshillit të Europës “Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale”, të datës 20 prill 1957, e cila hyri në fuqi në vitin 1959.

²⁴⁴ Neni 3 i Protokollit Shtesë të Konventës. (ETS Nr. 99).

²⁴⁵ Konventa midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Demokratike Gjermane “Mbi dhënien e Ndihmës Juridike për Çështje Civile, Familjare dhe Penale, bërë në Berlin më 11.01.1959, neni 45-Ekzekutimi I vendimeve. Konventa përmend vendimet e gjykatave, pa i specifikuar ato nëse bëhet fjalë për vendimet penale.

thirrja për në gjykatë, ose për shkak se thirrja i është bere vetëm me anë shpalljeje publike, ose në një mënyrë tjetër që nuk përputhet me dispozitat e kësaj Konventë;

b) kur vendimi i gjykatës është në kundërshtim me një vendim të mëparshëm, që ka marrë formë të prerë, të dhënë për çështjen midis po atyre Palëve, po për ato shkaqe dhe po për ato objekte nga gjykata e Palës Kontraktonjëse, në territorin e së cilës duhet të kryhet ekzekutimi i detyrueshëm”.²⁴⁶

Analizojmë një tjetër marrëveshje bilaterale, atë për ndihmë juridike ndërmjet Shqipërisë dhe Çekosllovakisë, të vitit 1959. Konventa ka një nënkapitull²⁴⁷ që lidhet me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të vendeve respektive, të cilat i klasifikon në dy kategori:

- Vendimeve për çështjet familjare me karakter jo pasuror;
- Vendimeve për çështjet me karakter pasuror.

Por, Konventa ka parasysh vetëm vendimet për çështjet familjare. Konkretisht, Neni 40 i referohet *“Njohjes së fuqisë ekzekutive të vendimeve për çështjet familjare me karakter jo pasuror”*²⁴⁸; ndërsa Neni 41 i referohet *“Njohjes së fuqisë ekzekutive të vendimeve për çështjet familjare me karakter pasuror”*²⁴⁹; kurse Neni 46 i referohet rasteve të refuzimit të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve²⁵⁰, dhe konkretisht, ai parashikon se:

²⁴⁶ Shih: Neni 49 i Konventës- Refuzimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

²⁴⁷ Shih: Nënkapitulli 5- Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve.

²⁴⁸ Konkretisht, marrëveshja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve për çështjet familjare me karakter jo pasuror, parashikon, se: “Vendimet, që kanë marrë formë të prerë, të institucioneve të drejtësisë dhe organeve të tutorisë dhe kujdestarisë të njëjës Palë Kontraktonjëse për çështje të së drejtës familjare me karakter jo pasuror njihen në territorin e Palës tjetër Kontraktonjëse pa ndonjë procedim në qoftë se organet e drejtësisë dhe organet e tutorisë ose të kujdestarisë të Palës tjetër Kontraktonjëse nuk kanë dhënë vendim që të ketë marrë formë të prerë për këtë çështje ose në qoftë se ato në bazë të kësaj Konvente nuk kanë kompetencë ekskluzive”.

²⁴⁹ Lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve për çështjet me karakter pasuror, Konventa parashikon, se, të dy Palët Kontraktonjëse njohin dhe lejojnë ekzekutimin e detyrueshëm në përputhje me dispozitat që vijnë: “a) Vendimet që kanë marrë forme të prerë për çështjet civile dhe familjare me karakter pasuror të dhëna në territorin e Palës tjetër Kontraktonjëse pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente; b) Vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë të dhëna në territorin e Palës tjetër Kontraktonjëse mbas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për çështjet penale lidhur me detyrimin e pagimit të shpërblimit të dëmit të shkaktuar të dëmtuarit; c) Vendimet që kanë marrë formë të prerë të arbitrazhit si dhe pajtimet e përfunduara para këtij organi në çështjet e tregtisë së jashtme edhe sikur njëra nga Palët në çështje të jetë person juridik, që ka patur vendqëndrimin e tij në territorin e njëjës nga Palët Kontraktonjëse”.

²⁵⁰ Për më tepër referoju Neneve të mësipërme të Konventës.

“a) Në qoftë se personi i paditur në çështje nuk ka marrë pjesë në gjykimin për shkak se atij ose përfaqësuesit të tij nuk i qe bërë me kohë qoftë edhe një herë dhe në formën e duhur thirrja për në gjykatë, ose për shkak se thirrja ishte bërë vetëm me anë shpalljeje publike ose me një mënyrë që nuk njihet nga dispozitat e kësaj konvente;

*b) Në qoftë se vendimi gjyqësor është në kundërshtim me një vendim të mëparshëm, që ka marrë formë të prerë, të dhënë për çështjen midis po atyre palëve, për po atë objekt dhe për po atë shkak nga gjykata e Palës Kontraktonjëse, në territorin e së cilës duhet të njihet vendimi ose të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm”.*²⁵¹

Ajo që është evidente, është fakti se, dispozitat e Nenit 46 janë aktuale, dhe si të tilla, mund ti hasim edhe në konventa të tjera në periudhën post komuniste, natyrisht me ndryshime në formë.

Ndërsa, legjislacioni kombëtar jo vetëm që parashikon krerë dhe seksione të veçanta për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, por i trajton ato në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar nivelin e kompetencave sipas hierarkisë. Konkretisht Kodi i Procedurës Penale lidhur me njohjen e vendimeve penale të huaja, parashikon, se:

“Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proceduar penalisht në shtetin shqiptar, i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe.

*Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar. Prokurori i bën kërkesë gjykatës së rrethit gjyqësor për njohjen e vendimit të huaj”.*²⁵²

Lidhur me kushtet e njohjes, legjislacioni ynë parashikon, se, vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet në ato raste, kur:

“a) Vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë;

b) Vendimi përmban disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar;

c) Vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës;

²⁵¹ Shiko: Neni 46 i Konventës.

²⁵² Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Neni 512 - Njohja e vendimeve penale të huaja.

ç) Ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike;

d) Fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar;

dh) Për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formë së prerë ose zhvillohet një procedim penal”²⁵³.

Po thuajse, e njëjta gjë parashikohet edhe për ekzekutimin e vendimeve penale të huaja. Ato pasi janë njohur, i nënshtrohen ekzekutimit të tyre nga prokuroria pranë gjykatës që ka shpallur njohjen.²⁵⁴ Këto kushte burojnë nga të gjitha traktatet ndërkombëtare apo dhe marrëveshjet bilaterale, lidhur me bashkëpunimin në fushën e drejtësisë për çështjet penale, konventa këto, të përmendura më lart, pjesë e së cilës vendi ynë është anëtar. Këtu mund të përmendim konventën e parë të nënshkruar nga shteti shqiptar me Greqinë pas vitit 1990, për zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore për çështjet penale, e cila parashikon, se:

*“Shtetet kontraktuese detyrohen të zbatojnë reciprokisht në bazë të kërkesës, sipas rregullave dhe kushteve që përcaktohen në nenet që vijnë, vendimet që janë marrë për çështje penale, me anën e të cilëve një gjykatë e njërit prej shteteve kontraktuese, ka shpallur në mënyrë të pa revokueshme ndaj një nënshtetasi të shtetit tjetër kontraktues, një dënim ose një mase heqje lirie”.*²⁵⁵

Gjithashtu, shteti shqiptar ka nënshkruar një sërë marrëveshje ku mund të përmendim:

- Marrëveshje bashkëpunimi me Qeverinë e Maqedonisë për ekzekutimin e ndërsjellët të vendimeve gjyqësore për çështjet penale²⁵⁶;
- Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit²⁵⁷;
- Konventën Europiane për Ndihmën Juridike në Fushën Penale²⁵⁸, etj.

²⁵³ Neni 514 - Kushtet e njohjes

²⁵⁴ Neni 518 -Ekzekutimi i vendimit të huaj.

²⁵⁵ Konventa midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore për çështjet penale, nënshkruar më 17 maj 1993, neni 1. Ratifikuar me ligjin nr. 7760, datë 14.10.1993.

²⁵⁶ Ratifikuar me Ligjin nr. 8303, datë 12.3.1998 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për ekzekutimin e ndërsjellët të vendimeve gjyqësore për çështjet penale".

²⁵⁷ Ratifikuar me Ligjin nr. 8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit".

Sipas legjislacionit shqiptar organet që ekzekutojnë vendimin penal të formës së prerë janë, gjykatat, prokuroria, Policia e Shtetit, Shërbimi i Provës, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, dhe Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor. Ndërsa, lidhur me vendimet penale të huaja, legjislacioni kombëtar parashikon se, vendimi penal i huaj nuk mund të ekzekutohen, nëse:

- a. Nuk përmbush kushtin e identitetit të normave, domethënë fakti për të cilin është dhënë vendimi, duhet të parashikohet si vepër penale në legjislacionin e të dy shteteve;
- b. Vepra penale ka natyrë politike ose ushtarake;
- c. Vepra penale është kryer jashtë territorit të shtetit që bën kërkesën;
- d. Sanksioni është parashikuar sipas legjislacionit të shtetit që bën kërkesën.²⁵⁹

Refuzimi i dhënies së ndihmës së ndërsjellët juridike parashikohet dhe në Konventë, sipas së cilës, ndihma juridike mund të refuzohet:

- a) *në qoftë se kërkesa i referohet krimeve që pala, se cilës i drejtohet kërkesa i konsideron ose krime politike ose krime që lidhen me krimet politike ose krimet fiskale;*
- b) *në qoftë se pala, se cilës i drejtohet kërkesa, mendon se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë paragjykim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit të saj.*²⁶⁰

²⁵⁸ Ratifikuar me Ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "për ndihmën e ndërsjellët juridike në fushën penale" dhe protokollin e saj shtesë”.

²⁵⁹ Jola Xhafo, E Drejta Penale Ndërkombëtare, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë 2009, faqe 297.

²⁶⁰ Konventa e Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjellët juridike në fushën penale", bërë në Strasburg më 17 Mars 1978.

Kapitulli VII: BASHKËPUNIMI OPERACIONAL PËR HETIME TË PËRBASHKËTA

7.1 Krijimi dhe funksionimi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore

Mekanizmi më të ri i bashkëpunimit policor në aspektin ligjor janë Ekipet e Përbashkëta Hetimore (EPH), të cilat e kanë origjinën në Titullin VI, në shtyllën e tretë të Traktatit për Bashkimin Evropian²⁶¹, me zhvillimet e njëpasnjëshme në nivel evropian dhe ndërkombëtar, në Traktatin e Amsterdimit, dhe të Nisës, deri në ndryshimet që solli Traktati i Lisbonës. Koncepti i EPH u bë i domosdoshëm për arsye se metodat ekzistuese të bashkëpunimit policor ndërmjet shteteve nuk ishin të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar, dhe për rrjedhojë puna në grup, me ekip hetuesish nga dy ose më shumë shtete duke punuar së bashku, rrisnin mundësitë e një lufte me efikasitet kundër krimit të organizuar ndërkufitar²⁶². Për përdorimin e EPH ka ekzistuar një bazë ligjore, edhe pse jo specifike që përfshinte:

- Protokollin e II-të Shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale²⁶³;
- Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar²⁶⁴;
- Konventën për Ndihmë të Ndërsjellë dhe Bashkëpunim ndërmjet Administratave Doganore;²⁶⁵
- Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore²⁶⁶.

²⁶¹ Traktati për Bashkimin Evropian të nënshkruar në 7 shkurt 1992 në Mاستriht.

²⁶² “*Mediterranean Journal of Social Sciences*”, Vol 5 No 1 January 2014, M. Elezi: “*EUROJUST and Joint Investigation Teams*”, p. 103. ISSN: 2039-9340, Romë, January 2014

²⁶³ Neni 20 i Protokollit të II-të Shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale, datë 20.04.1959.

²⁶⁴ Neni 19 i Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, miratuar më datë 15.11.2000.

²⁶⁵ Neni 24 i Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë dhe Bashkëpunim ndërmjet Administratave Doganore (Konventa Napoli II), miratuar më datë 18.12.1997.

²⁶⁶ Neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (PCC SEE), miratuar më datë 05.05.2006.

Me Konventën e Bashkimit Europian për Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore të vitit 2000, neni 13 i saj, Bashkimi Europian krijoi një bazë ligjore vetëm për EPH. Ndërsa një vit më vonë, Këshilli miratoi një Vendim Kuadër për EPH i cili do të shpejtonte përdorimin e instrumentit të EPH, përmbajtja e të cilit është një ripërsëritje e formulimit të nenit 13. Kuadri ligjor u jep përgjigje shumë pyetjeve lidhur me krijimin, organizimin, përbërjen, funksionimin etj.

Bazuar në këtë Konventë, si dhe në nenin 1(12) të Vendimit Kuadër, EUROPOL mund të ofroj këshilla për marrëveshjet për EPH dhe për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit²⁶⁷. Në aspektin ligjor, bashkëpunimi policor në Europë ka qenë subjekti i progresit të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm në fushën e punëve të brendshme. Në aspektin ligjor fillesa e bashkëpunimit policor është Traktati për Bashkimin Evropian i cili është teksti i parë ku përmendet bashkëpunimi policor. Traktati i Mاستrihtit²⁶⁸ e shtjellon bashkëpunimin policor në Titullin VI i cili përbën Shtyllën e Tretë të traktatit të BE.²⁶⁹ Traktati i Amsterdimit i nënshkruar në vitin 1997²⁷⁰, ndryshon Traktatin për Bashkimin Evropian. Risia që sjell ky Traktat në Titullin VI është kufizimi i bashkëpunimit policor dhe gjyqësor vetëm për çështje penale, ndërsa çështjet civile kalojnë në Shtyllën e parë me natyrë komunitare.²⁷¹ Traktatit për Bashkimin Evropian në përmbajtjen e tij, e specifikon bashkëpunimin policor dhe gjyqësor si më poshtë:

- *“....bashkëpunimi ndërmjet ministrive përgjegjëse dhe autoriteteve gjyqësore apo të ngjashme të Shteteve Anëtare në lidhje me procedimin dhe ekzekutimin e vendimeve”;*
- *“lehtësimi i ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare”;*
- *“sigurimi i zbatueshmërisë së rregullave të zbatueshme në shtetet anëtare”;*
- *“parandalimi i “konflikteve të juridiksionit ndërmjet shteteve anëtare”;* dhe

²⁶⁷ Shih: nenin 1(12) të Vendimit Kuadër

²⁶⁸Traktati për Bashkimin Evropian (Traktati i Mاستrihtit) i 7 shkurtit 1992, OJ C 191, 29.7.1992, fq. 1. Traktati hyri në fuqi në 1 nëntor 1993.

²⁶⁹Traktati i Mاستrihtit që krijon Bashkimin Evropian, ndan politikat e BE-së në tre shtylla kryesore. Shtylla e Parë (Komunitetet Evropiane) u plotësuar nga Shtylla e dytë ndërqeveritare (Politika e Sigurisë së Përbashkët dhe Drejtësisë) dhe shtylla e tretë (Bashkëpunimi në drejtësi dhe punë të brendshme).

²⁷⁰Fletore Zyrtare OJ C 340, 10 nëntor 1997.

²⁷¹Nenet 61 dhe 65 Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, në Titullin për vizat, azilin dhe imigracionin dhe politika të tjera që i referohen lëvizjes së lirë të personave.

- *“miratimi progresi i masave që krijojnë rregulla minimale në lidhje me elementët përbërës të veprave penale dhe ndëshkimet në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit të paligjshëm të drogave”.*²⁷²

Instrumentet me anë të së cilave do të realizohen masat e sipërcituara, parashikohen në nenin 29 të Traktatit për Bashkimin European, të cilat janë:

- *“Bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet forcave policore, doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente të shteteve anëtare, si drejtpërdrejt ashtu dhe nëpërmjet EUROPOL në përputhje me dispozitat e nenit 30 dhe 32;*²⁷³
- *Bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe kompetente të shteteve anëtare;*
- *Përafrim i dispozitave për çështje penale në shtetet anëtare”.*²⁷⁴

Ndërsa Traktati i Lisbonës²⁷⁵ forcon bashkëpunimin policor të cilat përfshijnë mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit; mbështetje për trajnimin e stafit dhe bashkëpunimin për shkëmbimin e stafit, pajisjet dhe kërkimit për zbulimin e krimit; teknika të përbashkëta hetimore në lidhje me zbulimin e formave të rënda të krimit të organizuar.²⁷⁶ Ky traktat sjell risi në fushën e bashkëpunimit gjyqësor mundësinë e krijimit të zyrës së Prokurorisë Evropiane për të luftuar krimet që prekin interesat financiare të BE dhe krimin e rëndë me dimension ndërkufitar²⁷⁷ në bashkëpunim me EUROPOL-in.

Autoritetet ligjzbatuese e identifikojnë EPH si një ekip me përfaqësues të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të tjerë nga shtete të ndryshme që hetojnë bashkërisht çështje të krimit

²⁷² Neni 13 i Traktatit për Bashkimin European.

²⁷³ Neni 30 i Traktatit për BE parashikon veprimet e përbashkëta në fushën e bashkëpunimit policor, ndërsa neni 32 i Traktatit për BE parashikon veprimin e mundshëm nga autoritetet të përmendura në ish nenin 30 dhe 31 “në territorin e shteti tjetër anëtar në bashkëpunim dhe në marrëveshje me autoritetet e atij shteti”, sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara nga Këshilli. Në lidhje me Europol-in, duhet të përmendet krijimi i tij nga “Konventa Europol” e nënshkruar në 26 korrik 1995, Fletore Zyrtare OJ C 316, 27 nëntor 1995.

²⁷⁴ Shih: neni 29 të Traktatit për Bashkimin European.

²⁷⁵ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European (Traktati i Lisbonës), hyri në fuqi në 1 dhjetor 2009, Fletore Zyrtare C 83 of 30.3.2010.

²⁷⁶ Shih, Neni 87 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European (Traktati i Lisbonës).

²⁷⁷ Shih Neni 86 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European.

ndërkombëtar apo ndërkufitar. Manuali²⁷⁸ i njohur nga autoritetet ligjzbatuese, i hartuar për EPH, përcakton që këto ekipe krijohen mbi bazën e marrëveshjes ndërmjet dy ose më shumë shteteve anëtare dhe/ose palëve të tjera për një qëllim specifik dhe një kohëzgjatje të caktuar. Ndërsa, lidhur me bazën ligjore për krijimin dhe funksionimin e EPH, me qëllim luftën kundër krimit ndërkombëtar, nivelet e larta politike të BE-së vendosën kuadrin ligjor. Ky kuadër u prezantua në nenin 13 të Konventës të BE-së për Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore në Çështje Penale, të vitit 2000²⁷⁹ dhe në nenin 1 të Vendimit Kuadër të Këshillit për Ekipet e Përbashkëta Hetimore.²⁸⁰ Këto dy dokumente të rëndësishme synojnë që t'i japin shteteve anëtare rregulla të qarta për krijimin e një ekipi, përbërjen, drejtimin dhe kompetencat e anëtarëve të ekipit, rregullat e funksionimit dhe përdorimit të informacionit të mbledhur etj. Gjithashtu si bazë ligjore për krijimin e një EPH ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të treta shërbejnë dhe dokumentet e mëposhtme:

- Protokoli i Dytë Shtesë i Konventës²⁸¹ së Këshillit të Europës për Ndihmën e Ndërsjellët në Çështje Penale, i 20 prillit 1959 ²⁸²(neni 20);
- Konventa²⁸³ e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 15 nëntor 2000 (neni 19);
- Konventa për ndihmë të ndërsjellë dhe bashkëpunim ndërmjet administratave doganore (Konventa Napoli II)²⁸⁴, 18 dhjetor 1997 (neni 24);

²⁷⁸Manual për Ekipet e Përbashkëta Hetimore, Bruksel, 4 nëntor 2011

²⁷⁹Akt i Këshillit i 29 majit 2000 që krijon në përputhje me nenin 34 të Traktatit për bashkimin European, Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit European, OJ C 197, 12.07.2000 fq. 1.

²⁸⁰Vendim Kuadër i Këshillit i 13 qershorit 2002 për ekipet e përbashkëta hetimore, OJ L 162, 20.06.2002, fq.1.

²⁸¹Ratifikuar nga Shqipëria (protokoli dhe Konventa) me ligjin nr 8498 datë 10.06.1999

²⁸²Protokoli i Dytë Shtesë i Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale, Strasburg, 8 nëntor 2001, Seritë e Traktatit European- nr 182 URL:

<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/182.htm>

²⁸³Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr 8920, datë 11.7.2002

²⁸⁴ Akt i Këshillit i 18 dhjetorit 1997 që krijon në bazë të nenit K.3 të Traktatit për Bashkimin European, Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë dhe Bashkëpunimin ndërmjet Administratave Doganore të 18 dhjetorit 1997, OJ C 24, 23.1.1998, fq 1

- Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (PCC SEE)²⁸⁵, 5 maj 2006 (neni 27).

Ekipe të Përbashkëta Hetimore mund të jenë mjete të duhur për hetim të suksesshëm për rastet veprave kriminale të: *Terrorizmit*, ku vendi ku vendi i sulmit të planifikuar ndryshon nga vendi ku mbledhet informacioni i parë. Në të tilla raste informacioni i rëndësishëm shpesh shpërndahet në shumë vende të ndryshme; dhe *Trafikut ndërkombëtar të drogës*, pasi dihet që trafikantët kanë vendbanime të ndryshme, dhe trafikimi ndodh nëpër dy ose më shumë shtete, për të mbërritur në destinacion.

Operacionet e përbashkëta janë të shumta, por mund të përmendim disa prej tyre, si p.sh:

- *Bashkëpunimi ndërmjet strukturave policore shqiptare, bullgare dhe maqedonase:*

Në muajin tetor 2009, u zhvillua operacioni `BARTER` i cili konsistoi në parandalimin dhe konfiskimin e lëndëve narkotike. Në përfundim u arrit konfiskimi i 132 kg heroinë në Bullgari dhe Maqedoni.

- *Bashkëpunimin mes policisë shqiptare dhe italiane:*

- Operacioni “Sunrise” (Lindja e Diellit) kundër një organizate kriminale që merrej me trafikun e marijuanës dhe të heroinës dhe ku në Shqipëri u arrestuan 9 persona ;
- Operacioni “Il Ponte” (Ura) kundër një organizate kriminale që merrej me trafikimin e heroinës dhe ku në Shqipëri u arrestuan 9 persona ;
- Operacioni “Ellenika – AL” kundër një organizate kriminale që merrej me trafikimin e heroinës e marijuanës dhe ku në Shqipëri u arrestuan 6 persona;²⁸⁶

Ndërsa, për vitin 2013 janë ngritur dhe funksionuar 10 Ekipet Hetimore të Përbashkëta të koordinuara nga Qendra SELEC, nga të cilat 6 EHP për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike, 1 për trafikim të armëve dhe municioneve luftarake, 1 për trafikim të veprave të artit, 1 për trafikimit të mjeteve motorike, dhe 1 EPH për kontrabandim të mallrave ku janë përfshirë disa juridiksione. Sipas shifrave zyrtare të SELEC, për periudhën

²⁸⁵ Ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr 9604 datë 11.9.2006

²⁸⁶ Analiza e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit 2010. Operacionet janë të iniciuara nga SELEC në vitin 2009, si rezultat i informacioneve të marra nga burime në shtetet respektive.

2005 - 2012 janë realizuar 170 operacione kundër trafikimit ndërkombëtar të drogës, ku janë përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe janë arrestuar 280 persona në Shqipëri.

Lidhur me *kontrabandën e mallrave*, dihet që kontrabandistët përdorin futjen e mallrave në mënyrë të paligjshme për t'iu shmangur detyrimeve doganore që kanë ndaj shteteve, kjo për të maksimizuar fitimin. P.sh: operacioni tjetër i vitit 2007 ishte “HURRICANE 2”, ku morën pjesë 12 vende të Europës Juglindore, i cili pati si qëllim sekuestrimin e cigareve kontrabandë në rajonin e Europës Juglindore. Rast tjetër mund të përmendim operacionin “SHADOW 3” e zhvilluar në muajin mars 2008, i cili solli konfiskimin e 666.056.970 paketave cigare, apo Operacionin tjetër të koduar “HURRICANE 2”, ku morën pjesë 12 vende të Europës Juglindore, i cili pati si qëllim sekuestrimin e cigareve kontrabandë në rajonin e Europës Juglindore.

Rast studimor EPH: *Hetimi i përbashkët “Marry”, operacioni “Le Manche”²⁸⁷, ndërmjet shteteve Shqipëri - Francë - Britani e Madhe:*

Në vitin 2012, strukturat e policisë shqiptare dhe asaj britanike, grumbulloi të dhëna se shtetasi H.M, në bashkëpunim me persona të tjerë, është përfshirë në kontrabandim të njerëzve nga Shqipëria drejt Mbretërisë së Bashkuar. Të dhënat e grumbulluara u referuan në Prokurorinë për Krime të Rënda e cila mbi bazën e tyre regjistroi Procedimin Penal, që bën fjalë për veprën penale të “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve e kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 298, 333/a të Kodit Penal. Si bashkëpunëtorë të shtetasit H.M në këtë aktivitet të paligjshëm janë evidentuar një grup shtetasish me qëndrim në Angli, Itali, Francë, Belgjikë, Kosovë, të cilët realizojnë ndihmën për kalim të paligjshëm të kufijve personave të interesuar kundrejt një pagese prej rreth 5000 - 6000 Paund britanik.

Në këtë kuadër, me qëllim dokumentimin e aktivitetit kriminal me shtrirje të gjerë, me kërkesë të Task-Forcës së SELEC kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, u kërkuar krijimi i një EPH me pjesëmarrjen e nga një prokurori dhe specialisti policor kundër trafikimit nga të Shqipëria, Franca, dhe Britania e Madhe. Pas hetimeve të kryera, më datë 29.03.2012 strukturat policore në bashkëpunim me Prokurorinë për Krime të Rënda, si dhe në

²⁸⁷ Procedimin Penal nr. 198, datë 24.12.2012, për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve e kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal”, nenet 298, 333/a të Kodit Penal. Prokuroria për Krime të Rënda.

bashkëpunim me homologët policore të Britanisë së Madhe dhe Francës finalizuan me sukses operacionin ndërkombëtar "Le Manche", i cili nga autoritetet britanike është koduar "Merry". Gjatë këtij operacioni u arrestuan shtetasit:

- *H.M, 47 vjeç, banues në Tiranë, i dënua më parë për veprën penale "Falsifikim", veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, e kryer më shumë se një herë në formën e grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal;²⁸⁸*
- *SH.S, 37 vjeç, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i dënua më parë për veprën penale "Mashttrim", për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, e kryer më shumë se një herë në formën e grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal;²⁸⁹*
- *A.P, 39 vjeç, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i pa dënua më parë, për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, e kryer më shumë se një herë në formën e grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal;²⁹⁰ Si dhe u shpallën në kërkim shtetasit:*
- *A.B, 37 vjeç, lindur në Kukës dhe banues në Angli, për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, e kryer më shumë se një herë në formën e grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal;²⁹¹*
- *K.B, 29 vjeç, lindur në Fier dhe banues në Angli, për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, e kryer më shumë se një herë në formën e grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal.²⁹²*

Gjatë hetimeve u provua se, shtetasit e mësipërm janë të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve shqiptarë drejt Britanisë së Madhe duke i transportuar të fshehur në kamionë. Gjithashtu, bashkëpunëtorë të tyre janë evidentuar edhe persona të tjerë me qëndrim në Kosovë, Francë, Belgjikë, Itali dhe Britaninë e Madhe. Të gjitha hetimet hetimore dhe operacionale të sipërcituara u kryen njëkohësisht në tre shtete, të koordinuara ndërmjet tyre. Pas kryerjes së operacionit "Le Manche", autoritetet policore shqiptare, në bashkëpunim

²⁸⁸ Vendim Nr. 96, datë 28.03.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për të cilin Gjykata ka vendosur masën e sigurimit "Arrest në burg".

²⁸⁹ Vendim Nr. 97, datë 28.03.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për të cilin Gjykata ka vendosur masën e sigurimit "Arrest në burg".

²⁹⁰ Vendim Nr. 100, datë 28.03.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për të cilin Gjykata ka vendosur masën e sigurimit "Arrest në burg".

²⁹¹ Vendim Nr. 99, datë 28.03.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për të cilin Gjykata ka vendosur masën e sigurimit "Arrest në burg".

²⁹² Vendim Nr. 98, datë 28.03.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për të cilin Gjykata ka vendosur masën e sigurimit "Arrest në burg".

me Prokurorinë për Krime të Rënda, autoritetet e Britanisë së Madhe, dhe Franceze, vazhduan veprimet për hetimin e plotë të aktivitetit kriminal të këtij grupi të strukturuar. Aktualisht çështja vazhdon të jetë në gjykim në tre shtete.

7.2 Bashkëpunimi kundër terrorizmit

Çështja mbi përkufizimin e terrorizmit është një temë debati ndërmjet shteteve, por pikat e përbashkëta të ekspertëve janë: veprim i paramenduar, planifikuar në avancë dhe jo një akt i thjeshtë i shtyrë nga motive të dobëta; veprim i shtyrë nga motiv politik, për të ndryshuar politikën ekzistuese; veprim i drejtuar kundër civilëve, duke përhapur panik dhe frikë,²⁹³ dhe veprim i cili ndërmerret nga grupe të konsiderueshme. Nuk është arritur në një përkufizim të njëjtë dhe shumë shtete e kuptojnë dhunën të motivuar politikisht, të tjerë i trajtojnë si krime. Legjislacioni ynë penal, jep këtë kuptim mbi veprat me qëllime terroriste:

“Kryerja e veprave me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare apo të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar ose destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni ose organizate ndërkombëtare”²⁹⁴.

Ndërsa, amerikanët e kanë përcaktuar terrorizmin si:

“dhunë e paramenduar, e motivuar politikisht, kundër objektivave jo-ndërlyftuese, e ndërmarrë nga grupe të segmenteve të një shteti ose nga agjentë klandestinë, zakonisht të interesuar për të ndikuar mbi një kategori njerëzish”²⁹⁵.

Terrorizmi përkufizohet si përdorim i llogaritur i dhunës, ose i kanosjes për përdorim të saj, nga individë, grupe të segmenteve të një vendi ose veprimtarë shtetëror për arritjen e objektivave politikë, shoqërorë e ekonomikë në kundërshtim me ligjin. Këto akte kanë për qëllim të krijojnë frikë masive në një zonë të vënë në shënjestër që është shumë më e gjerë

²⁹³ Xhavit Shala, Ballkani, Gjeopolitika dhe Siguria, vëllimi II”, shtëpia botuese “ONUFRI”, Tiranë 2009, fq. 158.

²⁹⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 230. Ndryshuar me Ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007, neni 15.

²⁹⁵ “Krimi dhe antikrimi- Historia e bandave kriminale”, Bujar Hoxha, shtëpia botuese Ombra GVG, Tiranë, 2008, faqe 230.

se ajo ku u sulmuan apo u kërcënuan viktimat.²⁹⁶ Për më tepër, lidhjet mes veprimtarive të organizuara kriminale dhe terrorizmit shfrytëzohen nga grupet terroriste për të financuar qëllimet e tyre kriminale.²⁹⁷ Përmasat e fenomenit të terrorizmit janë intensive, megjithatë legjislacioni kombëtar i përshkruan ato si:

*“Kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj jetës, shëndetit të njerëzve, lirisë vetjake nëpërmjet rrëmbimit të tyre apo të mjeteve të udhëtimit masiv, që kanë për qëllim turbullimin e rëndë të rendit publik dhe ngjalljen e frikës dhe pasigurisë në masë, dënohet me burgim jo më pak së 15 vjet ose me burgim të përjetshëm”.*²⁹⁸

Sipas përcaktimit në legjislacionin kombëtar, “Terrorist” është:

*“çdo person fizik, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë, në mënyrë vullnetshme, akte terroriste me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose që ka marrë pjesë si bashkëpunëtor në akte terroriste a në financimin e tyre, që ka organizuar ose drejtuar persona të tjerë për të kryer akte terroriste ose për ti financuar ato, që ka kontribuar me dashje ose duke pasur dijeni për kryerjen e akteve terroriste apo për financimin e tyre nga një grup personash, që veprojnë për një drejtim të përbashkët”.*²⁹⁹

Duke i`u referuar strategjisë së sigurisë kombëtare, në pjesën e dytë të saj, në kreun ku flitet për kërcënimet dhe rrezitjet e sigurisë, konstatohet se:

*Grupet militante dhe ekstremiste, të cilat përdorin dhunën për të realizuar objektivat politike, janë një rrezik serioz për sigurimin e jetës së qytetarëve dhe funksionimin e shtetit në Republikën e Shqipërisë.*³⁰⁰

Grupet e mëdha terroriste që veprojnë në shkallë ndërkombëtare hyjnë në tri kategori me kufij jo të përcaktuar qartë: ekstremistë fetarë të sponsorizuar nga qeveritë, palestinezë radikalë apo separatistë, dhe grupe majtiste. Megjithatë, pavarësisht nga kategorizimi,

²⁹⁶ “Lufta kundër terrorizmit”, Yonah Alexander, 2004, faqe 16.

²⁹⁷ Thomas M. Sanderson, “Transnational Terror and Organized Crime: Blurring the Lines”, SAIS Review XXIV, no. 1 (Winter-Spring 2004): 49 – 61; “5th Anti-Terrorism Task Force Meeting and Regional Workshop on Countering Terrorist Financing”.

²⁹⁸ Kodi Penal i RSH, cituar nga B. Hoxha, në “Krimi dhe antikrimi - Historia e bandave kriminale”, Ombra GVG, Tiranë, 2008, faqe 231.

²⁹⁹ Ligji nr. 9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër Financimit të Terrorizmit”, neni 3, paragrafi 4.

³⁰⁰ Strategjia e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, Pjesa II, Kreu IV Kërcënimet dhe rreziqet për Sigurinë, pika 29/3, miratuar me ligjin nr. 9322, date 25.11.2004, botuar në Fletore Zyrtare nr. 98, datë 20.12.2004.

shumica e organizatave terroriste ruajnë një strukturë të ngjashme me shumicën e bizneseve dhe organizatave të tjera të ligjshme. Ato kanë qëllime dhe objektiva, angazhohen në planifikim dhe vendimmarrje si dhe kanë udhëheqjen dhe hierarkinë e komandës. Pavarësisht nga struktura e tyre fizike, të gjitha organizatat terroriste i përshkon një fill i përbashkët: bërthamë udhëheqëse, kuadro aktive, përkrahës aktivë dhe përkrahës pasivë. Ndërsa, organizata terroriste të ekstremistëve fetarë synojnë përdorimin e dhunës për të vendosur “pushtetin hyjnor” si pushtet zyrtar politik, ekonomik, shoqëror. Terrorizmi fetar vjen nga besime ekstremiste fetare të mëdha si Islami, Ortodoks ose kulte fanatike të tjera me bazë fetare. Sponsorizuesit shtetërorë të terrorizmit pengojnë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit. Këto vende sigurojnë bazën kryesore për grupet terroriste. Pa sponsorizuesit shtetërorë, grupet terroriste do ta kishin shumë më të vështirë për të gjetur fonde, armë, materiale dhe për të siguruar zonat që u nevojiten për të planifikuar dhe zbatuar operacionet e tyre³⁰¹. Më shqetësues është fakti se disa nga këto vende kanë aftësinë për të prodhuar armë të shkatërrimit në masë si dhe teknologji të tjera destabilizuese që mund të bien në dorë të terroristëve. Kërcënimet paraqiten në forma e mënyra nga më të ndryshmet. Ato mund të ndodhin në formën e akteve të rëndomta terroriste, duke përdorur armët e shkatërrimit në masë apo dhe në formën e terrorizmit kibernetikë.³⁰² Aktet më të rëndomta të terrorizmit janë bombat, vrasjet, rrëmbimet e personit, pengmarrja, rrëmbimet e automjeteve, rrëmbimet e avionëve, sulmet e armatosura, gjymtimet dhe zjarret. Më të preferuarat midis tyre janë rrëmbimet e personit, sulmet e armatosura dhe bombat.

Në Shqipërinë post komuniste pavarësisht se nuk kanë ndodhur akte terroriste, u krijua një mjedis lehtësues për aktivistët e organizatave të tilla. Duke parë në këndvështrimin historik kjo ka ardhur nga disa faktorë:

- *Paqëndrueshmëria politike në vitet 1990, krijoj lehtësirat për futjen e anëtarëve të organizatave terroriste në Shqipëri, kryesisht të Al-Kaeda-s;*

³⁰¹ TE-SAT 2011, EU Terrorism Situation and Trend Report, EUROPOL, Hague 2011, p. 11, ISSN: 1830-9712.

³⁰² Ismet Elezi, “E Drejta Penale- Pjesa e posaçme”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar Tiranë, 2002, fq. 326 - 327.

- *Mungesa e duhur e autoritetit të shtetit;*
- *Mungesa e legjislacionit;*
- *Niveli i ulët i sigurisë së brendshme;*
- *Niveli i ulët i kontrollit të kufijve;*
- *Shkalla e lartë e kriminalitetit;*
- *Krijimi i organizatave joqeveritare islamike;*
- *Destabilizimi kombëtar në vitin 1997, grabitja e depove të armëve;*
- *Luftërat që janë zhvilluar në Kosovë dhe Maqedoni.*³⁰³

Gjatë viteve '90, Shqipëria shërbeu si një strehë për organizata të huaja ekstremiste, të cilat përfituan nga mungesa e shtetit ligjor dhe e stabilitetit. Individë të veçantë të organizatave joqeveritare që u shfaqën në ombrellën e ndihmave humanitare, mbështetën dhe organizata terroriste të Al Kaeda-s³⁰⁴. Si pasojë, kërcënimet terroriste në mes të viteve '90 shkaktuan mbylljen e përkohshme të ambasadës amerikane në Shqipëri dhe anulimin e të gjithë vizitave të zyrtarëve të lartë amerikanë të planëzuara në Shqipëri. Në mbrojtje të sigurisë kombëtare nga kërcënimet terroriste, në Shqipëri u ratifikuan dhe u miratuan një seri ligjesh dhe akte të tjera nënligjore³⁰⁵, ku mund të përmenden, Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për luftën kundër financimit të terrorizmit” viti 1999³⁰⁶ dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Në zbatim të Ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, në Shqipëri janë kryer sekuestrimet e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet), si më poshtë:

³⁰³ Mustafa Xhemali, “Terrorizmi, sfidë e kohës”, shtëpia botuese “KRISTALINA”, Tiranë 2009, fq. 53.

³⁰⁴ Marrë nga: “Terrorizmi ndërkombëtar, tiparet, natyra dhe karakteristikat e tij”, “PROCEEDINGS BOOK”, IC-2012, botim i UV. Shkodër, Albania. Nëntor 2012, faqe 1634-1637, ISBN: 978-9928-4011-9-9.

³⁰⁵ Counterterrorism Experiences of SECI Member Countries, Bucharest, June 2011, Questionnaire for the SECI Members about their Counterterrorism Experiences Republic of Albania: “Legal measures of CT in the country”, p.21- 24.

³⁰⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 8865, datë 14.3.2002, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për luftën kundër financimit të terrorizmit” viti 1999.

“- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të shtetasit Arab Asin Al-Qadi.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të Fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame” (Revival Of Islamic Heritage Society - RIHS).

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit “Al Haramania”.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit “Taibah Internacional”, i njohur dhe si “Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave”.

- Për sekuestrimin e pasurive, llogaritë, investimet dhe asetet e shtetasit Abdul Latif Saleh.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari të shtetasit Nabil Abdyl Sayadi.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të Fondacionit “Global Relief Foundation” (GRF)”.³⁰⁷

Rast studimor: Kontributi i institucioneve ligjzbatuese në Shqipëri lidhur me arrestimin e anëtareve të organizatave terroriste.

Si rast studimor do të analizojmë bashkëpunimi ndërkombëtar lidhur me kapjen dhe dorëzimin e terroristëve të disa organizatave terroriste ndërkombëtare, të cilët erdhën në Shqipëri për të zhvilluar aktivitetet “humanitar”:

- Në vitin 1993, në Shqipëri, disa shtetas egjiptian filluan aktivitetin “humanitar” si pjesëtar të Fondacionit “Al Haramania” me qendër në Riad të Arabisë Saudite, duke e shtrirë këtë aktivitet në disa qytete si, Tiranë, Peshkopi, dhe Elbasan. Ky fondacion kishte në përbërje të tij shtetasin egjiptian Ahmad Ibrahim Al Najar, i cili ishte prezantuar në Shqipëri me emrin Muhamed Fouda, ose Ebu Mahmudi, i cili ishte lidhje e ngushtë e terroristit Osama Bin Laden.
- Nga informacionet e marra nga shërbimet inteligjente shqiptare, rezultonte se, shtetasi egjiptian Ahmad Ibrahim Al Najar në vitin 1981 kishte marrë pjesë në një organizatë terroriste në Kajro, e cila kishte vrarë Presidentin e Republikës Arabe të Egjiptit, Al-Sadat, dhe për këtë ishte i dënuar me 3 vjet burgim.

³⁰⁷ Shih: Strategjia Ndërsektorale e luftës kundër Terrorizmit, 2011 - 2015, miratuar me VKM nr. 675, datë 06.07.2011, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale të luftës kundër Terrorizmit, 2011-2015, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”.

- Në vitin 1994, shtetasi egjiptian Ahmad Ibrahim Al Najar kishte marrë pjesë në një atentat për hedhjen në erë të Khan Al Khalil në qendër të kryeqytetit egjiptian Kajro, dhe për këtë ngjarje ishte i dënuar në mungesë me vdekje.
- Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit, autoritetet shqiptare bënë të mundur arrestimin e shtetasit egjiptian Ahmad Ibrahim Al Najar, në ambientet e Institutit “El Hagri” në Elbasan, dhe ekstradimin e tij në Egjipt.³⁰⁸ Gjithashtu u bë sekuestrimi i pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit “Al Haramania”.
- Gjithashtu, në kuadër të luftës kundër terrorizmit, në Shqipëri u arrestuan dhe shtetas të tjerë të egjiptian, anëtarë të organizatës terroriste ndërkombëtare “Xhihadi Islamik Egjiptian”, si: Issan Abd Al-Tawab Abd Al-Alin, dhe Ahmad Ismail Othman Saleh i njohur në Shqipëri si Muhamed Khalid; të cilët kishin udhëheqës të tyre Al Zawahiri, i vrarë gjatë sulmit amerikan në Afganistan, lidhje e Osama Bin Laden. Këta shtetas u ekstraduan në Egjipt.

Po kështu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar kundër terrorizmit ndërmjet autoriteteve të Shqipërisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe Egjiptit, mund të përmendim dhe sekuestrimin e asteteve të Fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame” (me qendër në Kuvajt), dhe arrestimin e shtetasve egjiptian, si: Shawqi Salamah Mustafa, i njohur si Mexhid Mustafa, dhe Muhamed Hasan, të cilat erdhën në Shqipëri për të zhvilluar aktivitet bamirësie në Shkodër dhe Elbasan, ku synonin financimin e studimeve të disa shtetasve shqiptarë në vendet arabe, si dhe dhënien e ndihmës ekonomike (pension mujor) prej 25 dollar në muaj për fëmijët jetimë. Këta shtetas u ekstraduan në Egjipt më datë 25.06.1998.³⁰⁹

Lufta kundër krimeve me natyrë terroriste aktualisht është prioritet i gjithë strukturave ligjzbatuese në mbarë botën. Misioni i strukturave policore të cilat kanë në fokus luftën kundër akteve terroriste, është zvogëlimi në maksimum i rrezikut terrorist ndaj vendit tonë, duke përmirësuar elementet e sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste. Ndërsa politikat për luftën kundër terrorizmit fokusohen në:

³⁰⁸ Xhavid Shala, “Siguria dhe Sfidat e Integritimit”, botuar nga Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare”, viti 2003, faqe 101, 102.

³⁰⁹ Po aty, faqe 102 dhe 106.

- “ *Parandalimin e terrorizmit, ndalimin e radikalizmit/ekstremizmit si prirje për terrorizëm dhe çdo akti tjetër kriminal;*
- *Ndjekjen e informacioneve të përpunuara dhe hetimeve që kryhen për të ndërprerë aktivitetet terroriste;*
- *Sigurimin dhe mbrojtjen e infrastrukturës dhe interesave të vendit tonë nga terroristët dhe ekstremistët;*
- *Reagimin dhe zbutjen e efektit të sulmeve duke hartuar plane emergjencash për rastet e sulmeve terroriste, duke trajnuar punonjësit që do të reagojnë të parët dhe duke siguruar që çdo reagim të jetë i koordinuar dhe i testuar”.*³¹⁰

Si përfundim, mund të themi se, bashkëpunimi policor është efikas, pasi materializohet edhe në veprimet operationale të përbashkëta me vendet partnere përkatëse, me të cilat kemi edhe marrëveshje. Mund të citoja mjaft operatione kundër terrorizmit, si me policinë angleze ku u hetua një celulë terroriste e Al-Kaedes e cila kishte në përbërje të saj edhe shtetas shqiptarë. Apo arrestimi i një shtetasi kosovar në vendin tonë, i cili u hetua në bashkëpunim me policinë gjermane. Kjo celulë kishte marrë angazhim për të kryer akte terroriste në Europë, por falë bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve ndërshtetërore u parandaluan akte të tjera terroriste.

7.3 Bashkëpunimi kundër trafikimit të njerëzve

Trafikimi i qenieve njerëzore është një nga veprat më të rënda kriminale, që mbështetet kryesisht mbi praktikën e dhunimit të të drejtave të njeriut, mbi personat e viktimizuar, dhe mbi mohimin e dinjitetit njerëzor. Trafikimi njerëzor ndikohet nga disa faktorë të janë “shtytës” dhe “tërheqës”³¹¹. Pra, faktorët “shtytës” mund të identifikohen, si: papunësia, varfëria, mungesa e arsimit, diskriminimi gjinor dhuna, etj. Ndërsa faktorët “tërheqës” përfshijnë: shpresa e punësimit dhe përfitimeve të larta financiare; shpresa për trajtim më të mirë social; kërkesa e tregut për prostituta; kërkesa për punë të lehtë, dëshira për arsimim

³¹⁰ Rregullore “Për funksionimin e strukturave kundër terrorizmit”, Miratuar me urdhër të Ministrit Brendshëm nr. 314, datë 26.09.2012, neni 4.

³¹¹ Delo Meçani, “Vepra penale e trafikimit të femrave, opinione dhe komente”, shtëpia botuese “MALUKA”, Tiranë 2006, faqe 20.

më të mirë³¹², etj . Procesi i trafikimi realizohet nëpërmjet tri fazave: rekrutimi, tranzitimi ose zhvendosja, dhe shfrytëzimi dhe kontrolli ndaj viktimave.³¹³ *Rekrutimi* realizohet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet rekrutesh individë, nëpërmjet rrjeteve informale (përfshirë anëtarë të familjes, miq apo shokë), nëpërmjet njoftimeve në media, ose nëpër agjenci të sajara që ofrojnë punë, mundësi studimi, martesë, apo udhëtime jashtë shtetit³¹⁴. Metodrat më të përdorura janë: detyrimi me dhunë, nëpërmjet rrëmbimit dhe grabitjes, ose edhe nëpërmjet shitjes (në mënyrë të veçantë të fëmijëve); mashtrimi me anë të premtimit për një punësim të ligjshëm; gënjeshtërs nëpërmjet premtimeve gjysmë të vërteta, si p.sh: mundësia për të punuar në kushte të paligjshme, por jo në kushte të rënda shfrytëzuese apo skllavëruese. *Transporti* lidhet me zhvendosjen e viktimat nga vendit e origjinës, brenda ose kufirit, për t'i mbajtur më lehtë nën kontroll. Ndërsa, *shfrytëzimi* i të tjerëve i referohet rasteve kur një tutor apo shfrytëzues merr të gjithë ose një pjesë të fitimit që një klient i paguan një prostitute të detyruar për të kryer një marrëdhënie seksuale.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe Protokolli në plotësim të asaj Konvente “*Mbi parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*” i njohur ndryshe si Protokolli i Palermos, është instrumenti ndërkombëtar ligjor parësor, në të cilin trafikimi përkufizohet si më poshtë:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, me anë të kërcënimit, ushtrimit të forcës ose të formave të tjera të detyrimit, të grabitjes, mashtrimit, gënjeshtërs, abuzimit, shpërdorimit të pushtetit ose përfitimit nga pozicioni i pa mbrojtur i personit, për qëllimin e shfrytëzimit të tij, me anë të marrjes ose dhënies së pagesave apo përfitimeve të tjera për sigurimin e lejes së një personi që ka kontroll mbi një tjetër. Shfrytëzimi do të përfshijë, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, ose të formave të ndryshme të shfrytëzimit seksual, të punës apo shërbimeve të tjera, të skllavërisë ose të praktikave të ngjashme me skllavërinë, të shërbimeve të detyruara apo të heqjes së organeve”.³¹⁵

³¹² Xhavit Shala, “Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritetit”, shtëpia botuese “ONUFRI”, Tiranë 2003, fq. 11.

³¹³ Po aty, faqe 52.

³¹⁴ MANUAL: “Standardi Rajonal për trajnimin e policisë së Europës Juglindore në fushën e Anti-Trafikimit”, botuar nga ICMPD, Vjenë, Austri, fq. 19.

³¹⁵ Neni 3, Protokolli i Palermos. Konventa u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në nëntor të vitit 2000 dhe ka hyr në fuqi në dhjetor të vitit 2003.

Nga analiza e përmbajtjes së përkufizimit dalin në pah tri elemente thelbësore të cilat përbëjnë mekanizmin e trafikimit, që ndihmojnë identifikimin e rasteve, siç janë: veprimet, mënyrat, dhe qëllimet. Duke u bazuar mbi përkufizimin e Protokollit të Palermos, Konventa sjell disa risi, veçanërisht në lidhje me suportin ndaj viktimave:

- Merr parasysh të gjitha format e trafikimit, kombëtar dhe transnacional, të lidhura ose jo me krimin e organizuar;
- Ka një kapitull mbi hetimin, ndjekjen penale dhe ligjin procedural;
- Përdor të njëjtin përkufizim të trafikimit si ai i Protokollit të Palermos dhe sjell përkufizimin ligjor të konceptit të viktimës së krimit të trafikimit;
- Trajton parimin e kriminalizimit të detyrueshëm të krimit të trafikimit dhe të mos-kriminalizimit të personave të trafikuar.

Ndërsa, institucione të ndryshme ndërkombëtare japin përkufizimet e veta lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. P.sh:

- *Përcaktimi nga Asambleja e Këshillit të Evropës:*

"Trafikimi i grave dhe prostitucioni me dhunë, si çdo transportim legal apo ilegal i grave dhe/ose tregtimi i tyre, me ose pa dëshirën e tyre fillestare, për qëllime të fitimeve materiale, me qëllim nënshtrimin e mëvonshëm për prostituim, martesë të detyruar, ose për formë të tjera të shfrytëzimit seksual të detyruar. Përdorimi i dhunës mund të jetë fizik, seksual dhe/ose psikologjik, dhe përfshin frikësimin dhe abuzimin e autoritetit ose e një situatë varësie".³¹⁶

- *Përcaktimi nga Konventa e Europolit:*

Ky përcaktim vë theksin kryesisht mbi anën seksuale të shfrytëzimit të viktimave. Në lidhje me format e krimit, në Nenin 2(2) për qëllimet e kësaj Konvente shkruhet:

"Trafikimi i qenieve njerëzore do të thotë nënshtrimi i një personi ndaj një pushteti real dhe të paligjshëm të personave të tjerë duke ushtruar dhunën ose kërcënimet ose me anë të abuzimit me autoritetin ose me anë të intrigës, me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion, të

³¹⁶ Këshilli i Europës; Rekomandimi 1325 (viti 1997) mbi trafikun e grave dhe prostitucionin e detyruar në Shtetet anëtare të Këshillit të Europës.

formave të tjera të shfrytëzimit seksual dhe të sulmeve mbi të miturit, ose tregtimit të fëmijëve të braktisur".³¹⁷

- *Përcaktimi nga Aleanca Globale Kundër Trafikimit të Grave³¹⁸ (GAATW):*

"Të gjitha veprimet dhe përpjekjet për të ndërmarrë veprime për rekrutim, transportim brenda kufijve ose jashtë tyre, për blerje, shitje, transferim, pranim, ose strehim të një personi duke përdorur mashtrimin, detyrimin (duke përfshirë përdorimin e forcës ose kërcënimit për të përdorur forcën, ose me anë të shpërdorimit të autoritetit) ose lidhjen me anë të huas për qëllimin e mbajtjes së personit, qoftë kundër pagesës ose jo, në kushte shërbimi të pavullnetshëm (shtëpiak, seksual ose riprodhues) në një punë të detyruar ose të sforcuar, ose në kushte të njëjta me skllavërinë, në një komunitet të ndryshëm nga ai në të cilin ky person pat jetuar në kohën e lindjes së mashtrimit, detyrimit apo lidhjes në një borxh".³¹⁹

Të gjitha këto përcaktime bien dakord për një numër dimensionesh kyçe:

- Asnjë nuk mbështetet mbi forcën, por përfshijnë një numër strategjish kontrolli dhe kontekstesh detyruese, nëpërmjet të cilave arrihet tek pranimi;
- Të gjithë përfshijnë trafikimin brenda dhe jashtë kufijve;
- Të gjithë përpiqen që të parashkruajnë mbi ata që lehtësojnë apo mbështesin trafikimin.

7.3.1. Format e trafikimit ndërkombëtar të qenieve njerëzore

Format e trafikeve të paligjshme të qenieve njerëzore, të parashikuar nga Kodi Penal i Shqipërisë dhe të hasura gjatë hetimeve të kryera ndër vite janë vepra penale të parashikuara nga nenet: 110/a - "Trafikimi i personave", 114/b - "Trafikimi i femrave" dhe 128/b - "Trafikimi i të miturve", janë: rekrutimi; transportimi; transferimi; fshehja ose pritja e personave; nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të

³¹⁷ Aneksi të cilit i referohet Neni 2 i Konventës së Europolit "Akti i Këshillit që parashkruan mbi Konventën bazuar në nenin K.3 të Traktatit të Bashkimit Europian, mbi Hapjen e një Zyre të Policisë Europiane; korrik 1995".

³¹⁸ Arqile Kosta, Arben Nasufi, Nikoll Rica, Bajram Yzeiri, "Policia dhe qytetarët", shtëpia botuese "MORAVA", Tiranë, 2004, fq.155, (traktatet kundër diskriminimit të grave).

³¹⁹ Aleanca Globale Kundër Trafikut të Grave (GAATW); Standardet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personave të Trafikuar; Janar 1999.

shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër.

Duke ju referuar situatës aktuale të trafikimit të qenieve njerëzore, në kuptim të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës së Palermos³²⁰, konstatohet se prej vitesh Shqipëria nuk është më vend tranzitimi i viktimave të trafikimit. Shqipëria aktualisht konsiderohet vend kryesisht origjine dhe me tendenca të një vendi destinacioni kryesisht përse i përket trafikimit të brendshëm. Në masën dërmuese viktimat e trafikimit janë femra të reja shqiptare të rekrutuara kryesisht në zonat rurale të cilat trafikohen kryesisht në vendet e BE dhe ku forma kryesore e shfrytëzimit është ajo e prostitucionit apo për shërbime të tjera seksuale. Vendet e destinacionit për shfrytëzimin e viktimave shqiptare janë kryesisht Italia, Franca, Belgjika, Holanda, Kosova, Maqedonia dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Në masë më të ulët vihet re trafikimi i fëmijëve, kryesisht nga komunitetet romë dhe egjiptianë të cilët trafikohen kryesisht në Greqi, Itali apo Kosovë me qëllim shfrytëzimin e tyre për lypje apo për birësime të paligjshme. Forma kryesore e rekrutimit mbetet mashtrimi që autorët e këtyre veprave u bëjnë viktimave të tyre femra për martesë apo bashkëjetesë jashtë vendit. Në këtë mënyrë ata organizojnë skema mashtruese duke mashtruar me ceremoni e rite zakonore jo vetëm viktimën por dhe rrethin e saj familjar.

Duke i`u referuar rrugëve që ndiqen për të dërguar viktimat në vendet e destinacionit, duhet thënë se, ato janë kryesisht nëpërmjet pajisjes me dokumente të falsifikuara dhe udhëtimit të tyre nëpërmjet rrugëve tokësore e më rrallë atyre ajrore e detare. Nga analiza e të dhënave statistikore në vite rezulton se tendenca e këtij fenomeni është në ulje të ndjeshme për shkak të masave të gjithanshme të mara nga shteti shqiptar, si përse i përket rritjes së ndërgjegjësimit të grupeve sociale në risk, por, dhe për shkak të një angazhimi të strukturave të zbatimit të ligjit. Krijimi i kuadrit ligjor të përshtatshëm, veçanërisht aplikimi

³²⁰ Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, Fletore Zyrtare, nr. 41, viti 2002, faqe 1195 e vijues.

i dënimeve të rënda të aplikuara dhe sekuestrimet e aseteve të përfituara nga krimi, kanë ndikuar pozitivisht në parandalimin e këtyre veprave penale.

Gjithashtu, duhet theksuar se, përgjithësisht ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve³²¹ shoqërohet nga: strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo i mjeteve të tjera të transportit, me qëllim për të ndihmuar për kalim të paligjshëm të kufirit, ndërsa kontrabandimi i njerëzve³²² është një fenomen i cili nxitet nga një seri faktorësh social-ekonomikë dhe nga një politikë mjaft e ashpër në dhënien e vizave. Ai paraqitet kryesisht në formën e ndihmës që persona të ndryshëm u japin emigrantëve të paligjshëm kundrejt pagesave. Po kështu, janë vërejtur grupe të vogla të organizuara kriminale të cilat bashkëpunojnë me grupe apo persona jashtë vendit në linjat që ndjek kontrabandimi. Format e hasura më shpesh janë:

- Organizimi i personave në grupe të vogla dhe shoqërimi i tyre deri në afërsi të pikave të kalimit kufitar. Mandej të shoqëruar nga persona të caktuar, grupet kalojnë në këmbë kufirin me Greqinë, jashtë pikave të kalimit kufitar. Në këto raste personat disponojnë dokumente identifikimi të falsifikuara.
- Pajisja me vizë e shtetasve nga ambasadat mbi bazën e dokumentacionit tërësisht apo pjesërisht të falsifikuar, i detyrueshëm për t'u paraqitur për pajisjen me vizë.
- Personat kalojnë kufirin shtetëror shqiptar nëpërmjet pikave të kalimit me shtetet kufitare që nuk kanë regjim vizash (Maqedoni, Kosovë, Mali i Zi) dhe mandej të drejtuar nga persona të tjerë, bëhet kalimi për në vendet e destinacionit.

Ndër format kryesore të trafikimit ndërkombëtar të njerëzve gjatë periudhës postkomuniste në Shqipëri kanë qenë :

- Nëpërmjet kalimit të detit me mjete lundruese, pa dokumente.
- Nëpërmjet kalimit të kufirit tokësor duke i`u shmangur kontrollit kufitar.
- Nëpërmjet kalimit në pikat e kontrollit kufitar me dokumente false.

³²¹ Neni 298 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

³²² Sipas kuptimit të Protokollit të Parë Shtesë të Konventës së Palermos.

Këto forma janë shfrytëzuar për të gjitha kategoritë e personave që janë trafikuar, si për shtetas shqiptarë ashtu dhe për të huaj, si për femrat që shfrytëzohen për prostitucion ashtu dhe për të miturit.

- *Kalimi nëpërmjet detit me mjete lundruese, pa dokumente*

Për realizimin e këtij trafikimi fillimisht u përdorën mjetet lundruese shqiptare si anije peshkimi, anije tregtare, motoskafë, dhe duke parë se fitimet ishin të mëdha, duke rënë në kontakt me trafikantë italianë, blenë mjete lundruese të shpejta si skafe e gomone me motorë me fuqi të madhe, duke bërë të mundur në këtë kohë kalimin e shpejtë të detit dhe rritur mundësinë e shpëtimit të kontrollit kryesisht nga anijet italiane të patrullimit. Gjatë viteve 1993-1999 mjetet lundruese të shpejtësisë së madhe arritën në disa qindra dhe shfrytëzonin kryesisht për këtë trafik gjirin e Vlorës, grykëderdhjen e lumit Vjosa, grykëderdhjen e Shkumbinit, gjirin e Kavajës e të Durrësit, si dhe gjirin e Shëngjinit. Kryesisht ky trafikim realizohet me grumbullimin e njerëzve në qendrat e nisjes, fillimisht me pagesë prej rreth 30 mijë lekësh dhe më pas gradualisht deri në 120 mijë lekë për person. Kjo formë është përdorur edhe për trafikimin e shtetasve të huaj kryesisht kinezë, turq me kombësi kurdë, iranianë, etj. Theksohet se ky trafikim bëhej pa dokumente. Rastet e dhimbshme të mbytjeve të njerëzve nga ky trafikim vinin duke u rritur, deri në ngjarjen e mbytjes në kanalin e Otrantos të 84 personave në vitin 1997, ngjarjen e 9 janarit të vitit 2004 etj.

- *Kalimi nëpërmjet kufirit tokës duke ju shmangur PKK*

Kjo formë trafikimi fillimisht u shpreh në formën e udhërrëfyesve, duke marrë shpërblime të vogla për këtë veprimtari dhe më pas u organizua në rrjete trafikantësh. Kalimi i shqiptarëve për në Greqi, nëpërmjet kësaj forme pati edhe ngjarje të dhimbshme, por ka ardhur duke u ulur si rezultat i gjetjes së mundësive të tjera. Aktualisht përdoren nga rrjetet e trafikantëve për të sjellë në Shqipëri viktimat të trafikut të huaj që shfrytëzojnë Shqipërinë si vend tranziti drejt perëndimit. Janë përdorur për këtë qëllim rrugëkalime malore e terrene

të vështira, ose nëpërmjet kalimit në liqene, duke shfrytëzuar errësirën dhe mungesën e kontrollit.

- *Kalimi nëpërmjet PKK duke përdorur dokumente false*

Kalimi nëpërmjet pikave të kontrollit kufitar është forma më e organizuar e trafikantëve sepse ekziston bashkëpunimi midis trafikantëve me falsifikatorët dhe punonjësve që abuzojnë në detyrë. Kjo formë është konstatuar pothuajse në të gjitha pikat e kalimit kufitar, sidomos në Rinas, në Portin e Durrësit dhe të Vlorës, si për shtetas shqiptarë ashtu dhe për të huaj. Gjatë viteve 1993-1998 kjo formë është përdorur gjerësisht dhe nga ana e policisë konstatimet kanë qenë të pakta. Pas vitit 1998 identifikohen me qindra raste të kthimit të shtetasve shqiptarë me dokumente të parregullta nga këto pika kalimi, ashtu dhe për kthimin e shtetasve të huaj që nuk plotësonin kriteret për të hyrë në Shqipëri. Kjo është forma e përdorur më shpesh për trafikimin e femrave të huaja me qëllim shfrytëzimi për prostitucion, sepse kjo rrugë ka qenë e kushtueshme për shkak të ndarjes së përfitimeve midis grupeve kriminale. Aktualisht sipas të dhënave të deklaruara nga policia italiane behët fjalë për një rënie në mënyrë të ndjeshme të këtij trafiku, ndërsa statistikat e policisë kufitare shqiptare tregojnë vetëm për raste sporadike në disa pika të kalimit kufitar.

7.3.2. Masat legislative kundër trafikimit të njerëzve:

Një nga objektivat kryesore të institucioneve kombëtare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, është edhe rritja e numrit të ndjekjeve penale dhe dënimeve të trafikantëve në raport me ndalimet dhe çështjet e hetuara dhe ndjekur në këtë fushë. Kjo arrihet në sajë të bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe prokurorisë dhe organeve të tjera ligjvënëse. Në këtë kuadër, janë bërë disa ndryshimeve në legjislacionin penal, të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor³²³. Ndryshimet konsiderojnë politika ndëshkimore të parashikuara nga nenet e mëposhtme:

³²³ Janë miratuar ndryshime në nenin 298 të Kodit Penal, me ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007, i cili përfshin elemente të veprës penale të kontrabandimit të qenieve njerëzore edhe përmes atyre kufijve që nuk janë të Shqipërisë.

Neni 110/a, Trafikimi i Njerëzve:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, ose dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të marre pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit apo formave të ngjashme me skllavërimin të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit. (5-15 vjet burgim dhe gjobë prej 2-5 milion lek)”.

Neni 114/b, Trafikimi i Femrave:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimi nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit (7-15 vjet burg dhe gjobë nga 3-6 milion lek). Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave (Burgim 10-15 vjet dhe gjobë nga 5-7 milion lek). Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike apo psikike ndaj të të dëmtuarës, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin (Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milion lek). Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarës (Jo më pak se 20 vjet burg, ose me burim të përjetshëm si dhe me gjobë 7-10 milion lek). Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik (Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës)”.

Neni 128/b, Trafikimi i të miturve:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit (7-15 vjet burg dhe gjobë nga 4-6 milion lek). Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve (10-20 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milion lek) Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin (Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milion lek). Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit (Jo më pak se 20 vjet burg ose me burgim të përjetshëm, si dhe gjobë nga 8-10

milion lek) Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik (Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës)”

Neni 114/a, Shfrytëzimi i Prostitucionit në Rrethana Rënduese:

“Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer:

- 1. Me të mitur;*
- 2. Ndaj disa personave;*
- 3. Me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta; gjinie, krushqie, kujdestarie ose duke përfituar nga raportet zyrtare ;*
- 4. Me mashtrim, shtrëngim, dhune ose duke përfituar nga paaftësia fizike ose mendore e personit;*
- 5. Ndaj një personi që shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;*
- 6. Kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike (7-15 vjet burgim) “.*

Neni 297, Kalimi i Paligjshëm i Kufirit Shtetëror: *“Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërore përbën kundërvajtje penale (Gjobë ose burgim deri në 2 vjet)”.*

Neni 298, Ndhimja për Kalim të Paligjshëm të Kufijve:

“Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit, ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, përbën vepër penale (1-4 vjet burg dhe gjobë 3-6 milion lek). Kur ndihma jepet për qëllime fitimi, (3-7 vjet burgim dhe gjobë 4-8 milion lek). Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasojë të renda (5-10 vjet burgim dhe gjobë 6-8 milion lek). Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit (Jo më pak se 15 vjet burg ose me burgim të përjetshëm si dhe gjobë 8-10 milion lek). Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik (Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës”.

Neni 113, “Prostitucioni”: *“Ushtrimi i prostitucionit (Gjobë ose burgim gjer në tre vjet)”.*

Neni 114, “Shfrytëzimi i Prostitucionit”: *“Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit (Gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet)”.*

Neni 115, “Mbajtja e Lokaleve për Prostitucion”: *“Mbajtja, shfrytëzimi, financimi, dhënia me qira e lokaleve për ushtrim të prostitucionit (Gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet)”*.

Në Kodin Penal është shtuar një dispozitë e re kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, e cila do të shoqërohet me një paketë të re social-edukative për ndihmën ndaj këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre në formën e punësimit, arsimit dhe llojeve të tjera të ndihmës. Politikat ndëshkimore ndaj autorëve të këtyre veprave penale janë një faktor i rëndësishëm në parandalimin e trafikimit. Por, nëse këto politika nuk mbështeten nga politika të tjera kombëtare, atëherë këto politika nuk arrijnë të ndikojnë në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, ndryshimet në Kodin Penal, të bëra me Ligjin nr. 144/2013³²⁴, kanë konsistuar në përmirësim të kuadrit juridik dhe rritje të shkallës së ndëshkueshmërisë së autorëve të trafikimit të qenieve njerëzore, dhe konkretisht:

- Është shtuar në Kodin Penal një nen i ri, i cili garanton mos-ndëshkueshmërinë dhe dënimin e viktimave të trafikimit për përfshirjen e tyre në aktivitete të penalizuara të cilat ato janë detyruar ti ndërmarrin si konsekuencë direkte e të qenurit subjekt i trafikimit të personave. (Neni 52/a Paragrafi (II)), *“Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t’i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme”*.³²⁵
- Neni 110/a *“Trafikimi i personave”* ndryshohet si titull dhe bëhet *“Trafikim i personave të rritur”*. Ky ndryshim titulli bëhet për të dalluar trafikimin e brendshëm nga trafikimi ndërkufitar, duke i dhënë fund konfliktit ligjor në implementimin e këtij neni mbi rastet e trafikimit të brendshëm.³²⁶
- Një nen i ri, neni 110/b i KP është shtuar *“Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar”* i cili përcakton penalizimin e përdorimit të

³²⁴ Ligji nr. 144, datë 02.05.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Fletore Zyrtare nr. 83, datë

³²⁵ Shih: Neni 7 i Ligjit nr. 144, datë 02.05.2013

³²⁶ Nenet 26 dhe 27 të Ligjit nr. 144, datë 02.05.2013

shërbimeve të trafikimit të personave dhe të atyre që përfitojnë nga këto shërbime, dhe është i dënueshëm me burgim nga 2 -5 vjet.

- Është shtuar një nen i ri, Neni 110/c *“Veprimet që lehtësojnë trafikimin”* i cili përcakton se *“Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”*.
- Neni 114/a i Kodit Penal mbi shfrytëzimin e prostitucionin në rrethana rënduese dhe neni 114/b *“Trafikimi i femrave”* janë shfuqizuar me ligjin e lart përmendur dhe nuk konkurrojnë më me nenet e tjera të trafikimit.

Po kështu, risi sjell dhe Ligji nr. 143/2013 *“Për disa shtesa në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”*, i cili paraqet ndryshime të rëndësishme në kontekstin e rritjes së aksesit të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje në drejtësi. Sipas nenit 4 të këtij Ligji, personat të cilët kanë nevojë të mbrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet paraqitjes së kërkesë-padisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar taksën mbi aktet, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në këtë rast, që personi ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetohet se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t’u përfshirë në to; ose është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to.

Qysh në dhjetor të vitit 2000, shteti shqiptar ka nënshkruar Konventën e Palermos dhe dy Protokollat plotësues të tij në lidhje me trafikimin e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, e cila është ratifikuar me ligj. Nëpërmjet nënshkrimit të Protokollit, shteti mori përsipër detyrime që lidhen me kriminalizimin e këtij fenomeni, marrjen e masave për rehabilitimin e viktimave të tij, forcimin e ndjekjes penale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. Gjithashtu, Kuvendi ratifikoi Konventën e Këshillit të

Evropës: “*Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore*”³²⁷, e cila ishte masa më e rëndësishme me karakter penal, në përpjekjet për të parandaluar këtë fenomen. Parashikimi i sanksioneve të rënda me burgim, si dhe i dënimeve me gjoba të larta dha efekte pozitive në parandalim. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka dhe Ligji nr. 9284, datë 30.09 2004, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”, i ndryshuar me ligjin e vitit 2009, të njohur si ligji antimafja³²⁸, i cili synon parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës dhe kriminel të organizuar dhe trafikues. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:

- a) *pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;*
- b) *pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;*
- c) *kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal;*
- d) *kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.*
- e) *kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal.*³²⁹

³²⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006. Ligji nr. 8733, i vitit 2001 “Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

³²⁸ Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

³²⁹ Shih: Neni 3, pika 1 e ligjit. Ndërsa pika 2 e Nenit 3 parashikon se: Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të: a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni; b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Ky ligj sjell risi barrën e provës, e cila në bazë të nenit 21, pika 3, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme. Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit është gjithashtu risinë fushën e ndjekjes së krimeve të rënda. Ky fond sipas ligjit shërben për:

- a) *përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë;*
- b) *përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik;*
- c) *dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale.*³³⁰


Gjithashtu ligji për moratoriumin e mjeteve lundruese³³¹ ka dhënë një impakt parandalues të veçantë, i cili për një periudhë disa vjeçare pezulloi të gjitha lëvizjet e mjeteve motorike lundruese shqiptare në ujërat territoriale dhe të brendshme të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga funksioni i përdorimit të mjetit, si dhe transporti i mjeteve lundruese në rrugë tokësore, me përjashtim të atyre në përdorim të organeve shtetërore dhe të shërbimeve portale; mjetet lundruese të destinuara vetëm për peshkim; mjetet e transportit detar, që shërbejnë për transportin e mallrave; dhe mjetet e transportit detar, të licencuara për transport pasagjerësh dhe të klasifikuara nga Regjistri Detar Shqiptar si mjete lundruese për transport udhëtarësh.

Lidhur me rezultatet e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për periudhën 2005 - 2012, statistikatat tregojnë se janë realizuar 53 operacione kundër trafikeve të paligjshme në bashkëpunim me partneret ndërkombëtar. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 351 raste të trafikimi të femrave me 463 autorë të proceduar, të paraqitura në grafikun e mëposhtëm, të ndara sipas viteve:

³³⁰ Shih: neni 37, pika 2 e Ligjit.

³³¹ Ligji nr. 9509, datë 03.04.2006, “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë”. Fletorja Zyrtare nr. 37, datë 02.05.2006, faqe 1166, i ndryshuar me Ligjin nr. 10220, datë 4.2.2010.

Grafik 1 : Raste të operacioneve policore të trafikimit të femrave, realizuar me partnerët ndërkombëtar, dhe autorët e tyre, 2005 - 2012



Burimi: Sektori kundër Trafiqeve të Paligjshme në Policinë e Shtetit

Ndërsa, vetëm për vitin 2012 janë kryer 13 operacione policore të përbashkëta me partnerët ndërkombëtar, ku janë përfshirë 67 autorë, nga të cilët 52 janë arrestuar në flagrancë, dhe 15 hetohen në gjendje të lirë.

Tabelë 2: Operacione policore të përbashkëta për vitin 2012

Nr	M. S. Hetimore	Operacionet	Aut	Arrest	Gj. Lire	Muaji	Vepra Penale
1	Përgjim/vëzhgim	Bregdeti	4	4		Janar	141/a- Maqedoninë /SELEC
2	Vëzhgim	Piazza	1	1		Shkurt	114- Italinë
3	Vëzhgim	Rruga	1	1		Shkurt	114- Italinë
4	Përgjim/Vëzhgim	Menaxheri	2	2		Prill	114/a- Italinë
5	Përgjim/Vëzhgim	Pranvere e hidhur	4	4		Prill	114/a- Italinë
6	Përgjim/Vëzhgim	Gjahtari	1	1		Prill	114/a- Italinë

7	Vëzhgim	Nikolli	1	1		Qershor	114/a- Italinë
8	Vëzhgim	Befasia	1	1		Qershor	114/a- Italinë
9		Lease car	15		15	Shtator	141/a- SELEC
10		Baywatch	28	28		Shtator	114- 113 Gjermani
11	Përgjim/vëzhgim	Halili	1	1		Tetor	114/a- Italinë
12	Përgjim/vëzhgim	Ura Dajlanit 2	7	7		Tetor	114/b,113- Italinë
13	Përgjim/vëzhgim	Deda	1	1		Nëntor	114/b- Italinë
	SHUMA		67	52	15		

Burimi: Drejtoria e Bashkëpunimit dhe koordinimit Ndërkombëtar në Policinë e Shtetit

Në Shqipëri, më i theksuar ka qenë dhe është trafikimi i femrave, të cilat shfrytëzoheshin për qëllime prostituimi brenda dhe jashtë vendit, si dhe trafikimi i fëmijëve të cilët shfrytëzohen në mënyra të ndryshme, kryesisht për lypje, për shpërndarje narkotikësh, vjedhje, etj. Statistikat e mëposhtme tregojnë se për periudhën 2006 - 2012 në trafikimin e personave janë implikuar 194 autorë, nga të cilët 163 janë proceduar për veprën penale të trafikimit të femrave, dhe 31 autorë për trafikim të të miturve.

Tabelë 3: Autorët e veprës penale të trafikimit të femrave dhe të miturve, 2006 – 2013

Viti	Vepra Penale	Autoret	Arrestuar	Gj. lire	Ndaluar	Kërkim
2006	Trafikim i femrave	28	2	7	10	9
	Trafikim i të miturve	4	2	1	1	-
2007	Trafikim i femrave	11	2	5	2	2
	Trafikim i të miturve	7	2	2	2	1
2008	Trafikim i femrave	16	1	10	2	3
	Trafikim i të miturve	-	-	-	-	-
2009	Trafikim i femrave	9	1	4	3	1
	Trafikim i të miturve	4	-	4	-	-
2010	Trafikim i femrave	45	5	34	3	3
	Trafikim i të miturve	3	3	-	-	-

2011	Trafikim i femrave	24	8	11	3	2
	Trafikim i të miturve	10	2	7	-	1
2012	Trafikim i femrave	30	8	19	-	3
	Trafikim i të miturve	3	-	2	1	-
2013	Trafikim i femrave	31	-	25	1	4
	Trafikim i të miturve	10	-	7	2	3
SHUMA	TRAFIKIM I FEMRAVE	194	27	115	24	27
	TRAFIKIM TË MITUR	31	9	23	6	5

Burimi: Sektori kundër Trafiqueve të Paligjshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë

Si përfundim, theksojmë se, përmirësimet e vazhdueshme në legjislacionin shqiptar, përafrimi i tyre me ato të vendeve të BE-së, ngritja e institucioneve në vend, si dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar kundër trafiqueve të pa ligjshme, duke rritur besueshmërinë për shkëmbim të ndërsjelltë të informacioneve dhe kryerjen e hetimeve të përbashkëta, ka sjell rënie të dukshme të rasteve të evidentuara, të denoncuar dhe proceduara, të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri.

7.4 Bashkëpunimi kundër trafikimit të drogave

Trafikimi i drogave është një nga aktivitetet ilegale më fitimprurëse të krimit të organizuar. Shqipëria me pozicionin e saj gjeografik favorizon në një farë mënyre tranzitimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike kryesisht të heroinës. Shqipëria nuk përbën vetëm një rrugë tranzitimi të drogave ilegale, por ajo është vendi ku droga kultivohet (kryesisht Canabis Indica), prodhohet (vaji i hashashit dhe marijuana), tregtohet lokalisht dhe abuzohet. Duke analizuar situatën dhe vlerësuar rrezikun përpjekjet për luftën kundër drogave duhet të përqendrohen kryesisht kundër kultivimit, prodhimit, trafikimit të drogave duke e transituar përmes Shqipërisë, dhe kundër trafikimit të tyre brenda territorit të vendit tonë. Rritja e efikasitetit të agjencive të angazhuara në luftën kundër drogave ka rezultuar në rritjen e sasive të konfiskuara dhe ka bërë që grupet kriminale të kërkojnë metoda dhe rrugë të reja

të trafikut ilegal, por, për shkak të natyrës serioze të problemeve që lidhen me trafikun e drogave dhe abuzimit me to, është e nevojshme të vlerësohet se deri ku mekanizmat kompetente dhe institucionet i përgjigjen këtij fenomeni. Konsiderohen lëndë narkotike të gjitha ato lëndë që shoqërohen me emërtimet psikotrope dhe narkotike që përdorimi, posedimi, shitja e të cilave është e ndaluar me ligj. Këto lëndë që kur merren në sasi të caktuara ndikojnë mbi sistemin nervor të njeriut duke prishur ekuilibrin psikologjik e fizik, sjellin shkatërrimin social e ekonomik brenda shoqërisë e personave, krijojnë ndjenjën e varësisë.

Sipas veprimit mbi personin dhe burimin nga i cili realizohen, ato klasifikohen, në:

- *Lëndë depressive*³³² (me veprim ngadalësues mbi sistemin qendror nervor), ku hyjnë medikamente natyrale si, opiumi, morfinë, heroinë, kodrinë, dhe medikamente sintetike si, barbiturat, trankilizan, sedativ, etj.
- *Simulantë* (ngacmues të sistemit nervor qendror), ku hyjnë medikamente natyralë si, gjethe koka, kokainë, crack, dhe medikamente sintetike si, amfetaminë etj.
- *Halucinacion krijues* (shkakton uljen e ndjeshmërisë së shqisave), ku hyjnë medikamente natyralë si, marijuanë, esrar, meskallin etj.

Po ashtu njihet përdorimi me efekt stimulues i disa substancave kimike natyrale e sintetike që avullojnë, të cilat quhen *thithëse* ose *zbërthyes organik*. Kjo përmbledh vetitë marramendëse me ndikim në sistemin nervor.

Për të qenë të suksesshëm në luftën ndaj lëndëve narkotike është e nevojshme analizimi i zonave të prodhimit, atyre që paraqesin më tepër kërkesa për këto lëndë, lidhjet e zonave njëra me tjetrën, si dhe faktorët që favorizojnë dhe metodat e tyre.

Zonat prodhuese të drogave. Nga studimet mbi zonat prodhuese në botë vëmë re se prodhimi i kokainës realizohet në vendet veriperëndimore të Amerikës së Jugut si Kolumbia, Peruja, Bolivia etj e më pas pushton regjet në botë. Kokaina prodhohet nga bima Koka. Kanabisi ose e quajtur ndryshe bima e kërpit Indian, me cilësinë e saj të

³³² Skënder Begeja, “Kriminalistika”, ribotim i SHBLU, Tiranë 1999, fq. 552.

zhvillimit në çdo klimë, prodhohet pak a shumë në të gjithë botën, është e shpërndarë në shumë vende të Azisë, Afrikës, Amerikës Latine dhe Europë. Derivatet e saj janë marijuana dhe hashishi. Opiumi që njihet si lënda e parë për heroinën, mbillen në mënyrë të ligjshme në vende të tilla si India, Japonia, Kina, Australi, Franca, Spanja, Hungaria, Turqia dhe në mënyrë të paligjshme në zonës ashtuquajtur të trekëndëshit të artë Burma-Laos-Tajlandë, zonën e “Hënës së artë” Pakistan – Iran - Afganistan, si dhe Meksikë e Kolumbi. Prodhimi tabletave sintetike nëpërmjet lëndës *Acid anhidrik acetik* që përdoret në prodhimin e heroinës, realizohet kryesisht në vendet ku konsumi dhe kërkesat për këto lëndë janë më të mëdha si Amerika, Europa Perëndimore, Kina, Rusia, India etj³³³. Faktorët që favorizojnë kultivimin e tyre në mënyrë të paligjshme janë luftërat, boshllëku i autoritetit shtetëror, paqëndrueshmëria e regjimeve. Në këto zona mungojnë pushtetet e fuqishme, sigurimi i duhur i kufijve, forcat e ligjit dhe mjetet e duhura. Në vitet e tranzicionit Shqipëria u përfshi në kultivimin e bimës narkotike “*canabis sativa*”.

7.4.1. Pozicioni i Shqipërisë në trafikun e lëndëve narkotike:

Në Shqipëri situata e drogës është shqetësuese, për faktin që tek ne mbillet, shpërndahet dhe trafikohet drogë. Me gjithë goditjet e herëpashershme që bën policia në këtë drejtim kundër grupeve dhe organizatave kriminale, përsëri ka një tendencë të qëndrueshme fenomeni i mbjelljes, shpërndarjes dhe trafikut të drogës. Droga që shpërndahet në shumë shtete të Europës, pikë të rëndësishme ka edhe vendin tonë. Fakti që janë goditur shumë grupe dhe organizata kriminale flet për atë që policia asnjëherë nuk e ka ulur intensitetin në luftën kundër drogës.

Në Shqipëri, drogat kryesore që janë prezentë dhe përdoren janë:

- *Kanabisi* - Rritet me lehtësi në Shqipëri në shume zona, sidomos në rrethet Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër e Tropojë. Ajo korret, ambalazhohet dhe eksportohet direkt e papërpunuar në Europën Perëndimore, ose dërgohet në fillim në Maqedoni

³³³ Elezi M, “Drug Production and Trafficking in Albania”, The Journal is published by the IISES and University of Economics, Prague, IJoSS Vol. II, No.3, 2013. <http://www.iises.net/journals/journal-of-social-sciences/ijoss-vol-ii-no-3-2013/>

për tu përpunuar. Fshati Lazarat i rrethit Gjirokastrë prodhon sasinë më të madhe të kanabisit në Shqipëri.

- *Heroina* - Po përdoret gjithnjë e më shumë nga vetë qytetarët e vendit tonë. Në shumë qytete kjo është një problem i cili duhet vlerësuar shumë seriozisht nga strukturat policore. Nga informacionet që disponon policia, del se sasi të konsiderueshme heroine trafikohen në Shqipëri. Ajo hyn në Shqipëri nga toka nëpërmjet rrugëve tokësore nga Turqia, Bullgaria, Maqedonia e Kosova, ose nëpërmjet Turqisë dhe Greqisë.
- *Kokaina* - Përbën vetëm një përqindje të vogël të drogës që trafikohet nëpërmjet Shqipërisë dhe hyn në vend nëpërmjet rrugëve tokësore, porteve detare dhe aeroportit.

Në Kodin Penal të Shqipërisë parashikohen këto lloje të krimeve në fushën narkotike:

- Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (neni 283);
- Trafikimi i narkotikëve (neni 283/a);
- Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës (neni 283/b);
- Kultivimi i bimëve narkotike (neni 284);
- Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale (neni 284/a);
- Ndihma në zbulimin e krimeve (neni 284/b);
- Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope (neni 284/c);
- Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike (neni 285);
- Përshtatja e lokalit për përdorim droge (neni 285/a);
- Hedhja ose braktisja e shiringave (neni 285/b);
- Nxjtja për përdorimin e drogës (neni 286).

Rrugët e trafikut të drogës dhe mënyrat e fshehjes: Grupet apo personat kriminale në përgjithësi përdorin dy rrugë për realizimin e trafikimit të lëndëve narkotike, të cilat janë: Trafikimi i brendshëm, i cili realizohet brenda territorit të vendit sipas kërkesave për tregti dhe konsum, dhe Trafikimi ndërkombëtar, i cili realizohet jashtë territorit të vendit ose

ndërmjet vendeve të tjera. Rugët e trafikimit të lëndëve narkotike janë të kushtëzuara nga: lloji i lëndëve narkotike; vendi i prodhimit dhe destinacioni; kërkesat e grupeve kriminale për lëndë narkotike; rreziqet dhe vështirësitë që lidhen me transportimin e tyre; dhe lloji i transportit (tokësor, ajror, detar). Ndërsa mënyrat e fshehjes së lëndëve narkotike janë nga më të ndryshmet, por më kryesoret janë:

- Fshehja në trupin e njeriut, teshat, bagazhet, sendeve, mjeteve që posedon.
- Fshehja në mjetet e transportit, e cila realizohet duke shfrytëzuar të gjitha ambientet dhe pjesët e një automjeti transporti dhe në ngarkesat e tyre. Me këtë mënyrë realizohen transportimet në sasi të mëdha të lëndëve narkotike.
- Fshehja në dërgesat postare, që zakonisht personat përdorin gjaneralitete të rreme.³³⁴

7.4.2. Masat specifike të luftës ndaj krimeve në fushën e drogave:

Hetimet kriminale janë pjesë e misionit të çdo organizate policie dhe përgjegjësi e strukturave të caktuara për këtë qëllim. Qëllimi i tyre është të përcaktojnë se ka ndodhur një krim, të gjejë se kush e ka kryer dhe ta sjellë autorin përpara drejtësisë duke mbledhur dhe paraqitur provat e mjaftueshme. Shpesh, efektiviteti i një strukture policie, departament, drejtori, komisarjat, sektor apo seksion), matet me aftësinë për të zbuluar veprat penale të ndodhura. Kur hetimi i një krimi është i suksesshëm, komuniteti krijon besim tek policia. E kundërta ndodh kur hetimi është i pasuksesshëm, qytetaret fillojnë të humbasin respektin dhe besimin tek policia³³⁵. Prandaj, policia duhet të jetë e aftë të ekuilibroj shumë detyra, përfshirë rritjen e sigurisë së komunitetit, t'i përmbahet drejtësisë dhe të rrisë besimin e publikut. Policisë nuk i kërkohet vetëm të parandalojë krimin por edhe të kapë dhe t'i çojë para drejtësisë autorët e kryerjes së krimit. Bashkërendimi i punës së policisë me prokurorinë është i sanksionuar në një udhëzim të posaçëm³³⁶. Në punën e tyre strukturat për hetimin e krimeve kundër drogës përdorin dhe këto metoda speciale:

a. Metoda e blerjes së stimuluar,

³³⁴ "The Journal of Social Sciences IJoSS" Vol. II, No.3, 2013. ISSN: 1804-980X, Çeki.

³³⁵ Bajram Yzeiri, "Ligji dhe Policia", shtëpia botuese "ILIAR", Tiranë, 2002, fq.165

³³⁶ Udhëzimi i Përbashkët Nr. 809, datë 09. 04. 2003 i Ministrisë të Brendshme dhe Prokurorisë të Përgjithshme "Për përdorimin e metodave specifike të hetimeve të krimeve".

- b. Metoda e dorëzimit të kontrolluar,
- c. Metoda e punonjësit nën mbulim dhe
- d. Metoda e punonjësit të policisë së infiltruar³³⁷ etj.

- *Përgjimi i telefonit dhe ambientit*. Kompetenca e përgjimit të telefonit rregullohet me ligj³³⁸. Përgjimi parandalues bazuar në dyshime të besueshme mund të bëhet para hetimit dhe pa vendim të gjykatës, por ai bëhet edhe përgjim procedural, pas fillimit të hetimit me vendim të Gjykatës. Disa nga nenet më të rëndësishme të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që preken nga përgjimet janë:

“1. Çdo njeri gëzon të drejtën e respektit të jetës së tij private dhe familjare, vendbanimin dhe korrespondencën e tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte veçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e vendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave lirive të të tjerëve.”³³⁹

Kodi i Pr.Penale në nenin 222/1 përcakton se:

“Me kërkesën e prokurorit ose të dëmtuarit akuzues, gjykata autorizon përgjimin me vendim të motivuar për rastet e lejuara me ligj, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës”.

Siç shihet në këtë nen për të lejuar përgjimin janë vënë disa kufizime të cilat duhet thënë se janë reflektim i kufizimeve që jepen në paragrafin e dytë të Nenit 8 të Konventës Evropiane për Liritë e të Drejtat e Njeriut.

- *Ndjekja teknike*, është përdorimi i mjeteve e pajisjeve vëzhguese, kjo realizohet duke vendosur mjetet në ambiente e mjedise me qëllim vëzhgimin dhe përgjimin e personave. Edhe në këtë rast ndjekja teknike bëhet me qëllim parandalues dhe procedural hetimor.

³³⁷ MANUAL “Për procedurat standarde të punës në hetimin e krimeve”, faqe 20, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Nr. 1101, datë 29.09.2009, hartuar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Shqipërisë.

³³⁸ Ligji nr 9157 date 4.12.2003 mbi “Përgjimin e telekomunikimeve”.

³³⁹ Konventa Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Neni 8 – “E drejta për të respektuar jetën private dhe familjare”.

- *Dorëzim të kontrolluar*³⁴⁰, ndjekja dhe mbikëqyrja në rrugë procedurale e sendeve dhe mallrave të ndaluara me qëllim gjetjen e autorëve dhe fajësimi i tyre.

- *Blerja e stimuluar*³⁴¹ e drogës duhet të jetë e kontrolluar qoftë nga pikëpamja operationale ashtu edhe nga ajo logjistike, dhe njëkohësisht të mundësojë zbulimin e sasive të mëdha të drogës apo vendeve e personave që e tregtojnë atë. Për këtë duhet të parashikohen procedurat e blerjes, personat (agjentët e fshehtë) që do të kryejnë, oficerët mbikëqyrës dhe në përfundim të bëhen relacione të sakta për rezultatet operationale dhe detyrat që do të kryhen me tej. Agjentët e fshehtë, janë punonjës të policisë me identitet tjetër dhe të depërtuar në veprimtarinë kriminale me qëllim mbledhjen e provave dhe fakteve. Në nenin 294/b të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar se:

*“Për qëllimet e zbulimit të krimeve të renda, oficeri i policisë gjyqësore, me autorizimin e prokurorit, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hetimin, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e vet si punonjës policie”.*³⁴²

Aktiviteti i punonjësit të policisë të infiltruar në organizata kriminale mund të përkufizohet si një veprimtari e oficerëve të policisë gjyqësore të pajisur me një identitet të rremë për të vepruar nën kontrollin e një mbikëqyrësi. Detyra e këtij punonjësi policie është për të vëzhguar dhe treguar gjithçka mbikëqyrësit të tij në lidhje me veprimtarinë kriminale të organizatës dhe me strukturën e saj. Në çdo moment çështja më kryesore dhe përgjegjësia më e madhe e oficerit të policisë gjyqësore që ka në ngarkim detyrën e infiltrimit është siguria. Infiltrimi i tyre në përbërjen e një grupi kriminal është një burim i mundshëm për sigurimin e provave shumë cilësore dhe për këtë arsye pranohen dhe menaxhohen risqet që shoqërojnë këtë operacion. Në ligjin procedural kombëtar midis të tjerave përcaktohet se:

³⁴⁰ Shih: Ligji nr. 8750, datë 26.03.2001”Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”, Neni 2, pika 2.

³⁴¹ Shih: Ligji nr. 8750, datë 26.03.2001”Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”, neni 2, pika 1.

³⁴² Neni 294/b i Kodit të Procedurës Penale.

“Oficeri i policisë gjyqësore për qëllimet e zbulimit të krimeve të rënda, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hetimin”³⁴³.


Pra, siç shihet dy janë detyrat kryesore të punonjësit të policisë së infiltruar, *së pari*: për individualizimin e pjesëtarëve të grupit kriminal, dhe, *së dyti*: mbledhja e provave të nevojshme për hetimin. Në të tilla raste, është e nevojshme të merren në konsideratë metodat e marrjes dhe të regjistrimit të këtyre provave.

- *Konfiskimi i pasurisë*. Krimi i organizuar, veçanërisht ai i trafikut të drogave sjell përfitime të mëdha në rrugë ligjore dhe jo ligjore. Personat duhet të vërtetojë burimin e fitimit. Ata të cilët nuk arrijnë të vërtetojnë rrugët e fitimit i konfiskohet pasuria. Këto realizohen në rrugë ligjore.

7.4.3. Të dhëna statistikore të luftës kundër trafikut të drogave:

Më poshtë do të paraqesim të dhëna statistikore për periudhën 2005 – 2012, lidhur me: rastet e kultivimit të Canabiss sattiva; bimë Canabis të asgjësuar; heroinë e sekuestruar në Itali, e tranzituar përmes Shqipërisë; dhe kokainë e sekuestruar në Itali e tranzituar përmes Shqipërisë.

Grafik 2: Numri i bimëve Canabis Sattiva të asgjësuar në periudhën 2005 - 2012



³⁴³ Neni 294/b, i Kodit të Pr. Penale, pika 1.

Si përfundim, theksojmë se, angazhimi i të gjitha strukturave ligjzbatuese në vend, koordinimi i veprimeve dhe i informacione ndërmjet tyre dhe institucioneve partnere, ashpërsimi i nivelit të dënueshmërisë si pasojë e ndryshimeve në Kodin Penal, ndjekja e hetimit dhe gjykit nga institucione të ngritura enkas për krimet e rënda si Prokuroria dhe Gjykata për Krimet e Rënda, në shkallë të Parë, të Dytë dhe në Apel, kanë sjell rënie të vazhdueshme të rasteve të trafikimit të drogave të rënda nga Shqipëria drejt vendeve të tjera. Problem vazhdon të mbetet kultivimi i Canabisit, ku zona të veçanta nuk janë në kontroll të plotë nga strukturat përkatëse policore. P.sh. fshati Lazarat në Gjirokastrë vazhdon të mbetet burimi kryesor i kultivimit të kësaj lloj droge.

Drogë e sekuestruar në Itali me origjinë apo të tranzituara nga Shqipëria (2000 - 2013)

Gjatë viteve të fundit ka rënie të ndjeshme të kalimit të drogave që tranzitohen nëpërmjet Shqipërisë për në drejtim të Greqisë dhe Italisë, kryesisht drogat e forta. Kjo konfirmohet edhe nga statistikat zyrtare të hartuar nga pala Italiane, të paraqitura me poshtë:

Tabelë 3: Drogë e sekuestruar në Itali me origjinë apo të tranzituara nga Shqipëria, 2000 - 2013

Lloji i drogës	VITI													
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Heroinë	187.542	636.030	700.728	1100.001	1085.330	392.604	379.162	173.568	62.479	59.224	2.026	17.538	0	97.272
Kokainë	12.960	11.549	4.500	14.381	3.289	2.130	0.000	13.844	3.880	0	1.120	0	0	12.131
Hashish	773.578	356.401	47.000	172.236	0.000	0.000	30.800	0	0	0	0	0	0	1.280
Marijuana	12696.157	13302.304	5847.940	8258.732	801.300	808.322	3043.025	456.517	4.000	1420.233	65.525	3190.136	4435.663	5.680.416

Burimi: Sektori Kundër Narkotikëve në Policinë e Shtetit

7.4.4. Ku ka çeduar lufta kundër trafikut të drogës në Shqipëri?

Nga analiza e situatës lidhur me trafikimin e drogave, dhe kryesisht asaj të llojit cannabis sativa, konstatohet se mos suksesi i plotë i policisë në këtë drejtim ka ardhur nga disa faktorë, të renditur si më poshtë:

- Bashkëpunimi i strukturave policore me ato vendore dhe komunitetin lidhur me shkëmbimin e informacioneve ka qenë i dobët.
- Masat parandaluese që në fazat e para të kultivimit të drogave kanë qenë të pa mjaftueshme.
- Nuk është bërë kontrolli i territorit në të gjithë hapësirën e vendit, por vende të veçanta janë devijuar.
- Në rastet e kapjeve në flagrancë, hetimet përgjithësisht janë fokusuar tek transportuesit, po u thelluar më tej, tek kultivuesit, përpunuesit, mjetet e përdorura për përpunim, transport dhe për trafikim jashtë vendit, personat financues, blerësit, destinacioni mbërritës, etj, duke u lënë mundësi organizuesve të trafikut të vijojnë aktivitetit pa u ndëshkuar.
- Stepja e strukturave policore në raste të veçanta, pasi i shmangen konfliktit nga grupe njerëzish, të cilët nga eksperiencia është provuar se përdorin armë zjarri dhe në vijë të parë vendosin gratë dhe fëmijët.
- Pasiguria e strukturave policore për rrjedhje të informacionit lidhur me grupe dhe individë të veçantë të evidentuar për rrezikshmërinë e lartë shoqërore.

7.5 Tregues të bashkëpunimit policor ndërkombëtar kundër krimit në kuadër të SELEC

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, policia shqiptare është angazhuar në operacione të përbashkëta rajonale nën drejtimin e Qendrës SECI, sot SELEC. Këto operacione kanë konsistuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, parandalimit të trafikut të lëndëve narkotike, luftës kundër terrorizmit etj. Disa nga treguesit e bashkëpunimit policor ndërkombëtar kundër krimit, të ndara sipas viteve janë:

Gjatë vitit 2007, strukturat policore shqiptare kanë marrë pjesë në 24 takime të Task Forcës të luftës kundër trafikut të lëndëve narkotike, 30 takime të Task Forcës të parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, 10 takime të Task Forcës së antikontrabandës, dhe në 9 takime të Task Forcës së antiterrorizmit, si dhe janë angazhuar në 2 operacione të përbashkëta:

- Operacioni `PARADISE` ku morën pjesë Shqipëria, Kroacia, Sllovenia dhe Italia. Në përfundim të këtij operacioni u arrit arrestimi i 5 personave në Itali dhe Slloveni, që merreshin me trafikimin e qenieve njerëzore drejt Italisë.
- Operacioni tjetër ishte `HURRICANE 2`, ku morën pjesë 12 vende anëtare, me qëllim sekuestrimin e cigareve kontrabandë në rajonin e Europës Juglindore³⁴⁴.

Gjatë vitit 2008 strukturat policore shqiptare kanë marrë pjesë në 9 takime të Task Forcës kundër trafikut të lëndëve narkotike, 6 takime të Task Forcës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 4 takime të Task Forcës të anti-kontrabandës dhe në 4 takime të Task Forcës së antiterrorizmit, të organizuara nga Qendrës SECI, duke u angazhuar në disa operacione të përbashkëta për sekuestrimin e cigareve kontrabandë, parandalimin e trafikut të armëve dhe municioneve luftarake, mjeteve motorike, si dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore:

- Operacioni “SHADOW 3”, i zhvilluar në muajin Mars, i cili përfundoi me konfiskimin e 666.056.970 paketave cigare.
- Operacioni “DORA” i zhvilluar në muajin Korrik, ku morën pjesë Shqipëria, Serbia, Greqia dhe Maqedonia, për *“Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal”*. Në përfundim të këtij operacioni u arrit shkatërrimi i një grupi kriminal që merrej me trafikimin e shtetasve kinezë drejt Greqisë, dhe kryerja e veprimeve hetimore të cilat rezultuan me 25 të arrestuar në Serbi dhe Maqedoni.

³⁴⁴ Burimi: Zyra e oficerit ndërlidhës në SELEC, Bukuresht.

- Operacioni “KLANDESTINI” i zhvilluar në bashkëpunim me strukturat policore homologe të Italisë, Kroacisë dhe Sllovenisë për *“Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror e kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal”*.
- Operacioni “BUTIKOFER” i zhvilluar në bashkëpunim me strukturat policore homologe të Italisë, Francës dhe Zvicrës për *“Trafikim të mjeteve motorike”*.
- Operacioni “POSTA E FUNDIT” i zhvilluar në bashkëpunim me strukturat policore homologe të Belgjikës për *“Trafikim të armëve dhe municioneve luftarake”*.
- Operacioni “ALBERTA” i zhvilluar në bashkëpunim me strukturat policore homologe të Kosovës për *“Trafikim të armëve dhe municioneve luftarake, e kryer në bashkëpunim”*.³⁴⁵

Gjatë vitit 2009, policia shqiptare mori pjesë në 6 takime të Task Forcës së anti-drogës, 8 takime të Task Forcës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 3 takime të Task Forcës të anti kontrabandës dhe në 4 takime të antiterrorizmit, të organizuar nga Qendra SECI, duke marrë pjesë në dy operacione të përbashkëta me pjesëmarrjen e 13 vendeve anëtare të Qendrës:

- Operacioni “CREDIT CAR”³⁴⁶ për sekuestrimin e makinave të vjedhura në rajonin e Europës Juglindore.
- Operacioni “BARTER”³⁴⁷ i cili konsistoi në parandalimin dhe konfiskimin e lëndëve narkotike.

Një ndihmesë në shkëmbimin e informacioneve dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta kanë dhënë Interpoli, Qendra SECI, oficerët e kontaktit që veprojnë në vendet respektive, Zyra Ndërlidhëse Italiane Interforcë, si dhe oficerët e kontaktit të atashetë policorë nga Greqia, Franca, Vendet Nordike, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, etj.

³⁴⁵ Po aty.

³⁴⁶ Ky operacion u drejtua nga Qendra SECI, u zhvillua në muajin Mars, dhe përfundoi me sekuestrimin e 157 automjeteve të vjedhura në shtete të ndryshme.

³⁴⁷ Ky operacion u drejtua nga Qendra SECI, u zhvillua në muajin Tetor të vitit 2009, në të cilin u arrit konfiskimi i 132 kg heroinë në Bullgari dhe Maqedoni.

Gjithashtu janë kryer edhe 10 operacione ndërkombëtare në bashkëpunim me autoritetet policore dhe gjyqësore të këtyre vendeve.

